

POEZIA BASHKËKOHORE SHQIPE - NË SUEDISHT

A N T O L O G J I

NUTIDA ALBANSK POESI - PÅ SVENSKA

A N T O L O G I

Përkthimi / Översättning

Ulmar Kvik (Ullmar Qvick)

Hajdin Abazi

Shqiptar Oseku

Poezitë i përzgjedhi dhe korrektoi redaktori, Shefki Oseku

Poesin valdes och korrekturläst redaktören, Shefki Oseku

Korrektorë të poezisë suedeze

Korrekturläsning på svenska

Marjanne Bengtsson

Monika Fingal

Kompjuterizimi / Dataansvarig

Frashër Oseku


Botim i dytë, i përmirësuar, qershor 2013

Andra, förbättrade upplaga, juni 2013

Tirazhi / Upplaga 1.000 copë

BOTIM I REVISTËS "DRITA" NË TRELEBORG - SUEDI

UTGIVEN AV TIDSKRIFT DRITA I TRELLEBORG – SVERIGE



LIBRI BOTOHET ME RASTIN E 100 VJETORIT TË PAVARËSISË SË SHQIPËRISË

Libri botohet me rastin e 100 Vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë

Boken är en hyllning till 100-årsminnet av Albanians självständighet

**Prindërve të mi, me dashuri dhe mirënjohje të thellë,
Shefki Oseku**

**Till mina föräldrar, med stor tacksamhet,
Shefki Oseku**

VOREA UJKO *

ARBËRESHI NË ULQIN *

Dëgjoj muzikën e natës

kur suvala ra

çdo ngjyrë u shua

e hëna u përul

mbrapa lisave.

Këtu unë s'kam shtëpi

dhe nuk ndihem i huaj.

Në ballë do ta puthja

vashën që troket në derë

dhe pyet në gjuhën time

nëse dëshiroj kafe.

Ndoshta ajo mendon

se gjuhën e kam nxënë

për udhëtim nëpër botë

dhe nuk e di fshetësinë

që çelet nga gjaku.

*** Poeti është arbëresh, nga Italia.**

VOREA UJKO

EN ARBËRESH I ULQIN *

**Jag lyssnade på nattens musik
när den rasande vågen kom
Alla färger bleknade
och månen hukade sig
bakom träden
Här har jag inget hem
ändå känner mig inte främmande.
Jag skulle kyssa på pannan
flickan som knackar på dörren
och frågar på mitt språk
om jag vill ha kaffe
Hon tänker kanske
att jag lärt mig språket
för resor runt om i världen
och hon vet inte om den hemlighet
som öppnas ur blodet.**

*Poeten är alban, men tillhör en gammal albansk minoritet i Italien.

*Ulqini, en stad vid Adriatiska kusten bebodd av albaner.

TI JE E BUKUR

**Ti je e bukur mojë vashë,
por dashuria ndërmjet nesh
ajo është e pamundur
pse, ta themi midis nesh,
dashurova mëmën tënde
që ishte e bukur porsì ti.**

DU ÄR VACKER

**Du är en vacker flicka, du
men kärleken mellan oss
den är omöjlig
- och låt det stanna mellan oss -
för att jag älskade din mor
som var lika vacker som du.**

VETMI

**Qytetet janë kuvende
ku na jetojmë pa thirrje
në vrull të maqinave
e në njëmijë antena
askush s'e merr
thirrmën time për shpëtim.
Kur unë të bie përdhe
i zhytur në gjak,
do të jem vetëm një maqinë
që ngatërron trafikun
e do të dëgjoj fishkëllimën
sepse jam nën kundravajtje.
Do të bëj miqësi
me qenin rrugaç
që takovan në periferi.**

ENSAMHET

**Städerna är församlingar
där vi bor utan att vara inbjudna
i bilarnas brådska
och i tusen antenner
tar ingen emot
mitt rop om frälsning.
När jag faller till marken
dränkt i blod,
kommer jag att vara bara ett fordon
som hindrar trafiken
och jag kommer att höra pipans visslande
för jag bryter mot reglerna
Jag kommer att bli vän
med en hundracka
som jag träffade i förorterna.**

SITUATË E DYTË

**Gjatë urës s'autorrugës
grumbull sorrash të patundura
midis vrullit të makinave.**

**Janë shumë të lodhura
e s'duan të fluturojnë më
në erë të rralluar.**

**Kanë marrë sëmundjen e njeriut
dhe presin të përulura
shortën fatale.**

**Nuk ka më rrëqethje
edhe vdekja e humbi misterin.**

Ju lutem të mbroni vdekjen.

ANDRA LÄGET

**Längs bron på motorvägen
en grupp orubbliga kråkor
mellan de framrusande bilarna
De är väldigt trötta
och vill inte flyga längre
i den tunna vinden.
De har fått människans sjukdom
och väntar ödmjukt
på sitt ödes lott
Det finns inte längre ens en rysning
även döden har förlorat sitt mysterium
Jag ber er skydda döden**

SITUATË E TRETË

**Macet shoqe të dashura
të mbrëmjeve dimërore
të shkretët qenë besnikë
të dhjetuar buzës së autorrugës
lecka të turpshme
mishin të përgjakshëm
ku natën brejtës të kujtueshëm
e mbarojnë hakmarrjen.**

**Pastaj gjithçka
do të jetë serë.**

**Nën rrotat e makinës
besnikëri dhe miqësi.**

Vetëm bitum.

**E unë po shkoj përpara
në varrezat e pamatura
njerëzish dhe kafshësh
nën varrezat e ndjenjave.**

TREDJE LÄGET

**Katterna är kära vänner
till vinterkvällarna
de stackars trogna hundarna
ligger dödade på motorvägens kant
likt skamliga trasor
av blodigt kött
där uppmärksamma gnagare på natten
avslutar hämnden.
Sen kommer allt
att bli till växthus.
Under bilarnas hjul
trofasthet och vänskap.
Bara asfalt.
Och jag fortsätter framåt
till de stora gravplatserna
för människor och djur
under känslornas kyrkogård.**

SITUATË E KATËRT

**Sonte s'e ndiej veten mirë.
Kam vrarë pesë zogj...
Porsa kishin dalë nga çerdhja
dhe bënin hapat e parë
në det të lirisë.
E unë ua hëngra erën
dhe u përplasën
në baltëmbrojtësin.
Kështu mora pjesë
në gjakderdhjen e përditshme.
Liria nëpër ujq
nuk është e këshillueshme.**

FJÄRDE LÄGET

**Ikväll mår jag inte så bra.
Jag dödade fem små fåglar ...
De hade just kommit ut från sitt fågelbo
för att göra sin första färd
i frihetens hav.
Det var jag som tog deras vind
och de kraschade
mot strandvallen
Så jag deltog
i den dagliga blodsutgjutelsen.
Frihet bland vargar
är inte tillrådligt.**

ZEF SKIRO DI MAXHO *

VAZHDIMËSI

**Vazhdat dritëdhënëse
të ëndrrave
lidhen e çahen
me natë.**

**Bashkë me këmishën
ti vesh
edhe mendimet e përditshme
e të hollën melankoli
të jesh
përsëri.**

*** Poet arbëreshë i Italisë**

ZEF SKIRO DI MAXHO *

KONTINUITET

**De lysande spåren
av drömmar
länkas och bryts
i natten.**

**Tillsammans med skjortan
klär du på dig
de vardagliga tankarna
samt den tunna melankolin
av att finnas
på nytt.**

*** Poeten tillhör den gamla albanska minoriteten i Italien**

QIELLI I PANGJYRË

Syri

**përkëdhel majet
e maleve
dhe i hedhe profilet
në një qiell pa ngjyrë.**

Bota

**është mozaik
që shihet nëpër degë
të një manduleje.**

**Rri në një profil guri
të gjej prehje
larg nga mendimet.**

FÄRGLÖS HIMMEL

**Ögat
smeker bergens
krön
och kastar deras profiler
upp mot en färglös himmel.**

**Världen
är en mosaik
sedd genom grenarna
på ett mandelträd.**

**Jag blir kvar i en profil av sten
för att finna tröst
bort från mina tankar.**

MENDIMI

**Dielli me ndjek pas
duke korrur ullinj.**

**Era
luan me ne.**

**Ne jemi gëzimi
i neve vetë.**

**E dielli
ulliri
era
na duken të gëzuar për ne
somenatë
por dëfren
për vetëveten.**

TANKEN

**Solen följer efter mig
och skördar oliver.**

**Vinden
leker med oss.**

**Vi är glädjen
för oss själva.**

**Och solen
olivträdet
vinden
verkar vara glada över oss
idag på morgonen
men roar sig
var för sig.**

POEZI

**Je ujë i kthjelltë
ngjyrë gurëzish të latuar
dell i tje dukshëm
qiell e re
Me sy të hapur
kredh
nurin tim.**

**Fijet e barit
nëpër gurëz
janë buzë që flasin
pa përgjigje.**

**Ti je si një valë e butë
që m'i tretë mendimet.**

**Vërej pastaj gjithëçka
si për herë të parë.**

POESI

**Du är klart vatten
färg av huggna stenar
en åder, genomskinlig
himmel och moln
Med öppna ögon
sköljer du
mitt anlete.**

**Grässtråna
bland gruset
är läppar som talar
obesvarat.**

**Du är som en mild våg
som smälter mina tankar.
Då ser jag allting
som för första gången.**

I HUAJ

**Bëhesh qesharak
duke i ndjekur trenat
makinat...**

**Dhe në ty mendimi
i përkohëshmërisë
së pranishme.**

**Por ndoshta s'është vështirë
jeta në dhe të huaj
për atë që është i huaj
për vetvete.**

FRÄMLINGEN

**Löjlig blir du
när du följer tågen
bilarna...**

**I dig – tanken på
förgänglighetens
närvaro.**

**Men kanske är det inte svårt
livet i ett främmande land
för någon som är främmande
för sig själv.**

ZEF ZORBA

NË VEND TË HYRJES

**I errët ky shteg. Nuk mundem
rrugën me e gjetë pa dritën
tande. (Çka më sëmbon?)**

**Në cep të greminës,
që josh e ngujon,
a nuk e shef si po lëkundem?**

ZEF ZORBA

ISTÄLLET FÖR INLEDNING

**Denna stig är mörk. Jag kan inte
hitta vägen utan ditt
ljus. (Vad är det som skär i mig?)**

**På kanten av avgrunden,
som förför och fångslar,
ser du inte hur jag vacklar?**

KRUJA *

(e parë nga Fushë-Kruja*, natën)

Gjerdan margaritarësh

mbi gjoksin tënd

t'irnuar

o atdhe

*** Fushë-Kruja, një qytetzë, afër Krujës.**

KRUJA *

(Sett från Fushë-Kruja, på natten)**

**Ett halsband av pärlor
på ditt smutsiga
bröst
mitt hemland**

*** I staden Kruja, levde under medeltiden, albanernas kung
Georg Kastrioti - Skanderbeg, som kämpade hjältemodigt
mot den turkiska invasionen.**

**** Kruja-Fältet är ett mindre samhälle nära Kruja i Albanien.**

PËRTEJ

Kjo botë (ruajna Zot!) e rrëshqitura!

Mbi ledhe të fildishta

rreh dielli thik,

e na lëbyrën sytë

në kundrim të ngulitur

përtej...

e mbesim shtang.

HINSIDES

Den här försåtliga världen (måtte Gud skydda oss!)

Mot murar av elfenben

hugger kniven solen ,

och vår blick grumlas

av vårt oavlåtliga betraktande

där bortom ...

och vi står förstelnade.

SONTE FESTË

**Sonte festë: shi me shtrëngatë,
bubullimë e erë e lezhjane *.
(Hënë nuk ka.)**

**Mbi çimento para meje
rrahin pikat me furi,
thyhet breshëri porsì kripa:
e çimento, si unë si ti.**

*** Lezha, qytetëz në Veri të Shqipërisë.**

I AFTON FEST

**I afton fest: regn och storm,
åska och vind typisk för Lezha *.
(Ingen måne lyser.)**

**Mot cementen framför mig
trummar regndropparna våldsamt
hagel krossas till salt:
cement, jag är som du.**

*** Lezha, en stad i norra Albanien.**

PA ELEMENT

**Sado të largohemi
o dhimbje,
mos ti cekohesh?**

**Ç'e mjerë
kënaqësia jonë
dritëshkurtër.**

UTAN BESTÅNDSDELAR

**Ju längre vi kommer från varann
du och jag, min smärta,
kommer du då att tunnas ut?**

**Så ynkelig den är
denna vår kortsynta
tillfredsställelse.**

- ALEGRO FURIOSO -

**...e shpesh kam pa liqenin të shpupurishur
kundër reve të mbarsura
me shkrepëtira të dhunshme
me kordha shkumesh të parreshtura
me gjithë sa kishte frymë
sulmonte, e gërmushej;
por shi vazhdoi me ra...**

- ALEGRO FURIOSO -

**... och ofta såg jag den uppiskade sjön
mot de jagande molnen
med våldsamma blixtar
och med huggsablur av skum som oupphörligt
med all sin styrka
gick till attack, vrålande
men regnet fortsatte att falla...**

SI ZOGJ DALLËNDYSHEJE

**Tash muzugu sa me vrap
qullosë rrugën time
(telat e dritës diku janë çartë).**

**Prej trurit trishtimi
shkumëzon e shprazet
në gjymtyrët e këputura.**

Heq këmba këmbën zvarë.

**Si zogjtë dallëndysheje,
fëmi të lagjës
më shkasin anazh
plot shend-e-verë.**

SOM SVALORNA

**Nu kommer skymningen rusande
och genomdränker min väg
(ledningarna för lyset har någonstans brustit)**

**Från hjärnan blir sorgen
till skum som töms ut
i lemmar som lossnat.**

Det ena benet drar det andra efter sig.

**Som små svalungar
halkar barnen från kvarteret fram
runt omkring mig
fulla av glädje.**

MARTIN CAMAJ

FILL I GJETUN

**Natën që shkoi u fikën dritat e mbeti
qyteti në terr deri n'agim**

**Amviset kërkuen llampat vojguri
e s'i gjetën në terr.**

**Në nadjë ra dielli e zbeu
faqet e rrokaqiellëve.**

**Në nadjë vrejta rrethin e andrrave
në truell
e gjeta fillin e tretun
në pikën e ndaljes së dritës.**

MARTIN CAMAJ

DEN FUNNA TRÅDEN

**I natt slocknade allt ljus och staden
låg i mörker ända till gryningen**

**Husmödrarna sökte efter oljelampor
men kunde inte hitta dem i mörkret.**

**På morgonen steg solen upp och lyste upp
väggarna på höghusen.**

**På morgonen såg jag drömmarnas cirklar
på marken
och fann den tråd som försvunnit
Då ljuset släcktes.**

NJË ZOG LËNGON

**Libri i besimit të shpendve thotë:
çdo zog shtrin krahët e vdes mbi bar,
ndëshkim pse preku kufijtë e ndaluem
mes qiellit e dheut.**

**Nji zog lëngon për vdekje mbi bar:
gjethet ndër lisa janë zogj e shokë
të pambërrishëm
e lozin me dritë e diell**

**larg dy gur mullinjsh që bien
si mbas ligjit njeni mbi tjetrin
pa za.**

EN FÅGELS LIDANDE

**Boken med fåglarnas troslära säger:
varje fågel sträcker ut sina vingar och dör i gräset,
som straff för att ha berört de förbjudna gränserna
mellan himmel och jord.**

**En fågel lider sin död i gräset:
Bladen bland träden är fåglar och vänner
som inte kan nås
och som leker med ljus och sol**

**Långt borta, två kvarnstenar som faller
på varandra enligt lagen
utan ett ljud.**

VETMIA E JUGORES NË VERI

**Harroi se shtini kambë ndonjherë
n'ujin e njelmtë. Me sy në dritare
i tregon vetes përralla mbi foshnje
e djepe mes avullit përvlues
t'ullishtave.**

**Vjen hana
e nis udhtimin televizori nëpër botë
në heshtje deri në mesnatë.
Mandej sheh andrra si rriten
dega lisash ndër krahë.**

ENSAMHETEN I NORR HOS KVINNAN FRÅN SÖDRA ALBANIEN

**Hon glömde att hon en gång satt ner sina fötter
i det salta vattnet. Med blicken mot fönstret
berättar hon för sig själv sagor om barn
och vaggor bland olivträd i ångande hetta.**

**Månen kommer
och tv börjar sin resa världen runt
och hon sitter tyst fram till midnatt.
Sedan ser hon i drömmen hur grenar
från olivträd växer ur hennes armar.**

NATA E KONCERTIT

**As bora nuk asht e bardhë në këtë muzg.
Gjindja me kambë të randa vrapon
kah dritaret e tingullit.**

**Në sallën e koncertit edhe diktatorët
marrin vesh masën e instrumenteve...**

**Në sallën e koncertit edhe dirigjenti
symbyll s'pau tjetër pos tingujsh
të ndezun brenda një rrotulle terri.**

AFTON MED KONSERT

**Inte ens snön är vit denna solnedgång.
Människorna springer med tunga steg
mot ljudets fönster.**

**I konsertsalen fattar till och med diktatorer
instrumentens omfång ...**

**I konsertsalen såg ej heller dirigenten
med slutna ögon någonting förutom de ljud
som tänts inne i mörkrets cirkel.**

TRAJTA

**Petk i endun prej nji dore
fund e krye, trajta,
e kandshme për sy e veshë.**

**Trajtë e thjeshtë e lindun
ndër mundime prej guri,
e përshkueme shtigjesh të parrahuna
me kambë ose patkoj.**

**Pendël e lehtë në dukje
po e randë hekur në peshë,
tingull ose ngjyrë
e kthjellët deri në dritë.**

FORM

**En dräkt helt sydd av samma hand,
en form, behaglig
för ögon och öron.**

**En enkel form, född
under möda ur en sten
forklad på obandade stigar
som varken fot eller hästsko beträtt.**

**Lätt som en fjäder till synes
men tung som järn i sin vikt,
ljud eller färg
klara ända intill ljuset.**

GJARPNI E GRUEJA

**Ajo mbramë harroi trupin e vet
zbuluet
e në mëngjes e gjeti pikturë të varun
në murin e gjanë dhetë pashë:
e kqyri e kqyri dhe u zhduk.**

**Petkat e saj teren buzë detit
me këmishën e gjarpnit mbi gurë.
Shtëpia tha se vjen prap, ajo,
deri mbasdite.**

**Mbasdite vonë, gjarpni i rrejtun
doli prej nëngurit
e iu zgerdhesh vetmisë ndërsy,
veshi këmishën e vjetër e shkoi
me fjetë.**

ORMEN OCH KVINNAN

**Igår kväll glömde hon sin kropp
blottad
och på morgonen fann hon en tavla
hängande på väggen, tio famnar bred,
hon tittade och tittade och sen försvann hon.**

**Hennes kläder torkar vid havet
tillsammans med ormens skjorta på stenar.
Hemma sade man att hon kommer tillbaka
tills på eftermiddagen.**

**Sent på eftermiddagen kom den bedragna ormen
ut från under stenen
och flinade ensamheten rakt upp i ansiktet
klädde på sig den gamla skjortan och gick
att sova.**

DËSHTIMI

**Nuk çova zanin në kor
aty ku duhej: prej frike, turpi?
“Atëherë, del jashtë! – Më tha mjeshtri.
– Del jashtë!”**

**Prej të mbramit rresht në fund
u shkëputa...
e njeha shkallët një nga një
deri në fund,
nën dhé
me peshën e njiqind syve në krahë.**

MISSLYCKANDET

**Jag höjde inte rösten i kören
när jag borde: av rädsla, skam?
"Gå ut då!" – sa dirigenten.
-Gå ut "!**

**Från den sista raden, längst bak
smög jag iväg ...
och räknade trapporna en efter en
till den sista,
nere i underjorden
med tyngden av hundra ögon i famnen.**

SHKODRA

**Aty si tash pra se me ardhë fiset
ishe
me tambël në plasaritjen e currave
e me themele në ujin e njelmë.
Të dhanë vetëm një emën: Shkodra.
E të thirrën qytet me kunora
e të hodhën përkrye gur
e hekurat e para.**

**U zgjove e përgjakun sa herë
e u kqyre në pasqyrën tande.
Me emën grueje u lave ndër ujna
t'lumejve dhe ndeje me petka të reja
në shkamb
e ndritun ballë diellit mbi fusha.**

SHKODRA *

**Då såsom nu, fanns du där förut,
sedan stammarna hade nått fram,
med mjölk och honung rinnande i dina älvar
och med grunden djupt ner under salta vatten.
De gav dig enbart ett namn: Shkodra
och kallade dig staden med kransarna
och kastade stenar på dig
och du fick de första handbojorna.**

**Du vaknade blodig gång på gång
och såg dig själv i din spegel.
Din kvinnliga stolthet tvättade du ren
i dina älvars vatten och med nya kläder stod du alltid
intill klipporna
skinande ljus under slätternas sol.**

*** Shkodra, nordligaste staden i Albanien, som kämpade
mot Romarriket, turkarna och montenegrinerna.**

NDËR MIJA TRAJTA IDEJA

**Prej dite në ditë një tingull
treqind e gjashtëdhjetë herë,
prej zgjimi në zgjim**

**frymë mali n'pullaz
ose trumcaku lypës meli
në dritare.**

BLAND TUSEN FORMER OCH IDEER

**Från dag till dag
tre hundra sextio gånger,
ett ljud som alltid väcker oss**

**bergens vind över taken
eller sparven som söker hirs
vid fönstret.**

ALTER EGO

**Nji zezak i verbët
me nji qen në mantel lëkure
mjedis kalldremit në qytetin e madh
të USA-s**

**qëndrojnë palëvizë në kambë.
Njerëzia u vjen rrotull
ujë rreth nji curri binjok
në zemër të lumit.**

**Ujë i larmë përreth plagës
në trupin e nji gjiganti.**

ALTER EGO

**En blind neger
med en hund i kappa av skinn
mitt på trottoaren i en storstad
i Förenta Staterna**

**båda står orörliga.
Folk rör sig runt omkring dem
vatten kommer ut från en fontän
mitt i floden.**

**Grumligt vatten runt såret
på kroppen av en jätte.**

NJË POETI TË SOTËM

**Rruga jote ashtë e mirë:
Parkat janë fytyrat ma të shëmtueme
të miteve klasike. Ti nuk shkrove për to,
por për rrasa guri e ballë njerëzorë
me rrudha shumë e për dashuninë.**

**Vargjet tua janë për t'i lexue në heshtje
e jo para mikrofonit
si të çetës së poetëve tjerë,**

**zemra
ndonëse nën shtatë lëkura
akull,
akull**

ndonëse nën shtatë lëkura.

TILL EN POET AV IDAG

Din väg är bra:

**Parkerna är de fulaste ansiktena
av de klassiska myterna. Du skrev aldrig om dem,
du skrev om stentavlor och mänskliga pannor
med många rynkor och om kärleken.**

**Dina verser är till för att läsas i tystnad
och inte framför mikrofonen
som andra poeters,**

**hjärtat
trots att det ligger under sju hudar
är iskallt,
iskallt**

trots att det ligger under sju hudar.

THA PIKTORI

**Tha piktori: "M'i jepni ngjyrat
jam i sëmutë.**

**M'i jepni ngjyrat të qes nga shpirti
nji lule të zezë
dhe flutura e bardhë që më sillet rreth kreje
të ndalet mbi te. M'i jepni ngjyrat!"**

MÅLAREN SADE

**Målaren sade: "Ge mig färger
jag är sjuk.**

**Ge mig färgerna så hämtar jag ut från själen
en svart blomma
och den vita fjärilen som virvlar runt mitt huvud
kommer att stanna på den. Ge mig färgerna! "**

TË PARËN LULE

Të parën lule që ndesha

Unë ty ta pruna.

A thue din lulja çka ne ndijmë për te?

Heshtojmë! Ajo kryeulun andrron

Livadhet që la.

DEN FÖRSTA BLOMMAN

**Den första blomman som jag stötte på
tog jag med till dig.**

Kan blomman ana vad vi känner för den?

**Vi tystnar! Med huvudet nedböjt drömmer hon
om ängarna som hon lämnade.**

FATOS ARAPI

KU ËSHTË KAINI ?

**Mbrëmë në rrugën e ngushtë tiranase
takova Abelin gulçues që pyeste:**

- Ku është Kaini?

**Se unë – thoshte Abeli – duhet të vdes,
patjetër duhet të vdes.**

A e ke parë Kainin?

**Në fushën e errët të gjakut
mbijnë dhe ecin ullinjtë.**

**Dhe ti më lëshon ndër duar
vdekjen tënde që thërret:**

Ku është Kaini?

FATOS ARAPI

VAR ÄR KAIN?

**Igår kväll på den smala vägen i Tirana
mötte jag Abel som flämtande frågade:**

- Var, var är Kain?

**För jag - sade Abel - måste dö,
det måste jag.**

Har du sett Kain?

**På blodets mörka fält
växer och rör sig olivträden.
Och du lämnar i mina händer
din död som ropar:
Var är Kain?**

MASHTROJNË HORIZONTET

Mashtrojnë horizontet në detin e hiçëve.

Kujtesat përmbysen në detin e hiçëve.

Anija shkallmuar mes dallgëve të hiçeve.

Humnerë nën humnerë tek unë,

Një S.O.S. ndizet-shuhet:

Shpëtoni

shpirtrat

e hiçeve.

HORISONTERNA BEDRAR

**Horisonterna bedrar på intighetens hav.
Minnena störtar ner i intighetens hav.
Fartyget bryts sönder bland intighetens vågor.
Avgrund under avgrund hos mig,
Ett S.O.S. tänds-släcks:
Rädda
tomma människors
Själar.**

TI DO VISH

Ti do vish e dashur, si s'do vish?

Kur e di se unë ty të pres

duke ndjer' frymëmarrjen e vetë mbrëmjes,

duke ndjer' frymëmarrjen e vetë pritjes,

duke ndjer' frymëmarrjen e vetmisë.

Ti do vish e dashur, si s'do vish?

Kur e di që unë po të mundnja,

rreth vetvetes rruzullin do vërtitnja,

si një portokall' në dorën time,

të rrjedhë koha shpejt

që ti të vish....

DU SKALL KOMMA

**Du skall komma, käraste, visst kommer du
när du vet att jag står här och väntar
mitt i själva kvällens andning
mitt i själva väntans andning
mitt i ensamhetens andning.**

**Du skall komma, käraste, visst kommer du
När du vet att om jag bara kunde,
skulle jag plocka jorden som en apelsin,
lägga den i handen, snurra runt runt runt,
så att tiden skulle ila, rusa, storma framåt
och du kom**

ÇAST BUZË JONIT *

**Dhe vargjet erdhën me ritme të kaltra
Ndër degë të tyre figurat e gjelbra
çelin - si gjethet nëpër portokalle.
Nën degëza vargjesh fëshfërijnë figurat,
Si mbrëmjes Jonit fletësat e ullinjve.
E mbusha gojën me erëra të Jonit,
ndjej nëpër dhëmbë kokrizat e jodit,
e shoh se si thyhen mirazhet mes valësh,
se si thërmohen përflakjet mes gurësh...
Dhe jam i tëri
grimca dritaresh e ngjyrash.**

*** Joni, deti jugor i Shqipërisë**

EN STUND VID JONISKA HAVET *

**Och verserna kom med sina blåa rytmer
Bland deras grenar gröna figurer
som öppnas - som bladen på apelsinträden.
Under versernas grenar viskar skepnader,
likt olivblad om aftonen vid Joniska havet.
Jag fyllde munnen med joniska smaker
och känner mellan tänderna korn av jod,
och jag ser hur hägringar bryts bland vågorna,
hur flimret smulas sönder mellan stenarna...
Och hela mitt jag
är bara smulor av speglingar och färger.**

*** Joniska havet, den södra delen av havet utanför Albanians kust.**

KA NJË RRUGË NË TIRANË

**Ka një rrugë në Tiranë
që nuk e njihni.**

**Kalo rrugën "Hakmarrja", pa kthyer kokën:
sajohen në ajër gjarpërinjtë e gjakut.**

Sapo hynë në "Urrejtje"

hidhe në ajër tri herë

tri shpirta ulliri – paqe dhe muzg.

Udhëkryqi i parë:

"Limoni harroi të lëshojë lule".

DET FINNS EN GATA I TIRANA

**Det finns en gata i Tirana
som ni inte vet om.**

**Du skall gå över "Hämndens väg", utan att se dig om:
där skapas i luften blodets ormar.**

Just när du kommer in på "Hatets gata"

**Släng då upp i luften tre gånger
tre olivkvistar - fred och solnedgång.**

Den första vägkorsningen:

"Citronträdet glömde att blomma"

E PAËNDËRRTA IME

**Më duhet një gjysëm ëndrre,
E paëndërrta ime.**

**Vë kokën në gjoksin tënd
e tani përplasem
te koka e një tjetri.**

Më duhet një gjysëm ëndrre.

**Shigjetat e orës së dorës
tutje i shtyjnë kalimtarët,
në ditë të rrëpirta tiranase.
Shpirtra, jo shpirtra që shkojnë...
Bri meje dikush flet me vete,
pa e kuptuar - besoj në rrëfimin e tij.**

**Dikush, prej zhgënjimi të egër,
mbërthen kryqe të reja.
I hedh një gjysëm leku *
Dhe blej kryqin tim.**

**Tani që ta ngre
Më duhet një gjysëm ëndrre,
E paëndërrta ime.**

* Leku, para e Shqipërisë.

DU, MIN DRÖMLÖSA

**Jag behöver en halv dröm,
du, min drömlösa.**

**Lägger mitt huvud på ditt bröst
och bums nu
vid en annans huvud.**

Jag behöver en halv dröm.

**Armbandsurets pilar
skjuter bort fotgängare
brådstörta dagar i Tirana.
Andar, inte själar som går ...
Nära mig pratar någon för sig själv,
utan att begripa – tror jag på hans prat.**

**I sin vilda besvikelse
sätter någon upp nya kors.
Jag slänger till honom en småslant
och köper mig mitt kors.**

**Och nu, för att resa det
behöver jag en halv dröm,
du, min drömlösa.**

*** Lek, den albanska valutan.**

DY PAS MESNATE

**Akoma s'i kemi shfletuar të gjitha
fletorkat e tragjedit tona.
Hedhur aty te këndi i dhomës,
prap mbeti një dëng...
Do t'i marrim me vete, andej,
në Ferr a Parajsë, - të lëçitim,
të englandisemi dhe të shtyjmë kohën.**

KLOCKAN TVÅ EFTER MIDNATT

**Vi har inte än bläddrat i alla
noteböcker av våra tragedier.**

**Kastade i hörnet av rummet där,
förblev en bunt...**

**Vi kommer att ta dem med oss dit,
till Helvetet eller Paradiset - för att läsa,
sysselsätta oss och få tiden att gå.**

NË KAQ PAK TIRANË

D.

**Në kaq pak Tiranë,
si mund të mbetesh kujtim,
si mund të kthehesh në mall.**

**Dhimbja e natës,
vetë natën e zgjon.
Si mund të bëhesh tragjedi...**

Në kaq pak Tiranë.

MED SÅ HÄR LITE TIRANA

D.

**Med så här lite, Tirana
hur kan du förbli ett minne,
hur kan du förvandlas till längtan.**

**Nattens smärta
väcker upp själva natten.
Hur kan du bli en tragedi ...**

Med så här lite, Tirana.

*** Tirana, huvudstad i Albanien**

MOS EJA NË ËNDËRR

Mos eja në ëndërr, e paëndërrta ime...

Ngopur me vdekjen e dashurisë

gjer në grykë, jam!

Edhe në gjumin e vdekjes

trembem nga britma ime

për ty.

Mos eja në ëndërr, e paëndërrta ime.

Mos e bëj shakanë e mbrëmshme.

Si ta duroj ditën,

që më sheh me sy ëndrre?

KOM INTE I DRÖMMEN

Kom inte i drömmen, du, min drömlösa...

**Mätt på kärlekens död är jag,
ända upp till halsen!
Även i dödens sömn
är jag rädd för mitt rop
på dig.**

**Kom inte i drömmen, du min drömlösa.
Kom inte med skämtet från igår.**

**Hur ska jag stå ut med dagen,
som ser på mig med drömmens ögon?**

QIPARISI IM...

**Qiparisi im që lëshohesh fluturon qiellit,
nëpër qiell fëfëllime dritë të kaltër,
si të të mbaj ndër sy
pa të përlyer?**

**Nuk isha unë krimi.
Ujkun e natës e pashë tek lëpihej,
sa ndjente erën e gjakut
të dashurive të mia të njoma.**

Si të mbaj ndër sy pa të fyer?

**Shiu i rimtë i prillit shliroi
siluetën tënde të ëndërrt.
Brerimë e lotëve të mia derdhet mbi ty.**

A janë ata të pastër?

MIN CYPRESS ...

**Min cypress som släpps loss och flyger upp mot himlen
på himlen flimrar blått ljus,
hur kan jag följa dig med blicken
utan att smutsa dig?**

**Jag var inte något brott.
Nattens varg såg jag slicka sig,
så snart han kände lukten av blodet
från min omogna kärlek.**

Hur kan jag följa dig med blicken utan att förolämpa dig?

**Det gråblåa aprilregnet befriade
din drömlika siluett.
Skurarna från mina tårar strömmar över dig.**

Är de rena?

E UNË BUZËQESHI

**Shkel në moskohë. Më çahen buzët,
thith gjakun më gjuhë.**

**I bëj shenjtë të ardhmes, - ajo
mbulon sytë me dorë.**

**Jam i tëri hutim,
e di: vdekja s'harron kurrë pikëtakimet.**

Moskoha rrëqethet tek unë.

**E unë buzëqesh duke rrufitur gjakun
e hidhur të njeriut.**

OCH JAG LOG

**Jag trampar på tidlösheten. Mina läppar spricker,
jag suger blodet med tungan.**

**Jag ger ett tecken till framtiden - hon
håller handen för ögonen.**

**Jag är helt i förvirring,
Jag vet, döden glömmer aldrig mötesplatserna.**

Tidlösheten ryser inom mig.

**Och jag ler medan jag hastigt dricker blodet,
det bittra människoblodet.**

MIHAIL HANXHARI

AJSBERG

Ajsberg i vetmisë

Kujtimi yt i bardhë flet me yllin e polit

Po dëshpërimi yt i heshtur nën ujë

Peshon më shumë se qielli

O peshk i vetëm

Ç'kërkon aq shumë në algat e zeza

Syri yt si lule fushe

Akoma s'e ka parë gjakun e diellit

Peshk i vetëm

Kur të shtrohet hëna përmbi errësirën

Metamorfoza e shpirtit do të ketë mbaruar

Lule polare do të vijnë nëpër gjumë

Dhe ti ngadalë do biesh në fund

MIHAIL HANXHARI

ISBERG

Ensamhetens isberg

Ditt vita minne talar med Polstjärnan

Men din tysta förtvivlan under vattnet

Väger tyngre än himlen

Du, ensam fisk

Vad är allt du kräver av svarta alger

Ditt öga som slättens blommor.

Du har inte ännu sett solens blod

Ensam fisk

När månen lägger sig över mörkret

Skulle själens metamorfos ha avslutats

Polarblommor framträder i sömnen

Och du kommer sakta att falla till botten

URË

**Ajo urë si dy vetë që dua të përqafohen
Njeriu në një breg tjetri në tjetrin breg
Dhe dot s'bashkohen**

**Ajo urë
Si një parqafim që nuk lidhet kurrë
Njeri në një breg tjetri në tjetrin breg
Përqafim e puthje bër gurë.**

Ajo urë.

BRON

**Den bron är som två människor som vill omfamna varann
Den ena på ena stranden och den andra på andra stranden
och inte kan förenas**

Den bron

Som en omfamning som aldrig blir av

**Den ene på ena stranden och den andre på andra stranden
Omfamning och kyss förvandlade till sten.**

Den bron.

PËR KË

Një ditë kujtohem

Që kemi tretur shpirtin në erën e çdo stine

Në verën e çdo lumi kemi derdhur shpirtin

E kemi nisur diku nëpër ujë

Si dhuratë dashurie

Dhe një ditë pyesim

Për kë për kë

O zemër

FÖR VEM

**En dag kommer vi ihåg
Att vi har slösat bort själen i varje årstids vind
I varje flods sommar har vi hållt ut vår själ
Vi har släppt ut den någonstans i vattnet
Som en gåva av kärlek
Och en dag frågar vi
För vem till vem
O mitt hjärta**

KJO DEGË

**Ç'mund të më sjellë kjo degë vjeshte
Më shumë se sa fillmin e heshtjes
Lumi tashti nuk ka më sy
Sytë e verës janë mbyllur
Sytë e verës janë mbytur
Përse s'kanë zë gurët
Ku t'i gjej fjalët që lashë nëpër breg të lumit
Një ishull që s'ka qenë më parë
Më shikon nga uji
Një copë dashurie
Më zgjat një dorë nga uji
O vjeshtë
Më ke hedhur krahët rreth qafës
Dhe gëlltis një lot pa zë.**

DENNA GREN

**Vad kan denna höstens gren skänka mig
Mer än början till en tystnad
Floden har inte längre ögon
Sommarens ögon har slutits
Sommarens ögon är döda
Varför har inte stenarna röst
Var kan jag hitta orden som jag lämnade på flodens strand
En ö som tidigare inte fanns
tittar upp på mig från vattnet
Ett stycke kärlek
Sträcker upp en hand ur vattnet
Ack höst
Du har slagit dina armar kring min hals
Och jag sväljer en tår utan ord.**

FIJE FIJE

**Vetëm vetëm duke menduar
Shoh jasht' nga qelqet për çudi
Se si dëbora ka filluar
dhe s'u besoj syve të mi**

**Dhe bora shpirtin ma mbuloi
Pranvera jonë vërtet u sos
Më ngjan sikur po dëgjoj
Tombel la neige të Adamos**

FLINGA FÖR FLINGA

**Ensam, tänkande i ensamhet
Ser jag förvånad genom rutan
att det har börjat snöa
och tror inte mina ögon**

**Och snön har täckt min själ
Våren tog verkligen slut
Det tycks mig som om jag lyssnar
på Adamos Tombe la neige**

NATË HESHTJE

Natë heshtje

Mund të dëgjohet

Kërcitja e lehtë e yjeve

Tek digjen atje lart

Nën urën e këputur

Lumi po shpie ngadalë

Një kurorë të shthurur

Që hëna hodhi përmbi lumë

Për shpirtin e urës së këputur

TYSTNADENS NATT

Natt, tystnadens natt

Där hörs

Ett lätt sprakande från stjärnorna

Medan de brinner där uppe

Under den trasiga bron

För floden långsamt med sig

En förstörd krona

som månen slängde ner i floden

till den trasiga brons ande

ISMAIL KADARE

ATDHEU

**Atdheu s'është
vetëm rëshqitja e rrombeve prej betoni
të pistës së gjatë të aeroportit,
kapota e ushtarit mes shiut e stuhisë,
një gotë konjak në sallat e barit plot rezonancë,
adresa shqip shoferit të taksisë.**

**Atdheu është
më i sigurt se kjo pistë betoni,
më ushtar se ky ushtar.**

**Atdheu është
lulet mbi varret e thjeshtë të të rënëve,
në sfondin e kuq të kryqeve dhe flakëve,
shamitë e zeza të nënave,
vargjet e pafund të refugjatëve me nofullat e kyçura,
sikur kanë kyçur në to
të fshehtat e kësaj toke.**

**Atdheu është
gjeneratat e shqiptarëve që përjetësisht lëvizin mes shekujve,
duke mbartur mbi supe këto kështjella të lashta si katafalke,
që po i çojnë, ngjyrë kuq e zi, në panteonin e lavdisë.**

**Atdheu është
betonarmeja e ëndrrave të vjetra e të reja,
muzgjet e shkuara dhe mëngjeset e ardhme.**

Atdheu është një milion diej mbi këtë tokë.

ISMAIL KADARE

FOSTERLANDET

**Fosterland är inte
bara romber av betong som står ut
på flygplatsens långa landningsbana,
soldatens rock i regn och storm,
ett glas konjak i barer och salar fyllda av genljud,
eller när du ger taxichauffören en albansk adress.**

**Fosterlandet är
säkrare än denna betonglandningsbana,
ståndaktigare än denna soldat.**

**Fosterlandet är
blommor på de fallnas enkla gravar
mot den röda bakgrunden av kors och eldar,
mödrarnas svarta sjalar,
ändlösa rader av flyktingar med sammanbitna käkar,
om de hade låst in i dem
denna jords hemligheter.**

**Fosterlandet är
generationer av albaner som oavbrutet rör sig - genom sekler,
bärande- på sina axlar dessa urgamla borgar som likbårar,
som de forslar, färgade i rött och svart, mot ärans panteon.**

**Fosterlandet är
en armerad betong av gamla och nya drömmar,
det förgångnas skymning och framtidens morgnar**

Fosterlandet är en miljon solar över denna jord.

ATJE LARG, NË VERI

**Atje në Veri,
atje larg nën retë bojë hiri
ndodhet një qytet me një emër të tmerrshëm,
të përgjakur.**

**Shirat bien parreshtur mbi qytetin verior, Gjakovë,
po, siç duket, nuk e lajnë dot gjakun nga fytyra e tij.**

LÅNGT UPPE I NORR

**Där uppe i norr
långt borta i fjärran under gråa skyar,
ligger en stad med ett fruktansvärt,
blodigt namn.**

**Regn faller alltid över den nordliga staden Gjakova, *
men det sköljer inte blodet från dess garvade ansikte.**

*** Gjakova, det blodiga fältet. Staden var alltid ett fäste
mot turkar och serber. Under kriget 1998-1999
dödade serbisk militär och polis över 1.275 gjakovabor.**

RETË

**Mes maleve tutje prej tokës lindore,
seç ra një ushtar nën plumbat mizorë.**

**As kryq nuk i vunë, s'e shtinë në tokë,
as nënë e as motër s'iu gjenden mbi kokë.**

**Veç retë që vinin që larg nga vatani,
e panë dhe e njohen, e zunë të qanin.**

MOLN

**I bergen långt borta i österland,
Dog en soldat för fiendens hand.**

**Man satte inte upp ett kors, fäste honom inte i jord,
Varken mor eller syster gav honom avskedsord.**

**Blott molnen från fosterlandet som kom ditåt,
Kände igen honom och fällde sin gråt.**

KITARISTI

**Kokën si shpellë e ka mbështetur mbi kitarë,
gjashtë tela si gjashtë udhë zgjatën në mugëtirë.
Ç'pe ashtu mbi tela, që me dorën e madhe
i re rëndë-rëndë
dhe e dëbove prej tyre?**

**Kë thirre vallë tjetër,
që menjëherë, ja,
iu përgjigj thirrjes sate dhe mbi tela erdhi,
duke shkelur lehtë e ëmbël,
gjersa shkau e ra
në gropën e kitarës
si në një hon të thellë?**

**Pastaj dora jote mbi telat mbolli lule
pastaj prej tyre shkundi
fletë të verdha.
Pastaj, për një çast
të shkretë telat mbetën.
Si udha dimërore, ku fryn veç era.**

**Kitarist,
mos i ler telat të ngrijnë,
shkunde dëborën prej tyre shkunde,
të mos bëhen telat rrugica të mbyllura
të jenë telat udhë të pafundme!
Dhe prapë mbi gjashtë telat ai dëbon e thërret.
Herë trishtimin e madh.
Herë harenë e madhe.
Mbi këto gjashtë udhë që e lidhin me jetën,
ngrihet kokë e tij si një shpellë krenare.**

GITARRSPELAREN

**Huvudet likt en klippa som vilar på gitarren
sex strängar som sex stigar löper ut i kvällen.
Vad såg du över strängarna som med handen
slog tungt
för att driva det bort därifrån?**

**Vem ropade du på
som genast, se där,
kom och landade på strängarna
med lätta och ljuva steg,
tills den halkade ner och störtade
i gitarrens hål
likt i en djup avgrund?**

**Sen strödde din hand blommor över strängarna
och skakade bort
gula blad.**

**Därefter, för en stund,
blev strängarna övergivna.
Likt en vinterstig där blott vinden viner.**

**Gitarrspelare
låt inte strängarna frysa,
skaka snön ifrån dem, skaka
stigarna får ej spärras av
låt strängarna vara ändlösa stigar!
Och åter driver han ut och tillkallar över sex strängar.
Än en stor sorg.
Än en stor glädje.
Över de sex stigar som binder honom till livet,
höjer sig hans huvud som en stolt klippa.**

PRITJA

**Telefoni po merr një sy gjumë para ardhjes sate
Abazhurët varen të heshtur mbi pritjen.
Përbindshat mbi qilimin e dhomës dremitin të qetë.**

Ora kaloi.

Ti u vonove.

Drita e abazhurëve u bë e keqe.

Si i vrarë telefoni ka rënë përmbys e s'merr frymë.

Tani përbindshat filluan të lëvizin,

ja, po zgjohen me leshra të kërleshura mbi qilim.

Ti do vish patjetër të qetësosh gjithçka.

VÄNTAN

**Telefonen har slumrat inför din ankomst.
Lampskärmarna svävar tysta över väntan.
Monstren på rumsmattan dåsar i stiltje.**

Klockan blev för mycket.

Du är sen.

**Ljuset från lampskärmarna lyser ondsint.
Som en död har telefonen fallit ihop och andas inte.
Nu börjar även monstren röra på sig,
se, de vaknar och reser ragg på mattan.**

Du måste komma nu för att lugna ner allt.

POEZIA

**Poezi,
udhën gjer tek unë si e gjete?**

**Mamaja ime shqipen mirë s'e di,
Letrat si Argoni i shkruan, pa pikë dhe presje,
Babi u end në rini në të tjera dete,
Po ti erdhe**

**Duke ecur nëpër kalldrëmin e qytetit tim të gurtë,
të qetë,**

**Trokitje drojtur në shtëpinë trekatëshe
Nr. 16.**

**Shumë gjëra kam dashur dhe çdashur në jetë,
Për shumë dëshira kam qenë citta aperta,
Por prapë
Si ai djali që kthehet vonë në shtëpi,**

**I lodhur dhe i shqyer nga bredhjet e natës,
Ashtu edhe unë, i lodhur përsëri
Pas çdo amatorie, jam kthyer tek ti.**

**Dhe ti,
Pa më mbajtur mëri për tradhëtinë
Më ke përkëdhelur flokë me ëmbëlsi,
Stacioni im i fundit,
Poezi.**

POESIN

Poesi

hur fann du vägen till mig?

**Min mamma kan inte bra albanska,
Breven skriver hon likt Argon, utan punkt och kommatecken,
Pappa gick i sin ungdom ut på de stora haven,
Men du kom**

**En vandring på gatorna i min lugna stad av sten
En tveksam knackning på dörren till trevåningshuset
Nr. 16.**

**Många saker har jag älskat och inte älskat i livet,
För många önskningar har jag varit città aperta,
Men lika fullt
som pojken som återvänder hem sent,**

**Trött och sliten - av nattvaket
Är jag också, och trött på nytt,
Efter varje amatörförsök har jag återvänt till dig.**

**Och du,
har utan att ställa mig till svars för mitt förräderi,
smekt mitt hår ömsint,
du min sista anhalt
Poesi.**

E SHKRUAR MË 31 DHJETOR

**Desha t'ju uroja sonte gjithë të mirat
Juve të dashurve,
Juve të mirëve,
T'u uroja maleve pleqëri të mbarë
Fushave dhe deleve – pjellori;
Oxhakëve – tym të zi,
Nënave – qumësht të bardhë,
Rrugëve – zhurma kalamajsh,
Të rënëve – qetësi.**

SKRIVET DEN 31 DECEMBER

**Jag ville önska allt gott ikväll
till er, mina älskade,
till er, goda människor,
Jag vill önska bergen en lycklig ålderdom,
Fälten och fåren - fruktsamhet;
Skorstenarna - svart rök,
Mödrarna - vit mjölk,
Vägarna - barnens glada sorl,
och till de fallna - frid.**

KUR TI TELEFONOJE

Telefonin nga gjumi i rëndë e i zi ti e zgjove

Më zërin e dashur, që dridhej ngrohtësisht.

Ishte dimër.

Unë isha fundosur

Në kolltukët e palëvizshëm pranë vetmisë.

U afrova te xhamat.

Jashtë binte shi.

Vështrova me mirënjohje telat e gjatë telefonikë.

Ata vinin nga larg, pa u ndaluar gjëkund, drejt e nga ti,

Nga aroma e flokëve të tu, nga vija besnike e buzëve,

Pa u ndalur e pa u pleksur me ylberët joshëse, rrugës.

Ti qaje?

Jo. Pika shiu të ngrohtë nga telat binin.

NÄR DU RINGDE

Ur sin tunga och svarta sömn väckte du telefonen

Med din älskade röst som darrade så varmt.

Det var vinter.

Jag var nedsjunken

I den orörliga fåtöljen nära ensamheten.

Jag närmade mig fönsterrutan.

Utanför regnade det.

Jag såg med tacksamhet på de långa telefonledningarna.

De kom från långt borta, utan att stanna någonstans,

direkt från dig,

Från doften av ditt hår, från dina läppars amorbbåge

Utan att stanna och utan att frestas av regnbågens förförelse,

på vägen.

Du grät?

Nej. Det var varma regndroppar som föll från ledningarna.

BESIM BOKSHI

LUMI I THELLË

**Rrëshqet ngadalë drejt detit të pafund
me gurgullimë të mbytur
si zë i shterrur i mordjes.**

**-Është lutje e moçme për një katarakt
pëshpëritin të trandurat fusha për anë.**

Lart, në majet e veta yjet qeshin e luhaten.

BESIM BOKSHI

DEN DJUPA FLODEN

**Den glider sakta ut mot det ändlösa havet
med en kvävd gurgling
som av dödens hesa röst**

**-Det är den gamla bönen om ett vattenfall
viskar darrande fälten invid floden**

Men högt där uppe i rymden skrattar och gnabbas stjärnorna.

NË PRITJE

**Kam pritur si shkëmbi,
si ylli skaj horizontit - në pikëllim,
vite me radhë.**

**Larg jam,
aty ku puthet jeta dhe vdekja -
aty i përtyp ditët e mia të gastarta...**

**Kur të vijë,
Ndoshta do të më gjejë të plakur
e s'do të mund të qesh si fladi i pranverës.**

**Të vdes, porse, nga gëzimi,
do të mundem.**

I VÄNTAN

**Jag har väntat som klippan,
som stjärnan vid horisonten - i sorg,
år efter år.**

**Jag är långt borta
där liv och död möts -
där tuggar jag mina förglasade dagar...**

**När du kommer,
kanske du möter en gamling
och kommer inte att kunna skratta som vårens vind.**

**Att dö, av glädje,
ja, det kommer jag att kunna.**

TË MËRKURËN

**S'do të më gjesh kurrkund
se unë jam jehonë që tani e tretur -
njeri që u linda të mërkurën.**

**E të mërkurën herët arrinë e diela e madhe
e i këput të gjitha këmbanat e jetës.**

**Sa afër ka qenë e marta!...
Mëkat!
Sa afër e enjtja!...**

**E ti, bir i së premtës fatlume,
kurrë s'do ta dish as përrallën
për njerëzit që lindën të mërkurën.**

**Sa afër e enjta!
Sa afër e marta!...**

PÅ ONSDAG

**Du kommer inte att hitta mig någonstans
för jag är det eko som redan förklingat -
en människa som föddes på onsdagen.**

**Tidigt på onsdagen kommer den stora söndagen
och börjar att ringa alla livets klockor.**

Så nära det har varit till tisdag!...

Så synd!

Så nära till torsdag!...

**Du, son till den lyckliga fredagen,
kommer aldrig att veta ens sagan
om de människor som föddes på onsdagen.**

Så nära torsdag!

Så nära tisdag! ...

PA URA

**Kur desha të kaloj matanë,
ura nuk kishte më.
Këndeje kam mbetur i mbërthyer për hijen time.**

**Kur e pata kohën të lodroj,
të gjitha poezitë e llastuara - matanë!
Këndeje i ka përmbledhur faqja e errët e hijes sime.**

**Këndeje, mik i dashur, vjen muzgu,
kupton?
e të kaplon ngadalë hija e çoroditur.**

**Muzgu sjell një poezi të qetë,
kur toka i jep shenja gjithësisë...**

**Atëherë merret vesh
se gjithçka është në rregull...
Edhe jeta e mbërthyer në brigje të çoroditura.**

UTAN BRO

**När jag ville gå över till andra sidan,
fanns inte bron längre.
Jag har blivit kvar, fast i min egen skugga.**

**När jag fick tid att leka,
fanns alla dessa självsvåldiga dikter – på andra sidan!
På denna sidan hade de täckts av min mörka skugga.**

**På denna sidan, käre vän, kommer skymningen,
förstå du?
och den fördärvade skuggan täcker dig långsamt.**

**Skymningen kommer med en lugn poesi,
när jorden ger tecken till universum ...**

**Då blir det förstått
att allt är sin ordning ...
Även det liv som är bundet vid de fördärvade stränderna**

UNË DUA

**Unë dua pikën kur gurin shpon
edhe borën kur ruan tokën nga acarimi.**

**unë dua diellin kur lëkurën përvëlon
edhe rrufenë kur qanë qiellin nga hidhërimi.**

**Unë dua... Ç'dua s'di as vetë.
Ndoshta dua veç hënën
që sheh gjithçka e s'flet.**

JAG TYCKER OM

**Jag tycker om punkten som genomborrar stenen,
och snön när den skyddar marken från frosten.**

**Jag tycker om solen när den bränner huden,
och blixten när den slår himlen i sin vrede.**

**Jag tycker om.. Jag vet inte själv vad jag tycker om.
Kanske tycker jag bara om månen
Som ser allt och håller - tyst.**

PRANVERA - DRITARJA IME

**Lagja qenka gjallë,
dritare ime e hutuar,
se prapë po ndihet gazi i fqinjit plak.**

**Ta arnojmë shpejt kullën e dashurisë
e me troha të shpirtit ta ruajmë kumrinë e mbramë,
se jeta paska shpërthyer rishtas zemrën për ne!**

**T'i shkundim hijet tona të rënduara,
dritarja ime,
se lagja zemërgjerë
paska nisur edhe një herë këngën e tretur!**

**Ku ma ke ndalur shikimin aq thellë,
dritare e zverdhuar,
për tri stinë më e moçme,
për tri stinë më e egër!**

**A na duhen më shumë kujtime
që me trohat e shpirtit
ta rrokim këngën e gjetur?**

Pranvera, dritarja ime e zemëruar

VÅREN – MITT FÖNSTER

**Kvarteret är fullt av liv,
mitt fönster förvirrat,
för på nytt hör jag glädjen hos min gamle granne.**

**Låt oss snabbt göra i ordning kärlekens torn,
med våra små stycken av själen skydda den sista duvan,
för livet har igen fått våra hjärtan att börja slå.**

**Låt oss kasta våra tunga skuggor,
mitt fönster,
för det hjärtevarma kvarteret
har än en gång börjat sjunga den förglömda sången!**

**Var har du fått min blick att stanna så djupt,
du gulnade fönster,
tre årstider äldre,
tre årstider vildare!**

**Behöver vi ännu fler minnen
för att kunna med våra små stycken av själen
på nytt ta upp vår återfunna sång?**

Våren, mitt förbittrade fönster

DIALEKTIKË

Ç'ka klasa punëtore që nxiton e shqetësuar?

Ç'ka qytetari që është strukur nën strehën private?

Dielli paska shkuar në anët e errta të botës

e qiellin e paskan kapluar vrimat e ambicieve të vjetra!

Klasa punëtore kalon në turnin e tretë,

rrapton himnin e saj tronditës

dhe nxjerr tym dezinfektues përpjetë.

Të nesërmen vjen dielli

e i jep mistri qiellit.

Qytetari freskohet në hijen private

Klasa punëtore kalon në turnin e parë...

Gjer në orën dy...

Pastaj bën roje...

DIALEKTIK

Vad bekymrar arbetarklassen som oroligt rusar kring?

Vad bekymrar medborgaren som sitter där under privat tak?

Solen har begett sig till jordens mörka sidor

och himlen har uppfyllts av den gamla ärelystnadens hål

Arbetarklassen går till tredje skiftet,

sjunger sin rörande lovsång

och låter desinfektionsrök spruta uppåt.

Nästa dag kommer solen

och ger spackel till himlen.

Medborgaren svalkar sig under den privata skuggan

Arbetarklassen går till första skiftet ...

Till klockan två ...

Efteråt står den på vakt...

KU MË GJETE ?

**Ku më gjete tani në fund të shekullit
ylli im i flakëruar**

**Më shikon e dridhesh
po as keq s'i bëra njeriu
as keq ylli im**

**Se mori vapë në udhëtimet e mia
e m'u shterr zëri
Se frëngëlluan armët e muzeve
e m'u tret shkëlqimi i syve**

**Ku më diktove se jam yti
këtu në fund të botës
mbështetur për murnaja të Kinës**

**Ma paske përgjuar zërin e shpirtit
urave
brigjeve**

**Më shikon e dridhesh
Të shikoj e dridhem
Të shikoj e zbehem
Në fund të shekullit**

VAR HITTADE DU MIG ?

**Var hittade du mig nu vid sekelskiftet
min brinnande stjärna?**

**Du tittar på mig och darrar
jag gjorde ingen människa något ont
inget illa min stjärna**

**Det blev varmt under mina resor
och jag förlorade rösten
för museernas vapen svingades
och jag förlorade mina ögons glans**

**Hur du förstod att jag var din
här vid världens ände
stödd mot den kinesiska muren**

**Du har avlyssnat min själs röst
på broar
på kusterna**

**Du tittar på mig och darrar
Jag tittar på dig och darrar
Jag tittar dig och bleknar
Vid sekelskiftet**

ËNDËRRAT E MIA S'FLUTUROJNË MË

**Po më doli deti përpara
nga t'ia mbajë
po më doli bora**

**Po më doli bora
gjurmët ku t'i fsheh**

Vetëm shpezët e egra shpëtojnë

**Ulurima po afrohet
Ëndrrat e mia s'fluturojnë më**

MINA DRÖMMAR FLYGER INTE LÄNGRE

**Om havet plötsligt dyker upp framför mig
vart skall jag ta vägen
om snön plötsligt dyker upp**

**Om snön dyker framför mig
var kan jag dölja mina spår**

Bara vilda fåglar kan undkomma

**Skrikandet närmar sig
Mina drömmar flyger inte längre**

BREGUT TË LUMIT

**Në mbrëmje dal bregut të lumit
E futem ngadalë në errësirë
Në errësirë të gurgulluar rri me kujtimet e mia**

**Në mbrëmje unë e lumi futemi në errësirë
Ai me gurgullimë kërkon legendat e humbura
Unë me heshtje - kujtimet e harruara**

Në mbrëmje rri bregut të lumit e plakem

PÅ FLODSTRANDEN

**På kvällen går jag vid flodstranden
och långsamt går jag in i mörkret
I det gurglande mörkret sitter jag med mina minnen**

**På kvällen går jag och floden - in i mörkret
Floden med sitt gurglande söker de förlorade legenderna
Jag med min tysthet - de glömda minnena**

På kvällen sitter vid flodstranden och åldras

MURTEZA NURA - XAJA

E KAM NË ZEMËR

Perëndinë e kam në zemër

Ma shëron vetminë dhe heshtjen e thellë

M'i rimbjellë Urdhërat e Shenjta

Më ndanë sigurt prej kafshërisë

Fanarin e lumturisë ma mbanë të ndezur...

Nuk ma errëson mendimin...

Ma vizaton Frymën e Shenjtë

Të jem i bukur si jeta

Të më mbajë për dore engjëlli kujdestar

Nuk kam arsye të mos jem i lumtur

MURTEZA NURA - XAJA

JAG HAR I HJÄRTAT

Gud har jag i mitt hjärta

Han botar min ensamhet och den djupa tystnaden

Han inpräntar i mig om och om igen de Heliga Buden

Stadigt håller han mig borta från det bestialiska

Han håller min lyckas fyrbåk tänd ...

Han skymmer inte mina tankar...

Han tecknar för mig den Helige Ande

För att vara vacker som livet

För att min skyddsängel ska hålla min hand

Jag har ingen anledning att inte vara lycklig

KU TA GJEJË ATË FJALË?

Ku ta gjejë atë fjalë

Që t'i vret paudhësitë

Ilaqët eliksir që shëron zheben e kohës

Frymën e ngrohtë që t'i shkrinë ngricat

Kutinë e tjetërsimit të tabllës së fatit...

VAR KAN JAG HITTA DET ORDET ?

**Var kan jag hitta det ord
som dödar missgärningar**

Läkemedlet-elexiret som läker tidens skabb

Den varma ande som smälter frosten

Alienationens låda i ödets tavla...

MA MERR MENDJA

Poezia është desert me eleksir...

Në poezi tokëzohen yjet ...

Mbi të shartohen purpurët me ylberë...

Flasin gjethet e ëndrrës e shpresës

Brengat palosën nëpër kujtime

Poezia moti është divorcuar me djallin.

JAG ANTAR

Poesin är en dessert med elixir

I poesin jordas stjärnor ...

På den ympas purpur med regnbågen ...

Där talar drömmens och hoppets blad

Bekymren viks ihop bland minnena

Poesin har för länge sedan tagit skilsmässa från djävulen

OPOZITARI

Gjithsesi në kafaz të margjinës

Në cilësi të gladiatorit...

Me epilogje të humbësit

Si dordolec mes arës me thekër

I tremb korbat...

Mediton për të tjerët

Në kafazin e margjinës

OPPONENTEN

**Ständigt i marginalens bur
står du där som en gladiator...**

Med förlorarens epiloger

Som en fågelskrämma ute i rågåkern

Skrämmer du kråkorna ...

Mediterar för andra

I marginalens bur

PO TË ISHA POET

**dashurisë do t'i bëja skalitje
me aromë purpure
qiellin blu do ta shkruaja
me diellyje
damarët e njeriut vertikal
do t'i mbushja me balsam dheu
në kopsht do të shartoja
zogj e lule për shqisa
në bebëza do të bëja
qendisma me agime brezash
ku ta di se çka tjetër do të bëja
të isha poet jashtë ëndrrës**

OM JAG VORE POET

**skulle jag pränta in i kärleken
en arom av purpur
på den blå himlen skulle jag skriva
med solstjärnor
ådrorna på den vertikala människan
skulle jag fylla med jordens balsam
i trädgården skulle jag ympa
fåglar och blommor för sinnena
på ögonens pupiller skulle jag
brodera släktledens gryningar
och vem vet hur mycket annat jag skulle kunna göra
om jag vore poet utanför drömmen**

VETËM FAJI

**mjerisht në errësirë ballkanike
derivat i Evropës anemike
verb frymëzimi i eposit pagan
emblemë me hiroglife province
zoti sheh po s`ka ç`bën
zari humb e letra djeg
daullet trumbetojnë**

ENDAST SKULDEN

i Balkans dunkel -

en produkt av den anemiska Eurovärlden

ett ord inspirerat av det hedniska eposet

ett emblem med provinsens hieroglyfer -

ser Gud allt men kan tyvärr inget göra

tärningen slår fel och papperet bränns

trummornas dunkande breder ut sig

KËNDEJ GARDHI

**në fontanë mozaiqe të nemitura
fontana loton -bën kujën prore
mbi të bilbili vetmitar
shpalos membranë të ferkut
në kupa na ligjëron e bekuara
vajton dikë diçka në të gdhirë
kuptojmë këngën magjepëse
nga lulet mbledh aromat
shpirtit i bën nektar e balsam
në horizont kalashnikovi bën qepjen e tmerreve
me dritën e vrarë dhe zëbilbilin bonjak**

PÅ DENNA SIDAN STAKETET

**i fontänen förstummade mosaiker
fontänen fäller tårar – gråter ständigt
över den låter en ensam näktergal
sina stämband dallra**

**I koppen läser vi en välsignad utsago
någon sörjer något i gryningen
vi förstår den förtrollande sången
från blommorna samlas dofterna
och blir till nektar och balsam för själen
vid horisonten hackar en kalasjnikov fram skräcken
I det slocknade ljuset och i näktergalens förtvivlade röst**

AGIM GJAKOVA

VARROSJA E LETRËS

**në Paris varrosa një letër
ceremoni ndriçimesh të përbindshme,
nuk di kujt ia çoja
nuk mbaj mend kur e shkrova
atë mbrëmje u dha lajmi nga radiotelevizioni**

**në mëngjes gazetat njoftuan
keni parë njeri që varros një letër pa e lexuar!**

**u kujtova të hedh një gur
që të fillonte një muranë.**

AGIM GJAKOVA

BEGRAVNINGEN AV PAPPERET

**i Paris begravde jag ett brev
en monstruös belysningsceremoni,
jag vet ej till vem jag skickade det
jag minns ej när jag skrev det
den kvällen kom nyheten från radio och TV**

**på morgonen rapporterade tidningarna:
har ni sett en människa som begraver ett brev utan att läsa det!**

**jag kom ihåg att kasta en sten
för att bli början till ett röse**

NUK KENI ME MË GJETUR

**nuk keni me m'gjetë as në tokë as në qiell
e kam fshirë nga fjalori i jetës mortjen...
kam mburrur veten s'e di me kuptue pezmin
që ngërthen mitin e pushtetimit
fryti më i lavdëruar i ferrit tokësor**

NI KOMMER INTE ATT HITTA MIG

ni kommer inte att hitta mig, varken på jorden eller i himlen

jag har tagit bort ur livets ordbok döden...

**jag har berömt mig själv att jag kan förstå ilskan
som innefattar myten om makt**

den mest prisade frukten i det jordiska helvetet

PROMOVIM LETRAR

**dashnorja e parë më thur lavde buletinesh
kërrusem në koshin e radiotelevizionit
dhe e mistifikoj veten sinqerisht
fallkritiku i parë më praron me ngrehinë publike
mbështillem me llojloj gazetash të ditës
dhe e ngjyros veten përçudnisht
pushtetari i parë ma shndërron vuajtjen në ëmbëlsi
zhytem në kolltukun pronësi të shtetit
dhe filozofoj mbi kotësinë përdhunisht
lavdi zotit që s'kam shkruar më shumë libra.**

LITTERATURFRÄMJANDET

**min första flickvän öser över mig beröm från bulletiner
jag böjer mig över TV-korgen
och mystifierar mig själv uppriktigt
den första orakelkritikern förgyller mig med en offentlig struktur
jag ikläder mig en rad olika dagstidningar
och färgar skamlöst mig själv
den första makthavaren förvandlar mitt lidande till salighet
jag slår mig ned i en fåtölj ägd av staten
och filosoferar våldsamt om meningslösheten
tack och lov att jag inte har skrivit fler böcker.**

Ç'ËSHTË AJO QË MUNGON

**nuk u ndodha kur u ndanë kolltukët
tash më mungon jorgani
nuk arrita pranë kasafortës
tash më mungon kuleta
nuk u ngjita në zulm të famës
tash më mungojnë këpucët
nuk e di kush m'i shpëlau mendtë!**

VAD ÄR DET SOM SAKNAS

jag var inte närvarande när fåtöljerna delades ut

nu saknar jag täcket

jag kom inte nära kassaskåpet

nu saknar jag plånboken

jag klättrade inte upp på berömmelsens krön

nu saknar jag skor

Jag vet inte vem som sköljde bort mitt sinne!

MUZGU

**m'u kujtua vdekja dhe i dhashë fund jetës
u shtriva në varr dhe ndeza qiriun e vetmuar
yjet u gremisën, ranë xixëllonjat
shpërfillshëm dielli m'i mbylli qepallat
kafshova dheun - përbetimin e amshueshëm
i lava mëkatet dhe u ngrita nga varri.**

SKYMNING

**jag kom ihåg döden och gjorde slut med livet
jag lade mig i graven och tände det enda ljuset
stjärnorna störtade ner, lysmaskarna föll
solen stängde föraktfullt mina ögonlock
jag tuggade jorden – vår odödliga trohetsed
Jag tvättade mina synder och uppstod ur graven.**

HABIA

**nga anija kozmike zbritën alienët
dhe kërkuan vjershat e mia
të gjitha ia kisha dhënë të dashurës
atëherë ata ma morën engjëllin e dashurisë
dhe u ngjitën përsëri në qiell.**

FÖRVÅNINGEN

**från rymdskeppet kom utomjordingarna ut
och bad om mina dikter
jag hade gett alla till min älskarinna
då tog de ifrån mig min kärleks ängel
och steg på nytt upp mot himlen.**

MITI I DYTË

**shtatë ditë e net përsërita me vete
se jam njeri
iu ofrova zotave të më bëjnë të shenjtë
m'u thanë këmbët
iu afrova njerëzve të më bëjnë dreq
m'u mpinë duart
e vendosa kokën time në tempullin e kohës
m'u thinë flokët
atëherë më ndodhën mrekullitë
kur gjithçka u shemb.**

MYT NUMMER TVÅ

**i sju dagar och sju nätter upprepade för mig själv
att jag är en människa
jag erbjöd - gudarna - att göra mig helig
de lät mina ben förtvina
jag erbjöd - människorna - att göra mig till skurk
de förlamade mina händer
jag lade mitt huvud i tidens tempel
mitt hår grånade
då inträffade ett mirakel
när allt kollapsade.**

MARRAMENDËSE

**po të bëhesha shtatore
qentë do të vinin të pshurrnin
te këmbët e mia.**

YRSEL

**om jag blev en staty
skulle hundarna komma och pissa
mot mina fötter.**

MITI I SË ARDHMES

**Ndoshta do ta ndieja veten tepër të gëzuar
sikur bota të ishte e rrafshët
në vend të priftërinjve
në turrë të druve
do të më digjnin kozmonautët.**

MYTEN OM FRAMTIDEN

**jag skulle kanske känna mig mycket lycklig
om jorden var platt
istället för prästerna
skulle astronauterna ha bränt mig
på ett bål av ved**

NË MJEDISËT E KOSOVËS

**ka që i bien kavallit me një vrimë
ka që i bien vrimës
me një kavall...**

I KOSOVAS TRAKTER

**Där finns de som spelar flöjt med ett hål
och där finns de som spelar i hålet
med en flöjt...**

DIN MEHMETI

PO VJEN NJË PUHIZË

**Po vjen një puhizë
mes gjetheve
për ta puthur ballin tëndë**

Flij ylli im flij

**Një rreze po zbret
nga qielli
për t'u dhënë syve dritë**

flij drita e shpirtit flij...

**Rritu rritu, bir edhe pak
dritë e ke shtrojen
mbulojën dritë e ke**

Flij toka ime e bulëzuar flij

DIN MEHMETI

DET KOMMER EN SVAL BRIS

**De kommer en sval bris
mellan blad
för att kyssa din panna**

Sov min stjärna, sov

**Från himmel kommer ned
ett stråle
för att ge ljus till ögonen**

Sov själens ljus, sov...

**Väx min son, bara lite till
ljuset är din säng
ditt täcke är ljus**

Sov min spirande jord, sov

ËSHTË DIKU NË MUA NJË PYLL

**Është diku në mua një pyll
ku jetohet zi e vdiset kuq**

**Herë i tharë deri në klithje
herë i gjethuar deri në këngë**

**Thellë në të kafshohen
mes veti stuhitë
e ulurijnë drunjtë**

**jeta fshihet pas vdekjes
vdekja pas jetës
e një Zot e di ç'ngjet**

**Atje paqërojnë dhëmbët e mprehtë
më të bukur për ta bërë këtë botë**

DET FINNS NÅGONSTANS I MIG EN SKOG

**Det finns någonstans i mig en skog
där man lever svart och dör rött**

**Ibland torkande fram till ett skrik
ibland lövrik fram till en sång**

**Djupt där inne biter
stormarna varandra
och träden vrålar**

**Livet döljs bakom döden
döden bakom livet
det är bara Gud som vet vad som händer**

**Där skapas fred av vassa tänder
för att göra denna värld vackrare**

KUR VDIQA LINDA UNË

**sa herë hyra në terrin tim
preka në dritën tënde**

lart në qiell u ndez një yll

**sa herë hyra në dritën time
preka në terrin tënd**

**poshtë në tokë u fik një zjarr
e vdiqa e linda unë**

NÄR JAG DOG FÖDDES JAG

**varje gång kom in i mitt mörker
rörde jag vid ditt ljus**

uppe på himlen tändes en stjärna

**varje gång jag kom in i mitt ljus
rörde jag vid ditt mörker**

**där nere på jorden slocknade en eld
och jag dog och föddes igen**

DIMËR I AKULLT

**Hëna sy i ngrirë
vështron në horizont**

është dimër i akullt

**rrshqitmë u bë qielli
rrëshqitmë toka**

jeta jonë thyen qafën

ISVINTER

**Månen ett fruset öga
blickar vid horisonten**

det är en isig vinter

himlen i halka

jorden i halka

vårt liv bryter nacken

ZOTËRAT NUK PRANUAN TË BËHEN NJERËZ

**dhe kështu mbeti bota:
gjithnjë e vjetër
me frymë të re**

jetë e kallur në terr

**gjithnjë e re
me frymë të vjetër**

**zotërat u dridhën
por nuk pranuan të bëhen njerëz**

GUDARNA VÄGRADE ATT BLI MÄNNISKOR

och så blev världen till:

alltid gammal

med en ny ande

livet brinnande i mörker

ständigt ny

med gammal ande

gudarna darrade

men vägrade att bli människor

PËRCËLLIMË

**era fle fushave
ujërat vdesin ngadalë**

**nga shigjetat e zjarra të diellit
digjet gjithçka**

**rrugët e qytetit
krejtësisht të boshatisura**

**jeta merr frymë
me vështirësi**

qielli përcëllinë

BRAND

**vinden sover på fälten
vattnet dör långsamt**

**av solens glödande pilar
blir allt förbränt**

**stadens gator
helt tomma**

**livet andas
hårt**

himlen i brand

VETËM

**vetëm
mesnatë
frigoriferi gjëmon
librat të shkujdesura mbi tavolinë
mendimet e mia
kafshohen mes vete egërsisht
abazhuri më vëren me indiferencë
sonte jam mbuluar me vetminë time
si me një jorgan dimëror
dhe heshti.**

ENSAM

ensam

midnatt

kylskåpet surrar

böcker utslängda på bordet

mina tankar

biter ilsket på varandra

bordslampan tittar på mig likgiltigt

ikväll är jag täckt av min ensamhet

som med ett vintertäcke

och sitter tyst.

ËSHTË DIKUSH NË MUA

**është dikush në mua
që klithë
e zëri s'i dëgjohe**

**është dikush në mua
që më bluan si tenja**

**diçka që digjet ngadalë
e flaka s'i shihet...**

**është diçka në mua
që bënë alarm**

**në hapësirën e zverdhur
të heshtjes**

NÅGON ÄR INNE I MIG

**någon är inne i mig
som skriker
och rösten hörs ej**

**någon är inne i mig
som mal mig som vetemjöl**

**något som brinner långsamt
utan synlig låga...**

**något är inne i mig
som slår larm**

**i det bleka utrymmet
av tystnad**

RETË I LËNURI ME SY

**kur mungon ti
retë i lënuri me sy**

**rrugët e mendimeve i ngris në qiell
yjet i zbres në tokë**

**harroj se kam lindur
harroj se jetoj**

**harresa bëhet vdekja ime
kur mungon ti.**

MED MINA ÖGON KAMMAR JAG MOLNEN

**När du är frånvarande
kammar jag molnen med mina ögon**

**Mina tankevägar lyfter jag upp till himlen
stjärnorna tar jag ner till jorden**

**jag glömmer att jag var född
och att jag lever**

**glömskan blir till min död
när du saknas.**

DIALOG ME VDEKJEN

**gjithmonë ec me mua
zbrazëtirë e pafund**

**edhe në gjumë kur jam
dëgjoj rropamët tua**

nëpër ëndërrat e mia...

SAMTAL MED DÖDEN

**alltid går du tillsammans med mig
oändliga tomhet**

**även när jag sover
hör jag hur du rasslar**

genom mina drömmar ...

AZEM SHKRELI

KËNGË E TURPSHME

Sonte

Qava sonte për ty

Arbëri

Nuk më vjen turp

Pse qava

Më vjen turp pse s'munda

Të bëj tjetër

Nga turpi qava

AZEM SHKRELI

SKAMLÅT

**Ikväll,
för din skull grät jag ikväll
Arbëri ***

**Jag skäms inte
för att jag grät
Jag skäms för att jag inte kunde
göra något annat**

Av skam grät jag

*** Arbëri, namn på Albanien**

PSALM PËR KOSOVËN

Kur pikon gjak

Kalliu, kur piqet vera

Kur hyn në gjakun tim

Nusërore e të bëhem krushk

Më mëso vetëm t'i bie

Kitarës, më mëso të vdes bukur.

PSALM FÖR KOSOVA

**När veteaxet
droppar blod, när sommaren mognar**

**När in i mitt blod träder sommaren
och jag ska gå i bröllopfölje**

**Lär mig då bara att spela
Gitarr, lära mig att dö vackert.**

VARGJE

Ç'të bëj me ju

Të egrat

Të mleftat bimë

Që mbitë në kokën time

Në vorbën tonë

Kur vetëtinë ç'të bëj

VERSER

Vad kan jag göra med er

vilda

hätska växter

som slog rot i mitt huvud

I vårt krus

När det åskar vad kan jag göra

GREVË

Më kot i rrah

Muret e heshtjes sime

Duhi e fjalës që s'e them

Le të digjet ngadalë

Jan Husi i durimit që s'trembet

Le të vishet kuq

Në ledhet e flakës së vet

Njerëz

Mbuloni fytyrat

me lustrën e fjalëve që s'iu kursejnë

STREJK

**Förgäves slår jag mot
Min tystnads väggar
stormen från det ord jag inte kan yttra**

**Låt det brinna långsamt
Jan Hus' tålamod som inget fruktar
Låt det klä sig i rött
I kretsen av sin låga**

Människor

Täck era ansikten

Med glansen av de ord som inte kan rädda er

PARA PËRSHËNDETJES

**Kur të shkosh
Shko tej harrimi dhe ditës
Kur u nisëm**

**Ajo që mbetet le të jetë
Push i një shikimi të djegur
Dhe gjeografi**

**Kur të shkosh
merri me vete sytë
Dhe shko, shko, shko,**

Ashtu shkohet

FÖRE HÄLSNINGEN

**När du ska ge dig i väg
Gå längre än glömskan och dagen
När vi började**

**Låt det som återstår bliva
en flaga av en bränd anblick
Och geografi**

**När du ska ge dig i väg
Ta med ögonen
Och gå, gå, gå,**

Så ska man ge sig iväg

MALLI PËR NJERIUN

**Ai vjen fill vetëm
Si vinë shpendët dhe shirat
Vjen kaluar harrimit**

**Vjen zog i largët
Nga vise të kaltra të kujtesës
I bardhë flokut, i cemtë lotit**

**Nga farë e pjekur, nga plazma
Vjen e na i jep gjak gjenit**

Malli për njeriun

LÄNGTAN EFTER MÄNNISKAN

**Den kommer helt ensam
så som fåglarna och regnen kommer,
den kommer ridande från glömskan**

**Kommer som en fjärran fågel
Från minnets blå nejder
med vitt hår, med kylans tårar**

**Från det mogna fröet, ur plasman
Kommer den och ger blod till våra gener**

Längtan efter människan

SKICË PËR NJERIUN

**Kur të pendohen udhët
Qiriu kur ta djegë ditën e vet**

**Kur të fletë amshueshëm
Ky varg imi në një guacë**

**Shi kur të bjerë, kur të rritet
Fieri, himni i harresës**

**Kur të vdesim të mençur
Përjetësisht kur të vdesim**

Të bukur që do të jemi, o

EN SKISS FÖR MÄNNISKAN

**När väggarna känner ånger
när ljuset bränner sin dag**

**När den talar odödligt
Denna min vers i sitt skal**

**När regnet faller, när ormbunken
växer, glömskans hymn**

**När vi dör kloka
i evighet när vi dör**

Så vackra kommer vi att bli, åh...

ORIGJINË

**Err e terr i mërgon ditët
I mbyll me net të gjata**

**Ne daç pi gjak pas thoit
Ne daç jep mishtë nga ashti**

**Ec këpute nga bima jote
Farën e hidhur të hithërit**

**A thua s'ishim tjetër veç
Thekër në thundër të kalit**

URSPRUNG

**Natt och mörker förvisar dagarna
och stänger dem med långa nätter**

**Om du vill kan du dricka blodet under nageln
eller ge ditt kött från benet**

**Gå och tag bort från din växt
nässlans bittra frön**

**Var vi verkligen inget annat än
råg under hästens hov**

SAGA PËR POETËT

**Kur dehen, kur merr përcëllimë
Kur s'vete vera mbarë**

**Therin natën qetësinë
Me nga një dhembje, nuk flenë**

Ditën e zgjojnë në mes të natës

**Zhlyhen në manafera vargjesh
Venë thnegla shkronjash nëpër fletë**

**Latojnë vetveten, kujtojnë se
Gdhendën të zezën në të bardhë**

Më i miri varet në një varg

SAGA OM POETERNA

**När de blir berusade och då branden härjar
När sommaren inte går dem väl**

**Bryter de nattens lugn
Var och en med sin smärta, de sover inte**

**De väcker dagen mitt i natten
De smetar in sig i verser i björnbärssnåren
sätter myrbokstäver - på papperet**

**De gör sina egna inskriptioner och tror att
de har graverat det svarta på det vita**

Det bästa hänger på en vers

JUSUF GËRVALLA *

SHTËPIA QË RRËZOHET

tash shtrati rri në oborr dhe do rraqe
t'zënë këmbët e merr në thua
gjësendet që shkëlqenin para një çasti tani prapë
si në kohëra të praptisura me pluhur mbuluar
hamenjtë e nxjerrin me kujdes një arkë korridorit
ora e madhe në mur ka pushuar
vetëm fëmijët tani lodrojnë e shkelin barin
këtë ditë do ta kalojnë si zogjtë nën qiellin blu

* Poetin dhe patriotin Jusuf Gërvalla e vrau
UDB-a jugosllave më 1982, në Gjermani.

JUSUF GĚRVALLA *

HUSET SOM RIVS

**nu ligger sängen på gården och lite skräp
får dina fötter att fastna och du kan ramla
prydnadssaker som nyss glänste är nu åter
som i vedervärdets tid täckta av damm
flyttkarlarna släpar försiktigt ut en kista genom korridoren
det stora vägguret har stannat
Nu är det bara barnen som skuttar omkring i gräset
denna dag kommer de att vara som fåglar under blå himmel**

*** Poeten och patrioten Jusuf Gěrvalla dödades av den jugoslaviska säkerhetspolisen UDB år 1982 i Tyskland.**

SHTËPIA QË NDËRTOJ

1.

**në një skutë do të ketë më shumë dritë
në tjetrën vend për shtratin dhe minjtë
një derë do ta ketë për në rrugën kryesore**

**një tjetër për kopshtin me lule të bardha
një verandë do ta ketë me një fuçi druri portokalli
do ta llogarisë këndin e diellit mbi dritare**

2.

**do të ketë aty pak troha buke do të zihet çaji
një komë e shtruar në mesore do gazeta dite
do të vë portretin e një dashurie në dhomën e pritjes
do të më vijnë shokë e do të më vijnë prindër
s'do të ketë kurtina të larme në dritare
dhe krejt dyert e drurit do t'i ngjyjej
me bojë plepi e gjethesh me të gjelbër
e do të kthej për çdo mbrëmje aty**

HUSET SOM JAG BYGGER

1.

**i ett hörn kommer att finnas mer ljus
i ett annat mer plats för sängen och mössen
en dörr ska det finnas ut till stora vägen**

**en annan till trädgården med vita blommor
det skall finnas en veranda med ett fat av apelsinträ
jag ska beräkna solvinkeln mot fönstret**

2.

**det kommer att finnas där lite brödsmulor, te kommer att kokas
en getskinnspläd liggande i mitten, några dagstidningar
jag kommer att ställa ett porträtt av en käresta i vardagsrummet
dit skall komma mina vänner och föräldrar
det kommer inte att finnas brokiga förhängen i fönstret
och alla trädörrar kommer jag att måla
i den grönaste poppelbladsfärg
och jag ska varje kväll återkomma dit**

SHTËPIA NË KORNIZË

**në vitrinat e verdha nga drita një natë e kam parë
mes do gjësendesh prej kashte dhe pëlhurash
rrinte pak si e shtrembëruar mbi përfytyrimin
dhe erë lulëshqerrash shpërndante nëpër trotuar
njerëzit ktheheshin nga turnet e natës të lodhur
aty kishte drunj të vjetër dhe trungje rrëzuar
një shteg i ngushtë barin e kishte tharë me shkelje
aty e pashë t'ime amë me govatë në dorë e vetmuar
shkonte e gëmuqur shtegut drejt derës së saj
s'di a do të ketë qenë ditë apo në rreze hëne larë
tym nga oxhaku i kërrusur dhe në kusi diçka që zien
do stiva drunjsh të nxira shiu rrinë te shkallët**

HUSET INOM RAMAR

**I skåpen belysta med gult ljus såg jag det en natt
bland prydnadssaker av halm och tyg
sittande lite förvrängt för min blick
och det spred tusenskönornas doft över hela trottoaren
människor återvändande trötta från nattsiftet
där fanns gamla träd och fallna stammar
en smal stig hade trampats upp på torkat gräs
där såg jag min mor ensam med bykkar i handen
hopkrökt på väg mot sin dörr
jag vet inte om det var dag eller en syn i månens sken
röken från en krokig skorsten och i grytan något som kokar
några vedtravar svärtade av regn ligger invid trappan**

NGA MEMOARET E NJË SHITËSI

**Kur u ktheva nën pullazin tim mbuluar me kashtë
nën qepallat e lodhjes e të kohës botën
e në botë s'kish tjetër pos shkëlqim ari e qelqi
mbi rrashta e penda të larta zogj alumini
kish edhe uri edhe poetë edhe ujëvare në botë
kish njerëz prej druri e kafshë të buta kudo**

UR EN SÄLJARES MEMOARER

**När jag kom tillbaka under mitt halmtäckta tak
under ögonlocken med sin och tidens trötthet fanns världen
och i världen fanns inget annat än glans av guld och glas
med sina höga skallar och fjädrar fåglar av aluminium
det fanns på jorden också hunger och poeter och vattenfall
överallt fanns det människor av trä och husdjur**

NJERIU I ZI

**Jam i sigurtë, kurrë s'do të bëj vetëvrasje
Kaq i hekurosur, i mirëfilltë, si arsyeja
E kam vrrarë orën e murit me armën e nxehtë
Dhe kam ikur prej librit të përhitur që më shëmton
Me bukurinë e tij
Vdekja s'është dobi as moshë as lindje e re
Drurin e vjetër të tavolinës, shtizën, patericën**

DEN SVARTA MANNEN

Jag är helt säker, aldrig kommer jag att begå självmord

Så välstruket, så riktigt, som förnuftet

Jag dödade väggklockan med mitt eldvapen

Och jag flydde från den grå boken som vanställer mig

Med sin skönhet

Döden är till ingen nytta, samma med ålder eller pånyttfödelse

Det gamla träet i bordet, spjutet, kryckan

PLUHUR E NGJYRË

**Sytë e tu qiell çerdhe e lumë i pakapërcyeshëm
ndërsa jam përgjumur përmbi tavolinë
im vëlla dhe fëmijëria ime pemën e kanë vjelë
kanë korrur kallinj
ime ëmë ka zier ftonj
shelgjet kanë vajtuar
si poeti sentimental në vjeshtë
- po asgjë s'është zverdhur.**

DAMM OCH FÄRG

**Dina ögon himmel hemvist oöverkomlig flod
medan jag hänger sömnig över bordet
min bror och min barndom har skördat frukten
bärgat hem kornet
min mamma har kokat kvitten
tårepilar har gråtit
som en sentimental poet om hösten
- men ingenting har gulnat.**

FLATRAT E DETIT TË HUMBUR

**Qepallat e gjata, hijet e syve dhe lagështia
Lumi i bardhë, trup i thyer leckë
Ec e ec e këmbët më sharrojnë në lym
Jam larg tokës
E qielli im i lartë s'më mban
Të mos isha det i humbur, do të kisha flatra**

DET FÖRLORADE HAVETS VINGAR

**Långa ögonfransar, ögonskuggor och fuktighet
Den vita floden, kropp bruten som en trasa
Jag går och går och mina fötter druknar i slask
Jag är långt från jorden
Och min höga himmel håller mig inte
om jag inte vore ett förlorat hav, skulle jag haft vingar**

FLETË TESTAMENTI

**Në zgjimin tim të heshtur të më ngurosin
në flijimin tim të begatshëm të verës
në nisjen time në fillimin tim të ri
në gjumë shekujsh me ndërrime të më zgjojnë
le të më puthë rrezja e qartë ngazëllyese
e druvarit të fjetur në rudinë**

BLAD UR TESTAMENTE

**I mitt tysta uppvaknande låt dem förstena mig
i mitt välsignade sommaroffer
i min avresa, i min nya början
i min tusenåriga sömn låt dem väcka mig i skift
låt mig få en kyss av den klara, glada solstrålen
med skogshuggaren som sover i gräset**

RAHMAN DEDAJ

FËMIJËRISHT

Më bëhet se një zog i padukshëm

Edhe sot i han

Qershitë e fëmijërisë sime

Sytë e ëndrave i kërkojnë

Fluturat e vdekura në shi

Si ta zë atë fëmijë

Ai arrinë në maje

Mua më fillon tatëpjeta

Si më humbi ai burim

Nga briri prushit

E një ëndërr më zgjohet

Te Gurët e shpatit të Rrushit

RRAHMAN DEDAJ

BARNSLIGT

Det tycks mig att en osynlig fågel

Även idag äter

Min barndoms körsbär

Drömmarögonen söker

Döda fjärilar i regnet

Hur kan jag få tag i barnet

Det når toppen

Jag börjar vandringen nedåt

Hur förlorade jag detta ursprung

ur det glödande hornet

och en dröm väcker mig

bland stenarna i Druvbacken

NJERIU ENGJËLL

**Engjëlli yt vesh pantallona të shkurta
Kapelën e vë mbi sy të majtë
Kratatën e ka të mëndafshhtë**

**Ai flet kur të dojë me Zotin
Dhe ia këndon himnin atdheut**

**Mbi portretin tënd engjëll
Bie shi qumështi
Zemra jote vizatohet në kartëpostale
Dhe ai përshpëritë në vesh
Lumturinë atdheut**

**Engjëlli yt ka gjelin kryengritës
Që i zgjon ëndrrat
Sipas yllit të fatit**

**Ai ka numrin e rrobave tua
Numrin e këpucëve tua
Dhe numrin e fatkeqësisë sime**

**Udhëton mbi shpinën e breshkës
Arrin më shpejtë se çdo djall
Pastaj ndërrohe rolet
Ti vesh pantollona të shkurta
Vë kapelën mbi syt të majtë
Dhe zëvendëson engjëllin**

**Më pastaj kush e di
As egjëlli engjëll
As ti nuk je ti**

ÄNGLAMÄNNISKAN

Din ängel bär kortbyxor
hatten drar han ner över vänster öga
och han bär sidenlen slips

Han talar när han vill med Gud
Och sjunger fosterlandssånger för Honom

Över ditt änglaporträtt
Faller regn av mjölk
Ditt hjärta tecknas på vykortet
Och han viskar i ditt öra
om hemlandets lycka

Ditt ängel har en upprorisk tupp
Som väcker drömmar
Enligt ödets stjärna

Han har din klädstorlek
din skostorlek
och min olyckas storlek

Han färdas på sköldpaddans rygg
kommer fram snabbare än någon djävul
Sedan byter ni roller
Du tar på dig kortbyxor
Sätter hatten över vänstra ögat
Och ersätter ängeln

Men vem vet sedan
om varken ängeln är ängel
eller du är du

FABULAT EDHE MË TEJ MË PËLQEJNË

**Secili le të matë
Hijen e vet të vdekur
Duke vënë gurin në zemër**

**Ashtu ishin udhëkryqet
Ashtu mësuam të ecim
Me këmbë me kokë**

**Çdo kohë e mjafton
Pikëllimi i vet**

**Fabulat edhe më tej më pëlqejnë
Aty vazhdimisht shtazët
Flasin si njerëzit
Dhe fëmijët besojnë**

FABLER TYCKER JAG FORTFARANDE OM

**Låt varje människa mäta
sin skugga som död
genom att sätta stenen i hjärtat**

**Sådana var vägkorsningarna
Så har vi lärt oss att gå
med fötter och med huvud**

**För varje tid räcker
dess egen sorg**

**Fabler tycker jag fortfarande om
där djuren hela tiden
talar som människor
Och barnen tror på dem**

**MITI THA:
SHUMËZOHEN SIZIFËT**

**Kështu ishte përherë
Dikush zgjedhet për fat
Dikush për flijim**

**Shtegu i njëjtë guri i njëjtë
Ndryshuan vetëm zotat
Dhe u shumëzuan sizifët**

**Një shpresë të shtyen kah maja
E vërteta të kthen në rrënjë
Në mes loja me Zotin**

**Lirija jote është të nisësh
Mallimi të kthen në fillim:
Mos u bë fat i atdheut**

**Fshehtësia e zotave
Nuk është më fshehtësi:
Shtegu i njëjtë guri i njëjtë**

**Kështu ishte përherë
Dikush zgjedhet për flijim
Dikush për fat**

**MYTEN SADE:
SISYFOS MÅNGFALDIGAS**

**Så var det alltid
någon blir vald till lyckan
Någon till att offras**

**Samma stig, samma sten
Endast gudarna förändrades
och Sisyfos mångfaldigades**

**Ett hopp driver dig upp mot toppen
Sanningen för dig tillbaka till rötterna
I mitten spelet med Gud**

**Din frihet är att du sätter igång
Saknaden för dig tillbaka till början:
Låt dig inte bli fosterlandets öde**

**Gudarnas hemlighet
är inte längre hemlighet:
Samma stig, samma sten**

**Så var det alltid
Någon väljs till offer
En annan till lyckan**

KRYQËZIM

Assesi të kuptosh

Si bëhesh fëmijë

Dhe imiton fluturën

Secili ka nga një zot

Më të mençur nga të tjerët

Futu në vesh të botës

E dëgjo si vdes

Qenësia nostalgjike

Është kohë e pikëllimeve

Kur mësohen e përsëriten lutjet

Ruajna Zot

Nga koha me shumë zota

KORSNING

**På inget sätt förstår du
hur du blir till barn
Och efterliknar en fjäril**

**Var och en har sin gud
Klokare än andra**

**Gå in i världens öron
och lyssna på hur det dör
Det nostalgiska varandet**

**Det är en tid av sorg
När man lär sig och upprepar böner**

**Gud skydde oss
från tiden med många gudar**

ËNDËRRA NËN OMBRELLË

**Është i paemër engjëlli
Që na mëson të mallëngjehemi**

**Ndoshta udhëtuam shumë
E po kthehemi gabimisht**

**Ndelemi në shitore të kohës
Disa blejnë lodra për fëmijë
Të tjerët shkopin për pleq**

**Ecim me ëndrra nën ombrellë
Krejt çka harruam
Në fund të udhës na pret**

**Edhe më tej të lumturit
Hanë bukë të njëjtë
Pa e shikuar orën**

**Vetëm e vërteta
Duket qesharake**

**Huazo nga jeta dhe luaje
Deri në fund fatin tënd-
Përshpërit ëndrra nën ombrellë**

**Kthejmë në shitore të kohës
Disa blejnë lodra për fëmijë
Të tjerët shkopin për pleq**

DRÖM UNDER PARAPLYET

**Det är den namnlösa ängeln
Som lär oss längtan**

**Vi har förmodligen rest mycket
Och tar en felaktig sväng tillbaka**

**Vi stannar till i tidens butik
Vissa köper leksaker för barn
Andra käppar för de gamla**

**Vi går med drömmar under paraplyet
Allt vi har glömt
Väntar oss i slutet av vägen**

**Även i fortsättningen
Äter de lyckliga samma mat
Utan att titta på klockan**

**Endast sanningen
Verkar löjlig**

**Låna från livet och spela
ända till slutet ditt öde
Viska dina drömmar under paraplyet**

**Vi återvänder till tidens butik
Vissa köper leksaker för barn
Andra käppar för de gamla**

BALADA QË HARROI TË FOLURIT

**Edhe kësa dite që u bë zog
Do t'ia harrojmë emrin**

**Nga të rremet mësuam
Aq sa të mashtrohemi**

**Fjalët që na shfajsojnë
Do t'i flasim
Në ëndrrat që s'na duhen**

**Nga balada që harroi të folurit
Harro ç'është e mundur të harrosh**

**U zhvendos nostalgjia
Si të njihemi shenjtëri**

**Libri i të lumturve
Ishte shkruar me gabime**

BALLADEN SOM GLÖMDE TALFÖRMÅGAN

**Även för denna dag som blev en fågel
kommer vi att glömma dess namn**

**Av lögnerna lärde vi
Hur mycket vi kan bli lurade**

**De ord som ursäktar oss
kommer vi att uttala
I drömmar som vi inte längre behöver**

**Av balladen som glömde talförmågan
Glöm allt det är möjligt att glömma**

**Nostalgin förflyttades
Hur kan vi känna igen varandra, Ers helighet**

**De lyckligas bok
Blev skriven med fel**

GJEOMETRIA PA VIJA

**Po shumëzohen egjëjt
Njëri tjetrit
Me saktësi ia masin kokën**

**Në gjeometri pa vija
Nyje lidhur mënia**

**Asnjë djall s'do të mbetet
Jashtë lojës kryesore
Që luhet me përsëritje**

**As njëqindgishitorët s'e prekin
Qetësinë time të sigurt
Ku gabon shenjtëria**

**Mos u bë sikur asgjë s'ndodh
Sikur s'ka asnjë vesh
Paformësia aktuale e harrimit**

**As në pasqyrë s'jemi
Atë që jemi
Në pantomimën humoristike**

LINJELÖS GEOMETRI

**Änglar ökar i antal
Och mäter noggrant
Varandras huvuden**

**I geometri utan linjer
Är agget knutet**

**Ingen djävul blir kvar
Utanför huvudakten
Som spelas i repris**

**Inte ens hundrafingertarmen kan störa
Min trygga frid
Där heligheten felar**

**Låtsas inte som om inget händer
Som om det inte finns något öra
Glömskans förhandenvarande formlöshet**

**Inte ens i spegeln
Är vi det som vi är
I den humoristiska pantomimen**

NGA FILLIMI

**Tepër di nga ajo
Që nuk më duhet**

**Krishti do të gozhdohet përsëri
Ndryshe do të matet koha**

**Tërë ajo që u mësua
Të luajë si harrimi
Nga fillimi do të pagëzohet**

**Ku nuk barazohet ëndrra
S'mund të vëhet as guri**

**Një kohë do t'i dijë të gjitha
Dhe pa kokë
Do të mbetet ngushëllimi**

FRÅN BÖRJAN

**Jag vet för mycket
av det jag inte behöver veta**

**Kristus kommer att korsfästas på nytt
Annorlunda kommer tiden att mätas**

**Allt det som man lärde sig
För att spela med som glömska
kommer att döpas från början**

**Där inte drömmen når sin jämvikt
Kan inte en enda sten sättas**

**En tid kommer att veta allt
Och utan huvud
kommer trösten att stå där**

EKZISTON NJË RREGULL

Zotat e vegjël

Kanë një fatkeqësi të madhe:

Nuk mund të rriten

Shpresoj se z. Zoti

Do ta ndërrojë mendimin

Në një riradhitje tjetër

Ca una në mes të sheshit pikojnë dritë

Dhe ja dejgin krahun kohës

Gjer te ajo dashurie e pëllumbave

Tani vetëm një gur

Mund të shndërohet në harfë

Një gur i butë

Në thikën e kujtimit në zemër

DET FINNS EN REGEL

Små gudar

Har en stor olycka:

De kan inte växa

Jag hoppas att herr Gud

kommer att ändra sin uppfattning

I en annan omfördelning

Vissa jag släpper fram ljus mitt på torget

Och bränner tidens arm

Ända upp till duvornas kärlek

Nu är det bara en sten

Kan förvandlas till harpa

En mjuk sten

Till minnets kniv i hjärtat

GJËRAT QË S'PREKEN

**Me dashurinë që s'preket
Vetë deti më lidh**

**E hudh mollën s'arrin
Në bregun e etur
Vasha me bukë në kokë
Emrin tim e kërkon**

**E hudh mollën e s'arrin
Unaza bie në ujë**

**Në shtëpinë time prej koraleve
Vetëm unë
Dhe gjërat që s'preken**

SAKER SOM INTE KAN RÖRAS

**Med kärlek som inte kan röras
förbinder mig själva havet**

**Jag kastar äpplet som inte kommer fram
Till Törstens strand
Flicka med bröd på huvudet
Söker efter mitt namn**

**Jag kastar äpplet och når inte fram
Ringan faller i vattnet**

**I mitt hus av korall
Bara jag
Och saker som inte kan röras**

TË ÇMËSYSHEMI NGA VETJA

Mos paç sy të keq

Engjëll i uruar

Që na e mat orën

Po ëndërrojmë në ëndërr

T'na zgjojë mençuri tjetër

E besimit që s'i besuam

Mos paç sy të keq

Na çmagjeps engjëll i Mirë

T'i shohim më qartë

Fytyrat tona të panjohura

E të çmësyssemi nga vetja

NEJ INTE SKA VI ANGRIPA OSS SJÄLVA

Måtte du inte ha onda ögon

Du välsignade ängel

Som mäter vår tid

Vi drömmer i våra drömmar

Att en annan klokskap ska väcka oss

Till den tro som var den vi inte trodde på

Måtte du inte ha onda ögon

Bryt våra illusioner, goda ängel

Så vi ser klarare

Våra okända ansikten

för att avstå från att anfälla oss själva

FREDERIK RESHPJA *

RIVARRIMET *

**Djem të rinj, të zjarrtë,
që i lanë puthjet e para përgjysëm.**

**Fëmijë që s'do lozin më kurrë në perëndim;
do ikin stinët në Kosovë e ata s'do të jenë.**

**Pleq s'do prehen më te pragu,
megjithëse nuset hutohen, ua pjekin kafetë çdo mëngjes.**

**Tani janë të vdekur. Aty poshtë te balta.
Sillen në brinjë.**

**Kryqetërthor në amfiteatrin e maleve,
a në një pllajë të pjerrët kohe.**

**Zot i madh! Po rivarrosen të vdekurit tanë
dhe na fal që jemi të mbushur me urrejtje;
Dhe po të duash, mos na fal o Zot!**

Dhe mos na jep parajsën, por na lër në dheun tonë, amen!

* Poeti ka qëndruar 17 vite në burgjet e Shqipërisë, sepse poezia e tij ishte vlerësuar si "reaktionare".

* Në luftën për çlirimin e Kosovës 1997-1999 u vranë dhe masakruan mbi 12.000 shqiptarë nga soldateska serbe. Pasi Kosova u çlirua, ka pasur shumë varrime e rivarrime. Ende nuk po gjenden eshtrat e mijëra njerëzve.

FREDERIK RESHPJA *

OMBEGRAVNINGAR *

**Unga pojkar, eldiga,
vars kyssar bröts mitt itu.**

**Barn som aldrig mer ska leka i kvällsljuset;
årstiderna växlar i Kosova utan dem.**

**Äldre som inte vilar längre vid porten,
fastän sonhustrurna glömmer sig, kokar de kaffe
varje morgon.**

Nu är de döda. Nere i gyttjan.

Ligger de på sidan.

**Kors och tvärs i bergens amfiteater,
i tidernas högplatåer.**

**Du store gud! De begraver om våra döda
och förlåt oss att vi fylls av hat;**

Eller förlåt oss inte, om du behagar:

Ge oss inte himmelriket, låt oss vara på vår jord, amen!

* Poeten blev fängslad 17 år i Albanien pga hans
poesi betraktades som "reaktionär".

* Under Kosovakriget 1997 - 1999 dödades
drygt 12.000 människor, tusentals saknas
fortfarande. Kvarlevorna, som ofta hade
begravts i trädgårdar, flyttas därför ännu idag.

KRONIKË

Një gjethe u bë zog dhe vajtoi mbi ullishte.

**Nga fshati kundruall dolën pleqtë
rendën pas shpirtrave që silleshin në ajër
drejt Kashtës së Kumtrit.**

**Të vrarët i rreshtuan në sheshin DEMOKRACIA *
mbështjellë me çarçafët e dhëndërisë.**

**Por shtypi tha se zgjedhjet qenë të ndershme,
të lira dhe korrekte. Ashtu edhe TV-të.**

**Pastaj lanë gjakun
te ullishtja me drurët e përdredhur
nga dhembja.**

Eh! Ullinj të e Shqipërisë dhe paqja juaj e mallkuar!

***Pas 40 vitesh diktaturë, në vitin 1991 në Shqipëri u mbajten zgjedhjet
e para "të lira", ku çuditërisht "fitoi" Partia e Punës së Shqipërisë!!!
Kështu, prapë u derdh gjaku për liri e demokraci.**

KRÖNIKA

Ett lövverk blev till fågel och grät i olivlunden.

**Från byn mittemot kom åldringarna ut
jagade själar som vandrade i luften
mot Vintergatan.**

**De dödade radades upp på DEMOKRATITORGET *
svepta i vitt som brudgummar.**

**Men pressen sa att valet var hederligt
och fritt och korrekt. Så sa också TV:n.**

**Sedan tvättade man bort blodet
vid olivlundar där grenar förvridits
av smärta.**

Ve! Albaniens olivträd och er förbannade fred!

*** Efter 40 års diktatur, 1991 i Albanien, utlystes det första "fria" valet.**

**Men, konstigt väl, igen "vann" Albanska Arbetets parti - kommunisterna
- och på nytt rann blod för fred och demokrati.**

RRI E RRI

**Ylli i mbrëmjes
ti me këngën tënde në kafazin e muzgut
m'i kujton sytë e saj,
në ngjyrën e detit kur ikin anijet.**

**Rri e rri, druri i pritjes çeli gjethe
zogjtë e trishtimit dalin te dyert e çerdheve.**

**Druri i pritjes u vesh me vjeshtë,
rrufetë u bien këmbanave
në ajrin e ngjyer me mbrëmje.**

**Druri i pritjes u bë dimër,
çeli dëbora lule tek era.**

**Vetëm tani që u sosën stinët
e kam kuptuar që dashuria ime s'të sjell në këtë botë
megjithatë, çdo ditë ngre ura e rrugë.**

KVAR

Aftonstjärna

**du med din sång i kvällens bur
påminner mig om hennes ögon,
likt havets färg när skepp avseglar.**

**Stanna kvar, bladen på väntans träd har slagit ut
sorgefåglarna skuttar till sina gångar i bona.**

**Väntans träd tog på sig en höstdräkt,
åskbyn slår i larmklockor
i en luft som färgats av kvällsljus.**

**Väntans träd har blivit till vinter,
snön har öppnat blommor i vinden.**

**Endast nu när årstiderna tar slut
förstår jag att min kärlek inte fört dig till världen
och ändå, reser jag broar och vägar varje dag.**

PEISAZHET E NATËS

**Zhduken drurët me fole e me gjethe
dhe luleve u rrëzohen ngjyrat;
nata gdhend në ajër statujat e hijeve.**

**Eja ti, tërë dritë, si dashuria!
hidh ngjyra mbi lulet,
vërë rregull mbi peisazhet e botës!**

**Nëse nuk vjen,
do të tremem nëpër kështjellat e ftohta
vizatuar brutalisht nga nata,
sepse mëngjesi nuk vjen asnjëherë.**

NATTVYER

**Träden försvinner med nästen och lövverk
och färgen störtar från blommor;
natten snider ur mörker skuggornas statyer.**

**Kom du full av liv, som kärleken!
kasta dina färger på blommorna,
skapa ordning i världens vyer!**

**Om du inte kommer,
kommer jag att upplösas i kalla fästningar
som natten brutalt tecknat,
för att morgonen inte ska gry igen.**

SHIROKA NË DIMËR

**Nuk ka më zogj. Fluturimet u fshinë.
Asgjë përveç grundi primitiv i shiut.**

**Bregu mendohet tek këmbët e ujrave
duke ëndërruar verën që shkoi.
Në rërën e harresës unë mbledh
qeramikën e portretit tënd.**

**Sa e shkurtër kjo verë, o Zot!
Një grusht rërë dhe një grusht diell.
Tërë kalendari i verës vetëm me një të shtunë
dhe tërë e shtuna vetëm me një puthje.**

BYN SHIROKA I VINTER

**Inga fåglar kvar. Flygningen har utplånats.
Inget kvar utom regnets primitiva grund.**

**Stranden grubblar vid foten av vattnet
drömmer om i somras.**

**Ur glömskans sand samlar jag
ditt anletes lerkärl.**

**Vad kort den här sommaren var, Herregud!
En näve sand och en näve sol.
Hela sommarkalendern med bara en lördag
och hela lördagen med bara en kyss.**

PËR NJË VJOLLCË

**Çeli vjollca e vogël mbi gurishte,
si një ylber mbi planete të panjohur.**

**Kështu kam ëndërruar edhe unë dikur,
të bëhem ylber mbi akuafortën e kohës vizatuar egër,
po tërë ato që thashë
u tretën në kujtesën e palexueshme të ajrit.**

**Më me fat janë perënditë
që kthehen tek toka të skalitur:
ti s'ke për t'u skalitur kurrë
e veç ndoshta në kujtesën e palexueshme të ajrit.**

**Ky qe fati yt prej ylberi
me një kryq shiu te koka;
por fati sundon tërë popujt e zotave,
të shumtë si rëra.
Vjollcë e vogël, o shpirt!**

TILL EN VIOL

**Den lilla violen slår ut på grusmarken
som en regnbåge över okända planeter.**

**Så drömde jag också förut
att bli en regnbåge över tidens vilt tecknade etsning,
men allt som jag har sagt
har upplösts i luftens oläsliga minne.**

**Lyckligare är gudarna
som återvänder utmejslade till jorden:
du skall aldrig mejslas ut
utom kanske i luftens oläsliga minne.**

**Detta var ditt regnbågsöde
med ett regnkors vid ditt huvud;
det är ödet som styr över gudarnas folkslag,
talrika är de likt sandkorn.
Lilla viol, min älskade.**

HËNË S'KA

**Bie një gjethe tërë vjeshtë,
a një dridhje muzgu;
bie alarmi i shirave, rrëzohen udhët e zogjve,
dhe hëna projekton profilin tim në xham.
Kështu do të iki, vizatuar nga hëna.**

**Do doja të shkoja në Hënë
për t'i kujtuar pikëllimet e rinisë.
Nga larg, me mallë, do ta vështroj Tokën,
shtëpinë ku u deshëm dhe u grindëm përjetësisht.**

**Por, zemra ime, hëna nuk ekziston
që ditën që u shfaqe ti.**

INGEN MÅNE

**Ett löv fullt av höst faller
eller var det kvällsljusets skälvning;
regnets larm tjuter, fåglarnas vägar rasar
och månen projicerar min profil i rutan.
Så ska jag fly, tecknad av månen.**

**Jag skulle vilja bege mig till Månen
för att minnas ungdomens sorger.
Från fjärran, med längtan, skulle jag titta på Jorden,
hemmet där vi ständigt älskade och grälade.**

**Men det finns ingen måne min älskade
sedan den dag du visade dig.**

KU ISHE TI?

Ku ishe ti kur dola i vetëm nën hënë?

në ç'hënë barisnje vallë?

Ku ishe ti kur vizitova profilin tënd

në xhamin e muzgut që krisi dhe u thye me trishtim?

Pastaj erdhi nata mbushur me mungesën tënde,

pastaj erdhi prapë nata

dhe kështu ka për të qenë deri në ditën e fundit të netëve.

Zbrita tek kroi

duke mbajtur në duar vazon delikate të agimit

pashë sytë e tu ruajtur në kujtesën e ujrave.

Lisi plak lëshoi përdhe kurorën e vjeshtës

si një sovran që abdikon.

Ani, mua më zuri ky mallkim.

Po qysh bën pylli pa ty? Si del vjeshta?

A ndofta nuk do të ketë kurrë më vjeshtë?

Atëherë në emër të kujt do të bien gjethet?

Në emër të kujt do të vijnë shirat, mjegullat, ylberët?

Ah, zemra ime, eja vër dorë mbi stinët!

VAR FANNS DU?

**Var fanns du när jag gick ut ensam under månen?
Under vilken måne vandrade du?
Var fanns du när jag tecknade din profil
i kvällens ruta, som brast och gick sönder i sin sorg?**

**Sedan kom natten fylld av din saknad,
sedan kom en ny natt igen
och så ska det alltså bli tills alla nätter tagit slut.**

**Jag gick ner till källan
gryningens ömtåliga kruka höll jag varsamt i händerna
såg dina ögon bevarade i vattnets minne.**

**Det gamla trädet la ner höstens krona på marken
som en abdikerande monark.**

**Låt vara att jag drabbas av förbannelsen.
Men vad ska skogen göra utan dig? Hur ska hösten komma?
Eller ska det inte få bli höst någonsin igen?
Till vems ära ska då löven falla?
Till vems ära ska regn, dis och regnbågor nalkas?
Älskling, kom och lägg din hand på mina årstider!**

VDEKJA E LORËS

**Rri në muzg sikur të janë rrëzuar kohërat përsipër,
gati për përjetësi.**

Nuk më flet. I ke premtuar vdekjes, e kuptoj.

Por ti në këtë botë erdhe për mua, jo për qiejtë.

**Kemi qenë përherë bashkë, që të rinj,
dhe tani më le!**

**Mua më trishtojnë stinët. Ti e ke ditur,
dhe me botën më ndan një udhë me kilometra vetmi.**

Kemi thënë gjëra që s'kanë për t'u kuptuar kurrë.

kemi ecur në tërë shekujt, para piramidave.

**Emrat tanë kanë qenë gdhendur
edhe kur nuk kishim shkëmbinj.**

Por këto s'kanë për t'u përsëritur më kurrë.

Si ungjijtë.

Të dy kemi qenë gjithmonë të bukur, por ti tani

je akoma më e bukur, kështu me pak vdekje në sy.

7 mars 2005

LORAS DÖD

**Du sitter i en skymning som om tiderna störtat över dig,
redo för evigheten.**

Du talar inte. Du har ingått förlovning med döden, jag förstår.

Men du kom till denna värld för mig, inte för himlarna.

**Vi har alltid varit tillsammans, sedan unga dagar,
och nu lämnar du mig!**

**Jag skräms av årstiderna. Du känner till
att jag och världen skiljs åt av en väg av miltals med ensamhet.**

**Vi har sagt ord som aldrig kommer att tydas.
Vi har gått genom alla sekler, före pyramiderna.
Våra namn ristades ihop
redan innan det fanns stenar och träd.**

**Men det kommer aldrig att upprepas.
Som evangelierna.**

**Vi har alltid varit vackra, men just nu
ser du vackrare ut ändå, med lite död i ögonen.**

7 mars 2005

VETËM RËRA

**Vetëm dy re, si dy zogj, zvarriten në qiell
për ku vrapojnë të bëhen shi, këta zogj?**

**Zëri im fytprerë ra në duart e tua,
zëri im tërë jetën i vrarë.**

**Ti ç'pate dhembja ime që ngrite harkun
të qëllosh zogjtë këngëtarë?**

**Si shpirti i shkretëtirës u ula
mbi trishtimin e kësaj nate vere.**

**Tani e tutje, pa ty,
tërë netët kanë për të qenë prej rëre.**

ENBART SANDEN

**Enbart två moln, som fåglar, svävar på himlen
Undrar vart de skyndar för att bli till regn, dessa fåglar?**

**Min halshuggna röst föll på dina händer,
min röst, hela livet fördömd.**

**Vad flög det i dig min smärta, som höjer din båge
för att skjuta ner sångfåglar?**

**Som öknens själ satte jag mig
över sorgen i denna sommarnatt.
Numera, utan dig,
kommer alla nätter att vara av sand.**

PRELUDË

**O ajër i mbrëmjes mbështillmë, erdhi ora të vdes përsëri!
Kur të mbyllen sytë e mi, nuk do të ketë më det
për varkat e lotëve.**

**Po shkoj dhe shirat po i lë të kyçura.
Po, unë do të kthehem përsëri në çdo stinë që të dua.
Unë kam qenë trishtimi i botës.**

O ajër i mbrëmjes mbështillmë, erdhi ora të vdes përsëri!

PRELUDIUM

**Kvällsluft linda in mig, det är tid att dö på nytt!
När jag sluter ögonen, ska det inte finnas mera hav
för tårarnas skepp.**

**Jag går och lämnar regnen inlåsta.
Men jag kommer tillbaka vid varje årstid för att älska.
Jag har varit världens sorg.**

Svep mig in kvällsluft, det är tid att dö på nytt!

ZEMRA IME

**Në asnjë dorë të botës nuk më zë gjumi.
Isha mësuar me kokën në duart e tua.
E ke ditur që kam diçka nga deti;
breg me breg dhe gjumi s'më zë.**

**Dua të shtrihem dhe të vdes,
por vjen ti dhe nga balta më ngre.**

**Kur male të tëra dot s'na ndanë,
si do na ndajnë dy grushta dhe?
Ah, isha mësuar me kokën në duart e tua,
tani dhe brigjet më gjumi nuk i zë.**

MITT HJÄRTA

**Jag somnar inte i någon av världens händer.
Jag var van att på dina händer vila mitt huvud.
Du har vetat att jag har lite av havet i mig;
från kust till kust och faller inte i sömn.**

**Jag vill lägga mig ner och dö,
men in träder du och lyfter mig ur stoftet.**

**När hela berg inte kunde skilja oss åt,
hur ska då två nävar jord lyckas?
Ack! Jag hade vant mig att sova med huvudet på dina händer,
nu kan inte ens kusterna falla i sömn längre.**

EPITAF

**Imezonjë, si do ja dal pa ty në këtë botë,
i mallkuar me pavdekësi
si patriarkët e mërzitshëm biblikë?**

**Duhet t'i kesh parasysh disa gjëra
tani që nuk je më!**

GRAVSKRIFT

**Bästa dam, hur ska jag lyckas utan dig i denna värld,
dömd till odödlighet
som de trista bibliska patriarkerna?**

**Du får tänka efter före
nu när du inte längre finns!**

ALI PODRIMJA

KOSOVA

1.

Zgjohu, Kosovë! Zgjohu, nëna ime e dashur,

balli dhe emri im i shkelur –

zgjohu, oj! A po e ndien vajin tim?

A po sheh si t'i kam ngulur sytë

mu në zemër, mu në shpirtë,

si t'i kam hedhur duart rreth belit

për të përqafuar, unë - ashti yt?

Zgjohu, Kosovë!

Nga degët e mia të thyera kush po bahet,

këtë vatër kush po e le?

Ç'janë këto gjurmë gjaku që po shtohen?

nëpër fytyrën tënde,

këto varre e murrana që po sillen vërdallë

rreth shtëpisë sime?...

Zgjohu, Kosovë! Zgjohu, nëna ime e dashur,

balli dhe emri im i shkelur –

Zgjohu, Kosovë!...

Sonte vetëm mbeta e -

në derë t'oborrit askush më s'po më troket,

askush më, thua vdekur jam e harruar

në këto troje e suka gjaku;

thua më është shkimbur hisja

e mbyllur dera e konakut...

Zgjohu, Kosovë! – flakë e hershme e ashtit tim

të pëlcitur!

Bota në ty le të kallet!

ALI PODRIMJA

KOSOVA

1.

**Vakna, Kosova! Vakna, kära mor,
min panna och mitt förtrampade namn -**

vakna, du! Hör du inte min gråt?

**Ser du inte hur jag borrar min blick
in i ditt hjärta, in i din själ,
hur jag har lagt händerna runt din midja
för att krama dig, jag - ett ben ur din kropp?**

Vakna, Kosova!

Vem går ifrån mina brutna grenar,

vem är det som lämnar denna härd?

**Vad är dessa spår av blod som bara blir fler
i ditt ansikte,**

**dessa gravar och stenhögar som virvlar
runt mitt hus?...**

Vakna, Kosova! Vakna, kära mor,

min panna och mitt förtrampade namn -

Vakna, Kosova!

I kväll blev jag ensam –

ingen knackar längre på min dörr

**som om jag hade dött och blivit glömd
på dessa blodiga marker och kullar;**

**Som om min arvslott fördärvats
och porten till min boning stängts för alltid...**

**Vakna, Kosova! – en gammal låga ur mina knakande knotor
Måtte världen brinna i dig!**

2.

**Para shtëpisë
më vratë -
Unë qesha.**

**Në degën më të lartë të plepit tim
më varët -
Unë qesha.**

**Në gjinjtë e gruas sime lehonë
pështyet -
dhe ranë perënditë

dhe perënditë
ranë
pas kokës sime.**

2.

**Framför hemmet
mördade ni mig -
Jag skrattade.**

**På den högsta grenen i min asp
hängde ni mig -
Jag skrattade.**

**På min nyss förlösta kvinnas bröst
spottade ni -
och gudarna föll
och gudarna
föll
bakom mitt huvud.**

UJKANI

**Ditën e mërkurë sollën lajmin
Ujkan Ujkani vdiq**

**Ditën e enjtë morën letër nga ai
kurrkujt asgjë për mua mos i besoni**

Ditën e premte hyri xhenazja në shtëpi

**Pikërisht në orën dymbëdhjetë
Ujkan Ujkanin e varrosën**

**Atje poshtë
në udhëkryq**

UJKANI

**En onsdag kom de med budet
Ujkan Ujkani har dött**

**På torsdagen fick de ett brev från honom
tro inte ett ord om mig från någon**

På fredagen kom kvarlevorna hem

**Precis klockan tolv
begravde de Ujkan Ujkani**

**Därnere
vid vägkorsningen**

BUKURIA

Zjata dorën në livadh lulen me këputë

Mos! -fquim i dashur më bërtiti -

Do të vyshket!

Unë qava për saksinë time të thatë.

Qita hapin kalin e bardhë me mbërri -

vashën e ëndërruar kaheerë

Mos! - përsëri m'u gjegj fquim.

Unë qava me mallë edhe atëherë.

Hodha dorën në gjithësi me pikëllim -

çel e mshel syt dritë m'u bë.

I lumi ti! - dikush më mbërriti në përfaqim

e kurgjë tjetër s'pashë e as ndjeva më.

Sot e atë ditë e kërkoh fquim tim të mirë.

SKÖNHET

**Jag sträckte ut min hand på ängen att dra upp en blomma
Gör det inte! - ropade min kära granne till mig -
Den kommer att vissna!
Jag grät över min tomma blomkruka.**

**Jag skyndade på mina steg för att nå den vita hästen -
flickan som jag drömt om sedan länge
Gör det inte! – sa på nytt grannen till mig
Jag grät av längtan även då.**

**Jag sträckte ut min hand mot universum i sorg -
ögonblickligen blev den till ljus.
Du lycklige! – kom någon och omfamnade mig
och jag såg ingenting mer och kände inget alls.
Alltsedan dess söker jag efter min goda granne.**

FILLIMI, REPRIZA

E paNjohura më në fund do ta mbyll Derën

**Pas shpinave tona vrapon Daniel Defo
miku ynë i vjetër**

**Robinson Kruson kërkon
atë zbulues të madh të vetmisë njerëzore**

(Sa shekuj kaluan qysh se ajo Derë u hap)

**Tevona dëgjoj rrapullimën e rëndë të një valleje
kujisjen e bravës frymëmarrjen e bimës në mur
Çelësi na u ndryshk apo fati na la**

Jashtë lojës si po na nxjerr pamundësia

START, REPRIS

Det oKända ska till slut stänga Dörren

**Bakom ryggen på oss springer Daniel Defoe
vår gamle vän**

**Robinson Crusoe letar han efter
denne store upptäcktsresande i mänsklig ensamhet**

(Så många sekler har gått sedan den där Dörren öppnats)

**Senare hör jag de tunga ljuden från en dans
Dörrlåsets gnyende plantans andning på väggen
Är det vår nyckel som rostet eller turen som lämnat oss**

Hur oförmågan kan sätta oss på undantag

MORA UDHËN TË TAKOJ NJERI

**Mora udhën
të takoj Njeri në grumbull
në Shanzelize fjala vjen
apo në Kremlin
po vite u bënë që kërkoj
dhe që s'flas.**

JAG RESTE FÖR ATT TRÄFFA MÄNNISKAN

**Jag reste i väg
för att träffa Människan i mängden
På Champs - Elysées till exempel
eller i Kreml
men det har gått årtal då jag letat
och jag säger ingenting.**

DERI NË FUND (I)

Athua është dita jote e fundit në Spital

Do t'i biem deri në fund athua

edhe kësaj dite të lodhur në Orën e Familjes

Atje larg në hapsirë jam unë Lumi*

Dhe udhëtuam kah ylli ynë që digjet në vetmi

Në jetë në art vrasësit më të mëdhenj janë frikacakët

Mjeshtria e tyre: gjuajtja në gabime dhelpëria

Ti mëso të duash vogëlush Ti mëso të ecësh me këmbët e tua

Mbi të keqen, mbi të mirën mendo me kokën tënde

Kurrë mos pështyj në dashuri as në pleh mallkim i fisit

Shkolla jote antike: të dish të çelësh derën e shtëpisë

në çdo kohë

të dish të thuash fjalën kur duhet thënë

Urrejtja është më e rëndë se vrasja

Me ditë më shikon nga krevati i vjetër: Spitali tepër i vogël

për dhemjet tua

për plagët tua

për ditët për netët tua plot klithje

Spitali tepër i vogël

i vogël tepër

Spitali

Nën të Danubi i thellë i kaltër *

*** Lumi, quhej i biri i poetit, i cili vdiq nga kanceri.**

TILL BOTTEN (I)

**Undrar om det är din sista dag på Sjukhuset
Ska vi gå till botten undrar man
även med denna trötta dag i Familjens Timme**

**Därute i rymden är jag, Lum *
och vi reste mot vår stjärna som brinner i ensamhet**

**I livet i konsten är ynkryggar de värsta mördarna
deras mästergren: att ge tjuvnyp slugheten**

**Lär du dig älska lillpojken Lär du dig att gå på egna ben,
över ondskan, över godheten tänk efter ditt eget huvud
spotta aldrig på kärleken eller på gödselhögen,
stammens förbannelse**

**Din urgamla skolning: att veta hur man öppnar hemmets dörr
i alla tider
att veta hur man säger Ordet när det ska sägas**

Hat väger tyngre än mord

**I dagar har du tittat på mig från den gamla sängen:
Sjukhuset för litet**

**för dina smärtor
för dina sår
för dina nätter fulla av skrik**

**Sjukhuset för litet
för litet
Sjukhuset**

Under den djupa blåa Donau

***Lum, poetens son som dog i cancer.**

MISH I GJALLË

Si të dua

**Në krahun e majtë të rrezaton kobolti
Në krahun e djathtë dyshohet
Në sëmundjen e vjetër**

Si të dua

**Qepe gojë
Memec nuk je
Gjak tjetër rrjedh trupit tënd athua**

Si të dua

**Asgjë nuk të rri bukur
Mish i gjallë**

RÅTT KÖTT

Så mycket jag älskar dig

**på din vänstra arm strålar kobolten
på din högra arm misstänker man
den gamla sjukdomen**

Så mycket jag älskar dig

**du har sytt ihop dina läppar
stum är du inte
rinner det männe ett annat blod i din kropp**

Så mycket jag älskar dig

**ingenting sitter fint på dig
rätt kött**

PIKËLLIMI

**Unë nuk qaj
shi bie vogëlushi im
shkundet plepi i shtëpisë.**

**Unë nuk këlthas
nën dritare vogëlushi im
coft ra korbi i Edgar Allan Posë.**

**Unë nuk luaj vendit
muret lëvizin sendet vogëlushi im
vjeshtë e keqe mori.**

Re e zezë shtëpinë tonë mbështolli.

SORG

**Jag gråter inte
det regnar min lillpojke
det är aspen därhemma som darrar**

**Jag skriker inte
under fönstret min lillpojke
det var Edgar Allan Poes korp som föll död ner**

**Jag rör mig ingenstans
det är väggarna som flyttar på saker min lillpojke
det blev en ond höst.**

Ett svart moln har svept in vårt hem.

UNË NUK JAM AI

Ai pranë dritares

**nuk jam unë
është jot ëmë
që të kërkon në turmë**

Ai në fund të dhomës së errët

**nuk jam unë
është yt vëlla
që përmallshëm fyellit i bie**

Ai para pasqyrës

**nuk jam unë
është jot motër
që flokët shkurton**

Lum Lumi

unë jam ai që derën hap

JAG ÄR INTE DEN

**Den vid fönstret
är inte jag
det är din mor
som söker dig i mängden**

**Den i änden av det mörka rummet
är inte jag
det är din bror
som längtande spelar på en flöjt**

**Den framför spegeln
är inte jag
det är din syster
som klipper sitt hår**

**Välsignade Lum
jag är den som öppnar dörren**

FLETË E BARDHË

Mbi tavolinë

fletë e bardhë. Aty do shkuar:

Lum Podrimja vdiq më 29 shtator 1982.

Por, unë nuk mund ta nënshkruaj vdekjen tënde.

**Në qenie të ndjej si lëvizë, si merr frymë
të shoh në jetë
gjithkund.**

Vdekjen tënde nuk mund ta nënshkruaj vogëlush.

**Varrmihësit le ta qesin emrin
ose bardhësia le të më mbulojë edhe mua
të tërin.**

(Ulpianë, Kosovë, 10 tetor 1981)

VITT BLAD

På bordet

ett vitt blad. Det skall stå:

Lum Podrimja dog den 29 september 1982.

Men jag kan inte skriva under din död.

**I mitt väsen känner jag hur du rör dig, hur du andas
jag ser dig vid liv
överallt.**

Din död kan jag ej skriva under lillpojk.

**Dödgravarna får skriva ditt namn
eller så får denna vithet täcka även mig
hela mig.**

(Ulpiana, Kosova, 10 oktober 1981)

MACA E ZEZË

**në udhëtimin tim
një macë e zezë më ndjek
e shpirti më thotë
në gjysmë rruge ke për të mbetur
e kënga më thotë
kurrë s'do t'më këndosh me zë
e drita më thotë
i verbëri i verbër ka mbetur
e ëndrra më thotë
më kërkoni në zgjendërr
eja e besoj fytyrës në pasqyrë
një macë e zezë më ndjek
nën udhëtimin tim
orën e fatit ajo dikton**

SVART KATT

På min resa

följer mig en svart katt

och själen säger mig

du ska bli kvar på halva vägen

och sången säger mig

du ska aldrig sjunga högt igen

och ljuset säger mig

den blinde ska blind förbliva

och drömmen säger mig

sök ett uppvaknande

tro om du vågar på ansiktet i spegeln

en svart katt följer mig

på min resa

ödets timme är det hon som dikterar

HIJA IME

**Hija ime më mashtron
herë me orë nuk e mbërrij
herë fare nuk e hetoj**

Ç'po ndodh me mua zotynë

**Në horizont dielli sapo duket
zë në thua e bie diku
prej hapësisë së bardhë**

**Unë sillem rreth vetvetes
po hijes sime besën nuk i kam
Ta marr apo ta lë**

MIN SKUGGA

**Min skugga gäcker mig
ibland går det timmar innan jag når den
ibland upptäcker jag den inte alls**

Vad är det som händer med mig min Herre

**På horisonten så snart solen visar sig
möter förhinder och faller någonstans
från den vita rymden**

**Jag snurrar runt mig själv
men jag litar inte på min skugga
Om jag ska ta eller lämna den**

BILAL XHAFFERI

BALADË ÇAME *

**Ylberi, si një përshëndetje e përlotur lamtumire,
u zhduk matane largësive,
mbi kreshtat e flakëve,
nëpër shi.**

**Matanë largësive u zhduk e përflakur Çamëria
dhe gjitha rrugët tona shpien në veri.**

**Ulërin era e Mesdheut mbi trojet e lashta epirote,
mbi të shtrenjtat troje tona stërgjyshore.**

Në kullotat e braktisura kullosin rrufetë.

Ullishtet e pavjelura gjëmojnë si dallgë nëpër bregore.

Dhe kudo toka çame

mbuluar nga retë,

rënkon e mbytur në gjak e lot,

e mbetur shkretë,

pa zot.

Na e tregojnë drejtimin plumbat, që vërshëllejnë në errësi të errë.

Na e ndriçojnë rrugën flakë, që të gjithë tokën kanë përpirë

Pas shpinave tona përplas tufani dyert e shkallmuara të

shtëpive.

Dhe rruget zgjaten e zgjaten në veri.

Ne, popull muhaxhir, ecim nëpër shi...

Lamtumirë,

Çamëri!

* Çamëria është territor shqiptar, i cili padrejtësisht iu dha

Greqisë në Konferencën e Ambasadorëve, në Londrës në vitin 1913.

Greqia pas kësaj kohe me dhunë i dëboi çamët për Shqipëri dhe Turqi,
sidomos pas vitit 1944.

BILALL XHAFERI

TJAMISK BALLAD *

**Regnbågen, som en tårfylld hälsning till farväl,
försvann i fjärran,
över krön av lågor,
genom regnet.**

**Där i fjärran försvann Tjameria i lågor **
och alla våra vägar leder norrut.**

**Medelhavsvinden ylar över Epiros gamla länder *,
över våra förfäders kära marker.**

På de övergivna betesmarkerna betar blixtar.

De oskördade olivlundarna dånar som vågor mot stränder.

Och tjamernas land

överallt täckt av moln,

jämrrar, dränkt i blod och tårar

lämnat öde

herrelöst.

Kulorna, som visslar genom mörkret visar oss riktningen.

Vår väg lysas upp av lågor, som slukat allt land.

Bakom våra ryggar slår stormen mot husens fallfärdiga dörrar.

Och vägarna sträcks ut och sträcks ut norrut.

Vi, ett förvisat folk, måste ge oss av genom regnet ...

Farväl,

Tjameria!

* Tjam (på albanska çam) är ett albanskt territorium, vilket orättvist gavs till Grekland i Ambassadörernas Konferens i London 1913. Efter denna tid drev Grekland med våld tjamer ut till Albanien och Turkiet, särskilt efter år 1944.

** Tjameria, namnet på tjamernas land.

*** Epiros – albanskt område, nu i Grekland.

JANINË, VJESHTË *

**Liqeni i Janinës – luginë plot me ujë
Dergjet i përgjumur në mjegullën mëngjesore,
Shket krahu i pulëbardhës mbi nisinë si tumule,
Me fletët e rrepeve mbulon era shëtitorët.
Xhamitë ekzotike, bija lindore të braktisura
U pozojnë të trishtuara turistëve nga Perëndimi.
Matanë sinorit me tela vijën stërnipat e Pirros *
Dhe kalojnë kryeulur nën rrepet buzë limanit**

**Vjeshta lakuriqe si "missis minifunde",
Fërkohet pas ledheve mjekrosh tërë myshk,
Atje ku Frosina* iu shkëput Ali Pashait *
Dhe në ujrat e ftohta të gjolit u zhyt.
Ashtu është Janina e vjetëruar mënjanuar
Dhe të duket sikur në gjol mengadalë do humbasë
Bashkë me lavdinë e dikurshme të harruar
Bashkë me buçimën e tambureve luftarakë.
Do humbasë në Joaninën e re me neon,
Nën valët e veturave që shkasin asfalteve
Nën hotelet moderne "Ksenia", "Palladion".
Nën tingujt e kambanave dhe këngët e psallmeve...**

**Liqeni i Janinës – luginë plot me ujë
Përkundet i përgjumur në mjegullën mëngjesore.
Që tej sinorit me tela vijën stërnipat e Pirros
Dhe kalojnë kryeulur nën rrepet e shëtitoreve
Me një mendim të heshtur, me një brengë përvëltonjëse.**

* Janina, qytet në Çamëri.

* Pirro, prijës ilir.

* Frosina, qytetëz në Çamëri.

JANINA OM HÖSTEN *

**Janinas sjö – en vattenfylld dalgång
Ligger sömnig i morgondimman,
Fiskmåsens vingar sveper över ön som en gravhög
Med platanernas blad fyller vinden promenadplatserna.
Exotiska moskéer, österlandets övergivna döttrar,
poserar sorgsna för turisterna från väst,
Bortom trådstängslan kommer Pyrrhus ättlingar*
Och passerar med böjt huvud under hamnens plataner**

**Hösten, avklädd som en miss i minikjol,
Smeks över fördämningarnas skäggmossa
Där skildes Frosina* från Ali Pascha *
Och sjönk ner i det kalla träskvattnet.
Nu är Janina föråldrat, förglömt
Och det syns liksom långsamt försvinna i träsket
Tillsammans med sin svunna, förgätna ära
Tillsammans med mullret från stridstrummor
Kommer det att försvinna i den nya Joannina med neonljus,
Under strömmar av bilar som glider fram över asfalten
Under de moderna hotellen "Ksenia", "Palladion".
Under ljudet av kyrklockor och psalmsång ...**

**Janinas sjö - en dal full av vatten
Ligger sömnig i morgondimman,
Bortom trådstängslan kommer Pyrrhus ättlingar
Och passerar med böjt huvud under hamnens plataner
Med en tystnadens tanke, med en brännande smärta.**

* Janina, stad i Tjameria.

* Pirro, illyrisk ledare.

* Frosina, en stad i Tjameria.

*Ali Pascha, albansk hövding som kämpade mot det turkiska väldet.

EJA TRISHTIM

Eja, trishtim,

**eja me hapa fletësh që bien nga degët,
eja me hapa shiu qe këputet nga fletët...**

Eja trishtim,

**eja me hapa tingujsh që dridhen në mbrëmje,
eja me hapa zemrash që rrahin me dhimbje...**

Eja, trishtim,

**o prehër i ëmbël që nuk më braktise kurrë,
o strehë e qetësisë sime,
o ëndërrime të mia,
o gji i shpresës sime.**

Eja, trishtim,

trishtim

eja.

KOM TILL MIG VEMOD

**Kom, vemod,
kom med steg likt blad som faller från grenarna,
kom med steg likt regn som faller mot bladen....**

**Kom vemod,
med steg likt ljud som darrar i aftonen,
med steg likt hjärtan som slår i smärta ...**

**Kom, vemod,
o du ljuva famn som aldrig övergav mig,
o du fristad för mitt lugn,
o mina drömmar,
o bröst med mitt hopp.**

**Kom, vemod,
vemod
kom.**

NË STACIONIN E LARGËT

**Në stacionin e largët në fushë,
Klithi sirena e trenit të fundit.
Mbi çatinë time, si jehonë iu përgjigj kukuvajka.
Kë pres unë sonte?
Kush mori rrugën në errësirë
Dhe i kërrusur përmes shiut,
U nis për tek unë.
Më kot më shkon mendja
Tek ata që më deshën.
Më kot kujtoj sonte
Ata që i desha.
Asnjëri
S'do shkundë pika shiu
Në pragun e derës sime këtë natë.
Rrugën e ka mbuluar
Balta dhe nata
Dhe në errësirë
Askush nuk do niset për tek unë...
Ja, kështu do më rrjedhë tërë jeta,
Larg atyre që më deshën,
Larg atyre që i desha.**

PÅ DEN AVLÄGSNA STATIONEN

**På den avlägsna stationen på fältet,
Ljöd ångvisslan från det sista tåget.
På mitt tak, som ett eko, svarade ugglan.
Vem väntar jag på ikväll?
Vem tog vägen i mörkret
Vem kom hopböjd genom regnet,
Fram till mig.
Förgäves tänker jag
På dem som tyckte om mig.
Förgäves kommer jag ihåg ikväll
Dem som jag tyckte om.
Ingen
kommer att skaka av sig regndropparna
På min tröskel ikväll.
Vägen har täckts av
Lera och natt
Och i mörkret
Kommer ingen att bege sig till mig ...
Således kommer hela mitt liv att rinna på,
Långt från dem som tyckte om mig,
Långt från dem som jag tyckte om.**

TI LULËZON NË PEJSAZHET E TRISHTA

Kushtim Sh.

**Te shtëpia jote pranë periferisë
hidhet mbi lum ura me parmak të drunjtë.
Matanë hapen livadhet mbushur me lule si fildish,
që zbardhëllejnë e llamburitin në muzg...**

**Kur vallë do kthehem përsëri atje
pranë maleve të bakërt,
pranë kodrave me lizvare të kaltër?
Kur do të mbështetëm, si dikur përsëri
te parmakët e urës së drunjtë
mbi livadhet në muzgjet mavi?...**

**Tani lulet e shegëve janë shkundur të gjitha
dhe kokrrat janë vjelur dhe fletët kanë rënë
vetëm ti lulëzon akoma në pejsazhet e trishta,
vetëm ti e ruan pranverën në shpirtin tim.**

**Dhe kur të kthehem unë i ngrirë nga acari i dimrit
do gjej tek ti ngrohtësinë e diellit të majit
do gjejë aromat e luleve dhe këngët e zogjve
dhe dora jote e butë do më shkundë borën prej flokëve
Ashtu, me faqen mbi prehrin tënd do bie në gjumë
gjersa agimi të përhap mjergullat mbi lumë.**

DU BLOMSTRAR I SORGSNA LANDSKAP

Tillägnat Sh.

**Vid ditt hus i utkanten
välver sig över floden bron med sitt räcke av trä
Där bortom öppnar sig ängar fyllda med benvita blommor,
som lyser och bländar i solnedgången ...**

**När får jag komma tillbaka igen dit
till bergen av koppar,
nära kullarna med de blå sluttningarna?
När får jag stå och luta mig, som förr en gång,
mot räckena på träbron
vid ängarna i mörkblå skymning? ...**

**Nu har alla granatäppelträdens blommor skakats ner
och frukterna skördats och löven har fallit
bara du blomstrar fortfarande i sorgsna landskap
bara du bevarar våren i min själ.**

**Och när jag kommer tillbaka, stel av vinterns kyla
hittar jag hos dig majsolens värme
doften av blommor och fåglarnas sånger
och din mjuka hand kommer att skaka snön från mitt hår
Så, med ansiktet i din famn kommer jag att falla i sömn,
tills gryningen sprider dimmorna över floden.**

RESUL SHABANI

GJELI

**Në oborrin tim prej uji dhe dielli,
Mëngjesin e zgjojnë vetëm këngët.
Tani po marrin frymë edhe lulet
Mbuluar me vesë si fëmijët e urtë.
Vala po i flet valës për orën
Që ecën pa pushuar nëpër stacione bote.
Si dikur, edhe tani ora rreh,
E në dritare flakërojnë rreze dielli.
Kënga jote që zgjon e zbuloi
Edhe jorganin e blertë të barit në kopsht.
Asnjë frymë e thellë tani s'pushon
Midis shuplakave të duarve të mia.
Nuk e dite se dita agon
Në fyellin e bariut të dashuruar në bjeshkë
Në oborrin tim prej uji dhe dielli,
Mëngjesin e zgjojnë vetëm këngët.**

...

RESUL SHABANI

TUPPEN

**I min trädgård av vatten och sol,
väcks morgonen endast av sång.
Nu andas även blommorna
Täckta av dagg som snälla barn.
Våg talar till våg om klockan
Som oavbrutet rör sig mellan världens stationer.
Som tidigare slår klockan även nu,
Och mot fönstret flammar solstrålar.
Din sång som väcker lyfte också upp
Det gröna täcket av gräs i trädgården.
Inga djupa andetag vilar nu
Mellan mina handflator.
Du visste inte att dagen grydde
I herdens flöjt förälskad i bergen
I min trädgård av vatten och sol,
väcks morgonen endast av sång.
...**

BABA

**Në duart e tua të çara, koha përsëri
Gjen shtigjet e saj të ndritshme.
Prej buzëqeshjes tënde e kemi ngritur
Një ujërvarë hidrocentrali
Lart në bjeshkë, fyelli buzëqesh
Me zënimin e tij jetik, e
Ai që e stolisi heshtjen tënde
Me hieroglife pikëllimi, pushon
Nën hijen e rëndë të manit
Nën oborr, çatitë e mbuluar me vesë
A është e rëndë dashuria jote,
Sa malli për livadhin e djegur?
Mixhok i butë dhe mixhok i egër
Që përqafton vetëm kur s'je
Në duart e tua të çara, koha përsëri
Gjen shtigjet e saj të ndritshme.**

...

FADERN

**På dina spruckna händer finner åter igen tiden
sina lysande banor.**

Från ditt leende har vi satt upp

Ett vattenfalls kraftverk

Uppe i bergen ler flöjten

Med sin eviga stämma, och

Han som prydde din tystnad

Med sorgmodets hieroglyfer, vilar

Under mullbärsträdets tunga skugga

På gården, där taken täckts av dagg

Är den så tung din kärlek,

Som din längtan efter den svedda ängen?

Du milde gamle gubbe, du vilde gamle gubbe

Som omfamnar endast när du inte finns

På dina spruckna händer finner tiden återigen

Sina lysande banor.

...

MOTRA

**Ma kthe mollën e papjekur
Që ma rrëmbeve në lojërat fëmijërore në liqen,
Ma bëj këngë bilbili, vajin tim
Të fëmijërisë. Nëpër orgraja e zabele,
Ditët e mia rinore, ju përshëndes,
A është kjo degë jargovani
Në duart e mia lule akcie
Dhe erë ftoi? Pranverë dhe vjeshtë;
Pleqëri dhe rini,
Djalëri dhe fëmijëri – jeta me valët po rrjedh
Dhe me vajin e malit kur e rrëmbyen
Puhizën e lehtë me flatra ëndrre.
Po kthehem! A do të të gjej?
Lojërat e fëmijërisë të pakuptimta vallë janë?
Ma kthe mollën e papjekur
Që ma rrëmbeve në lojërat fëmijërore n'liqen.
...**

SYSTEMERN

**Ge mig tillbaka det omogna äpplet
som du rövade ifrån mig i vår barndoms lekar vid sjön,
Förvandla till näktergalens sång
Min barndoms gråt. På ängar och i lundar,
Hälsar jag er, min ungdoms dagar,
Är denna gren av syren
I mina händer en akacieblomma
Och en doft av kvitten? Vår och höst;
Ålderdom och ungdom,
Tonåren och barndomen - livet rinner fram i vågor
Och i bergets klagan när den lätta brisen
Fördes bort på drömmarnas vingar.
Jag kommer tillbaka! Kommer jag att hitta dig?
Är barndomens lekar verkligen utan mening?
Ge mig tillbaka det omogna äpplet som du rövade ifrån mig
i vår barndoms lekar vid sjön,...**

KËNDON KUMRIA

**është vonë dhe njerëzit
i kanë fikur drita e syve
marrë të pi – vetëm s'më pihet
marr të vritem s'më del gjak
dru e gur zhur o valë
vetëm ngjyrë dhe vetëm pikturë
vetëm ngjyrë dhe vetëm pikurë
shpina më shpon në gjumë
zgjuar eci e mbi vete mjegull
a është vërtet vonë
apo ende s'jam zgjuar krejtësisht?
në cilat vite po hyjnë vitet e mia
në të cilat rrudha në cilat valë
a është vërtet koh'e ftohtë
apo fryn një fllad pranvere
ç'po ndodh me shqisat e mia
marrë të marr rrugë e shtrati
vjen pas meje si anije e fundosur
me katërqind duart e mia
mezi i shtrëngoj gishtërinjtë e mi
vetëm kambët përpara më shpien
do të arrij sidoqoftë**

RINGDUVAN SJUNGER

**det är sent och människorna
har släckt ögonens ljus
jag försöker dricka – men ensam kan jag inte dricka
jag försöker döda mig men inget blod kommer ut
trä och sten grus och våg
bara färg och bara målning
bara färg och bara målning
det hugger till i ryggen under sömnen
jag går vaken och över mig dimma
är det verkligen för sent
eller har jag inte vaknat helt?
i vilka år går mina år in
i vilka rynkor i vilka vågor
är det verkligen kallt väder
eller blåser en vårens vind
vad är det som händer med mina sinnen
Jag försöker ta mig framåt men sängen
kommer efter mig som ett sjunket fartyg
Med mina fyrahundra händer
förmår jag knappt sträcka ut mina fingrar
det är bara fötterna som för mig framåt
Hursomhelst ska jag komma fram**

FLOKËT E MEDUZËS

si të bie në shtrat me ty
kaq e hijshme me hije
me hojet e ëmbëlsisë së zbrazët
si të zgjohem nga shtrati yt
i pahelmuar
pika-pika kafshimet
po e kuptove shtratin e vdekjes
si dashuri
ku do ta gjejmë fashinë
që s'i ngjan as vdekjes
as gjumit
po vjen si figurë porcelani
e bronzte
me tingëllimën e xhamtë
si kristale
e bukur për t'u parë
e ftohtë për t'u prekur

Dashuri e butë e lëngshme
gjumë që ëndrën e këndell
me erën e flokut të saj
ata që mendojnë se është
helm
helmi dashuri se është
do të këndellen n'eufori
tri çaste para se t'u zihet
fryma
nën zgurëne trupit limfë...

MEDUSAS HÅR

**hur ska jag göra för att få ligga med dig
så schön du är med ditt utseende
med kupor av tom sötma
hur ska jag kunna vakna i din säng
utan förgiftning
utan dina bett här och där
om du tänker dig dödsbädden
som kärlek
var ska vi då finna den frid
som varken liknar döden
eller sömnen
du kommer som en porslinsfigur
belagd med brons
med en klang av glas
som kristall
för vacker för att se
för kall för att röra**

**En mjuk, flödande kärlek
en sömn som uppfriskar drömmen
med doften av hennes hår
de som tycker att det är
ett gift
att gift är kärlek
kommer att återhämta sig i lyckorus
tre ögonblick innan
de kvävs
av kroppens lymfa...**

POETI PËR VIZITË

**krejt si ti ishte poeti
ngazëllehej me bukuritë që vetëm syri
i vizaton në botën e imagjinuar
dhe pi dy gllënjka ujë shëndeti
për të mirë të zotit të shtëpisë
e pastaj dehet në këngën e çiltër
që e përshpërit nën qiellzë**

**Poeti ishte krejt si bari
shumëzohej nga të prekurit me sqep
të zogut grabitqar
shumëzohej me fjalët e veta
dënesi si grua pa turp
zemrën e vë në një pjatë me ujë të valë
çudi ishte poeti
krejt si ti**

POETEN KOM PÅ BESÖK

**alldeles som du var poeten
han jublar över den skönhet som bara ögat
tecknar i den imaginära världen
och dricker två klunkar mineralvatten
för husets herres välgång
och blir sedan fullkomligt berusad av den rena sången
som han viskar så att den knappt hörs**

**Poeten var alldeles som en herde
förökade sig genom att peka
med rovfågeln näbb
förökade sig med sina egna ord
snyftade som en kvinna utan skam
lade sitt hjärta i en tallrik med kokande vatten
konstigt nog var poeten
alldeles lik dig**

XHEVAHIR SPAHIU

NISJE PA KTHIM

**Do të vijë nata, do të hyjë brenda meje
në ca shitgje të verbëra ku askush nuk ka shkelur,
do të ecë pa e ndier, në majë të gjithërinjve,
si të shkelë mbi një ngrehinë prej qelqi,
dita do tkurret pak nga pak si një mjegull,
nata më në fund do të ketë emrin tim.**

Po nisem për udhë. E vetmja nisje pa kthim.

XHEVAHIR SPAHIU

RESA UTAN ÅTERVÄNDO

**Natten kommer, den ska träda in i mig
på några hemliga stigar där ingen har satt sin fot
den kommer att gå framåt utan att höras, på tåspetsarna,
som om den skulle röra sig i en byggnad av glas,
dagen kommer att krympa bit för bit som en dimma
och slutligen kommer natten att ha mitt namn.**

Jag ger mig ut på en resa. Den enda resan utan återvändo.

NË PYLLIN ME SOKRADHE

Ç'u bënë gjahtarët?

Ku vanë?

**Gjahtarët s'duken,
të gjithë janë plagosur.**

I SKOGEN MED HJORTAR

Var finns jägarna?

Vart tog de vägen?

**Jägare syns ingenstans,
alla är de sårade.**

SHKËMBI

**Mbi buzët e plasaritura të gurëve
përkulet butësisht një fik i egër.
Ndonjë zog që më të rrallë ulët,
sajon një çerdhe në pjesë e pavdekur.
Qumësht i kokrrave bën dritë
mbi trupin e ngritë në heshtje.
T'i vijë goja, pa le të japë shpirt
me ta thënë të vërtetën e tmershme.**

KLIPPAN

**Över stenarnas spruckna läppar
böjer sig mjukt ett vilt fikonträd.
En fågel som någon gång slår sig ned där
reder sitt bo på de delar dit döden ännu inte hunnit
Frukternas mjölk ger ljus
åt kroppen som stelnat i tystnad.
Vore det inte skönt om den skulle öppna munnen
Även om den efteråt skulle ge upp andan
Bara för att en gång berätta den hemska sanningen.**

TOMORRI *

**Mjegulla e var,
Mali s'duket më.**

Fusha ka mbetur pa Zot e pa Zë

*** Tomorri, mali më i lartë i Shqipërisë**

TOMORRI *

**Dimman täcker det överallt,
Bergets syns inte längre.**

Fältet har lämnats utan Gud och utan Röst

*** Tomorri, det högsta berget i mellersta Albanien.**

PËRKTHIMI I LUMIT

**Rri dhe përkthej lumin.
Përkthim i vështirë
ky i ujërave.
Fjalët të rralla,
shprehje të ngurosur,
ritëm i tejkohëve.
Njëqind burime njëzëri
mitin e moçëm kallzonin.
Gjithë natën përktheva lumin.
Në mëngjes
përkthimi ishte zhdukur.**

ÖVERSÄTTNING AV FLODEN

**Jag håller på att översätta floden.
Det är oerhört svårt
att översätta vattnet.
De sällsynta orden,
förstelnade uttryck,
en rytm bortom tiden.
Hundra källor samtidigt
berättade den åldriga myten.
Hela natten översatte jag floden.
På morgonen
hade översättningen försvunnit.**

ART

tek tingujt vdes

tek ngjyrat çmendem

tek fjala vdes çmendem përmendem

KONST

vid ljudet dör jag

vid färgen blir jag galen

vid ordet dör jag, blir galen, vaknar upp

APOTEOZË GRI

**Qielli është gri,
toka është gri,
gri dhe puthja.**

**Buka s'ka erë,
era s'ka erë,
s'ka erë lulja.**

**Ëndrra është gri,
gjaku është gri,
gri edhe zjarri.**

**Molla s'ka erë,
uji s'ka erë.
s'ka erë bari.**

**Moti është gri,
shpirti është gri,
gri edhe kënga.**

**Era pa erë,
buka pa bukë,
pa zemër zemra**

GRÅ APOTEOS

**Himlen är grå,
jorden är grå,
grå är även kyssen.**

**Brödet har ingen doft,
vinden har ingen doft,
inte heller blomman har doft.**

**Drömmen är grå,
blodet är grått,
grå är även elden.**

**Äpplet har ingen doft,
vattnet har ingen doft,
ingen doft har gräset.**

**Vädret är grått,
själen är grå,
grå är även sången.**

**Vinden utan vind,
brödet utan bröd,
hjärtat utan hjärta**

SONTE

**Jetoj brenda syve të tu,
në sytë e mi ti ke shtëpinë.**

**S'jemi vetvete,
secili është tjetri.**

Vera ime ka dy skaje:

njëri në pranverë, tjetri në vjeshtën tënde.

Ti hyn në të djeshmen time,

humb rrugën si ai që ka humbur kujtesën...

Sa do të doje të kishe në duar të djeshmen time!

Sa do të doja të kisha në duar të ardhmen tënde!...

Për të djeshmen time ti mund të pysësh

një lumë,

do lisa, një dem,

edhe varrin,

varrin e nënës.

Krejt e kotë.

T'i lëmë pytjet. Pytjet le të marrin një sy gjumë.

Sonte jemi vetëm e sotme.

IKVÄLL

**Jag bor inne i dina ögon,
i mina ögon har du ditt hus.**

**Vi är inte oss själva,
var och en av oss är den andre.**

**Min sommar har två gränser:
den ena på våren, den andra i din höst.**

**Du kommer in i mitt förflutna,
du går vilse som en som har förlorat minnet...**

Jag skulle önska att du hade mitt förflutna i dina händer!

Jag skulle önska att du i dina händer hade min framtid!

**Om mitt förflutna kan du fråga
en flod,
några träd, en tjur,
till och med graven,
mors grav.**

Allt är förgäves.

Låt oss sluta med frågor. Låt frågorna få sig en gnutta sömn.

Ikväll är vi bara närvarande.

NJERIU PA EMËR

Jam njeri pa emër,

jetoj në balada...

Unë eci dhe kokën s'e kthej,

jam njeriu pa emër dhe në ç'kohën jetojmë nuk e di:

emrin ma kanë kyçur në dosje dhe zyra,

ia shtrëngojnë qafën me rrathë kuqalashë,

ia shtojnë pikëpytjet si kosa kërcënuese,

tmerrohen kur unë dhe emrin im jemi bashkë.

Jam njeri pa emër,

jam emërharruar.

Mos njerëzit kanë harruar të flasin, të shkruajnë?

O zot, më keq akoma:

kanë harruar të duan.

Ku shkoi emri im,

ma tregoni varrin.

Kam frikë se ndonjë ditë do të dal si i çmendur

të kap cilindo për mëngë në rrugë

e ta pyes;

Më thuaj, o njeri:

Si quhem unë?

MANNEN UTAN NAMN

**Jag är en man utan namn,
lever i ballader ...**

Jag går och vänder inte på huvudet,

Jag är en man utan namn och vet ej i vilken tid vi lever:

mitt namn har de låst in i dossier på kontoren,

de klämmer åt dess hals med rödaktiga cirklar,

de ökar frågetecknen som hotande skäror,

de förskräcks när jag och mitt namn är tillsammans.

Jag är en man utan namn,

ett glömt namn.

Kanske människorna har glömt att tala och skriva?

O gud, ännu värre:

de har glömt att älska.

Vart tog mitt namn vägen,

visa mig graven.

Jag fruktar att en dag komma ut som en galning

och ta någon i kragen på gatan

och fråga;

Säg mig, människa:

vad heter jag?

KOKA IME, ÇUDITEM ME TY

**Koka ime,
çuditem me ty.**

**S't'u shurdhuan ata veshë?
S't'u verbuan ata sy?**

**Si të mban qafë e hollë?
Jemi mbi shpatulla ende?
S'u mërzite aty?**

**Koka ime,
çuditem me ty.**

**Të të merrja në duar,
të t'i prekja pak flokët,
ballin bër për plumba.**

**Të të rrokja nën sqetull,
gurë e drurë të këndonin:
shkon njeriu kokëprerë.**

**Në një këngë të moçme
kjo ka ndodhur në njëherë.**

**Po ti prapë si mushka
mizorisht rri aty.**

**Koka ime,
çuditem me ty.**

MITT HUVUD, JAG FÖRVÅNAS ÖVER DIG

**Mitt huvud,
jag förvånas över dig.**

**Varför blev dina öron inte döva?
Varför blev dina ögon inte blinda?**

**Hur kan den tunna nacken hålla dig uppe?
Vi är fortfarande över axlarna?
Blev du inte uttråkad där?**

**Mitt huvud,
jag förvånas över dig.**

**Om jag kunde ta dig i handen,
och beröra ditt hår,
pannan gjord för kulor.**

**Att stoppa dig under armen,
stenar och träd skulle sjunga:
där går mannen med avhugget huvud.**

**Det sägs att i en gammal sång
har detta hänt en gång.**

**Men envist som en eländig åsna
sitter du där du sitter
Mitt huvud,
jag förvånas över dig.**

VETMI

**Po bie nata
pa një yll rrëqethës.**

**Sërish jam vetëm.
Vetëm.**

**Nën dhe si vemje
ndryshku po bren hekur.**

**Sërish jam vetëm.
Vetëm.**

Më griu grija e përditshmërisë.

**Boshin
shurdhan - e di -
s'më merr askush.**

Po shkoj në tjetër vend.

**Përtejshmëria
s'dhemb.**

ENSAMHET

**natten faller
utan en darrande stjärna.**

**Återigen är jag ensam.
Ensam.**

**Under jorden likt en larv
fräter rosten järnet.**

**Återigen är jag ensam.
Ensam.**

Det vardagliga tär på mig.

**Den döva
tomheten - vet jag -
kommer ingen att ta ifrån mig.**

Jag går till ett annat land.

**Bortomligheten
Ger ingen smärta.**

GRI MIZORE

Zogjtë e ngritë mizërojnë në një gri mizore

**Vetëm malet fluturojnë
si skelete.**

Ç'fusha hashashi paske mbjellë, Zot i madh.

**Me gojë e korrin,
me dorë i hamë ndajnatë.**

Zogjtë e ngrirë mizërojnë në një gri mizore.

**Skelete malesh vijnë rrotull
si përçartje.**

GRYMT GRÅTT

Frusna fåglar svärmar i ett grymt grått

**Endast bergen flyger
som skelett.**

Vilka fält med hasch du har planterat, store Gud.

**Vi skördar dem med munnen,
vi äter den med händerna i skymningen.**

Frusna fåglar svärmar i ett grymt grått.

**Bergskelett snurrar runt
som i delirium**

EQREM BASHA

**KËSHILLA DHE DETAJE TË NJË PROJEKTI
URBANISTIK**

**së pari qytetin vendose nga dielli
që të ndritë në mëngjes dhe në mbrëmje**

**Pastaj projekto kanalizimin
që t'i hedhë jashtë mbeturinat
e atentateve të netëve të errëta**

**në qendër
vere monumentin e heroit të panjohur
që të marrë frymë lirisht
në ndërrimin e stinëve**

**dhe
mos ngul rrokaqiejt
që i bëjnë hije njeriut**

**kur t'i shënosh rrugët
le të nisen të gjitha prej zemrës
që të sjellin gjak
në çdo gjymtyrë të qytetit**

**nëse s'ka lumë
derdhi lotët e të dëshpëruarve
nëse s'ka parqe
bëjnë një pyll me flokë të kërleshura**

**dhe mbi të gjitha
projekto qelitë solare
sepse qyteti
së pari vendoset nga dielli**

EQREM BASHA

RÅD OCH TIPS I ETT STADSPROJEKT

**för det första ska staden vetta mot solen
för att belysas morgon och kväll**

**Sedan projekteras avloppssystemet
för att göra av med resterna
efter attentat i mörka nätter**

**I centrum
placeras monumentet över den okände hjälten
för att kunna andas fritt
vid årstidernas växlingar**

**och
bygg inga skyskrapor
som kastar skugga över människorna**

**När ni ska markera gatorna
Låt dem alla utgå från hjärtat
för att ge blod
till varje del av stadskroppen**

**Om det inte finns någon flod
låt då de förtvivalades tårar rinna
om det inga parker finns
gör då en skog av utslaget hår**

**och framför allt
projektera solceller
eftersom staden
först riktas mot solen**

BALADË E ZEZË E NJË DITE TË BARDHË

**shefi i baladës iks me kapelë të zezë
me dorëza të zeza dhe kapotë të zezë
syzi flokëzi vetullzi mjekërrzi
bashkë me dhjetë shok e me syza të zeza
dhe një veturë të gjatë të zezë
në një qytet fatzi thyen një shitore
në mes të ditës së bardhë
dhe prej andej rrugës së shtruar
vrapuan në strofull ta ndajnë prenë**

E zeza fitoi atë ditë të bardhë

**Gjurmët i mbuloi mjegulla e dendur
shefi i bandës iks me kapelë të zezë
me dhjetë shokët e vet dhe automobilin e madh
nën strofullën e zezë ndanë prenë e bardhë
bën llogari-llogaria u doli
shefi i bandës iks u bë supershef
me shefin ypsilon lidhi miqësi afariste
shefi i bandës iks e kapelë të zezë
pas një jave u bë shefi iks ypsilon zezit
me tre nënshefa dhe delta luftëtarë
pastaj shefi i bandës xyzjabcd me kapelë të zezë
me iks nënshefa dhe iks herë delta luftëtarë
- e formoi një ditë në një banket solemn
shtetin e zi me rrugë të zeza e qytete të zi
me ushtri e polici të zezë aparat të zi
me ushtri e polici të zezë aparat të zi
ministra e parlament të zi
në një ditë të bardhë**

EN SVART BALLAD OM EN LJUS DAG

**chefen för ballad x med svart hatt
med svarta handskar och svart överrock
svarta ögon svart hår svarta ögonbryn svart skägg
tillsammans med tio kamrater, med svarta glasögon
och med en lång svart bil
i en stad med svart öde rånade en butik
mitt på ljusa dagen
och därifrån på den jämna vägen
skyndade de till sitt näste för att dela bytet**

Det svarta vann denna ljusa dag

**Spåren täcktes av tjock dimma
gänget x:s ledare med svart hatt
med sina tio kamrater och stora bil
i det svarta nästet delade det vita bytet
de räknade – beräkningen blev färdig
Gänget x:s ledare blev superchef
och med y- chefen blev han affärskollega
gängchefen x med svarta hatten
efter en vecka blev x till svarta y:s chef
med tre vicechefer och Deltakämparna
sedan bildade chefen för xyzjaabcd-gänget med svart hatt
med x vicechefer och x Deltakämpar
- en dag vid en högtidlig bankett
bildade han den svarta staten
med svarta gator och svarta städer
med svart armé och polis och svart statsapparat
svarta ministrar och svart parlament
en ljus dag**

NJË I MARRË LUAN ME FIJE TË SHKREPSËS

**një i marrë luan me fije të shkrepës
pranë tij kalon një plak zështerur
- pështyn në kutin e tij
i marri përsëri luan me fije të shkrepës
e ndez një fije e ndez dy fije
fëmijëve të lazdruar u digjen qerpikët
plaku i kërrusur pengohet në trotuar e bie
pastaj mallkon bastonin e thyer
të marrët tjerë që qeshin pranë lumit
hedhin në të mbeturinat e eshtrave
atij i mbarohen fijet e shkrepës
-ma jepni një fije shkrepse
dhe kalimtari i painteresuar ia fal kutinë
pranë tij gjithnjë kalojnë fëmijët me qerpikë
të përcëlluar**

**i marri qeshet plaku rënkon në trotuar
-ma jepni një fije të shkrepës
dhe i dehuri trupmolitur ia jep një kuti
të marrët tjerë i hedhin eshtrat në lumë
ai ndez një fije i ndez dy fije
pranë tij grumbull kutiash të zbrazura
-ma jepni një fije të shkrepës
dhe njerëzit ia hedhin kutiat
ai qeshte e nuk falenderohet
një i marrë luan me fije të shkrepës
-hej kujdes thërrasin fëmijët me qerpikë
të përcëlluar**

shtrati i lumit u mbush nga eshtrat e hedhura

EN GALNING LEKER MED TÄNDSTICKOR

**en galning leker med tändstickor -
förbi honom går en gamling med en sliten röst
- spottar i hans låda
den galne leker igen med tändstickorna
tänder en sticka och tänder två stickor
bortskämda barn får ögonfransarna brända
den krokige gamlingen snubblar på trottoaren och faller
förbannar sedan den brutna käppen
andra stollar som skrattar nere vid floden
kastar benbitar ner i den
hans tändstickor tar slut
- ge mig en tändsticka
och den likgiltige förbipasserande ger - honom en
tändsticksask
förbi honom går alltid barn med svedda ögonfransar
stollen skrattar gamlingen stönar på trottoaren
- ge mig en tändsticka
och en drucken med utsliten kropp ger honom en
tändsticksask
de andra galningarna kastar ben i floden
han tänder en sticka han tänder två stickor
bredvid honom en hög av tomma tändsticksaskar
- ge mig en tändsticka
och folk kastar till honom tändstickaskar
han skrattade och tackade inte
en galning leker med tändstickor
hallå, se upp, ropar ungarna med svedda ögonfransar
Flodbädden fylldes av bortslängda ben**

UDHËTARI I NATËS SË KËSAJ BOTE

**ai s'është zgjuar si tër bota – në mëngjes
për të dita ka filluar në llogorin e të dëshpruarëve
ka ardhur në këtë botë nga nata
dhe natën ec për të arritur në fund të ditës**

**ai nuk është zgjuar kur lind dielli
as nuk është lindur kur zgjohen milingonat
fundja për të mund të shkruhet poezi
se s'është njeri por urith që rron
me rrënjët e kalbura të kësaj bote
s'është as i vetëm as me shokë
për portretin e tij kërkohen hije
ngjyra të përhimta dhe drita në mjegull**

**ai s'është zgjuar si tërë borta – në mëngjes
por tërë jetës udhëton rrugës së vetë nga skaji
drejt mesit të errësirës
i takon – si thonë – familjes së urithëve
që njerëzit e ndershëm i ndjekin me helm
për t'i ruajtur rrënjët e shëndosha...**

**për të çdo varg vjershe do të ishte i thatë
megjithatë
jeton në këtë botë
dhe meriton
edhe për të thuhet
dy tri fjalë
në një vjershë**

DEN NATTLIGA RESENÄREN I DENNA VÄRLD

**han är inte vaken som hela världen - på morgonen
har dagen börjat för honom i de förtvivalades skyttegrav
han har kommit till denna värld från natten
och på natten går han för att nå fram till dagens slut**

**han är inte vaken när solen går upp
han är inte ens född när myrorna vaknar
likafullt kan det skrivas poesi om honom
för han är inte en människa, utan en mullvad som lever
på ruttna rötter i den här världen
han är varken ensam eller med vänner
till hans porträtt behövs skugga
gråa färger och ljus i dimman**

**han är inte vaken som hela världen - på morgonen
men i hela sitt liv reser han på sin egen väg
från kanten mot mörkets mittpunkt
han tillhör – som det sägs – mullvadarnas familj
som - ärliga människor förföljer med gift
för att behålla rötterna friska ...**

**För honom skulle varje diktrad vara torftig
ändå
lever han i denna värld
och förtjänar
att det sägs även om honom
två eller tre ord
i en dikt**

MENY BALLKANIK

**mos e shtro sofrën e dashur
sonte do të hamë jashtë
do të dalim më herët
do të kthehemi vonë
te ne në Evropë jeta ka ndryshuar
eja me mua e dashur
të pimë një ponç te bari Admiral
marrim dhe një coupe royale
te caffe Montreal
rrugës së bilardo Benny
hedhim një karamboll pas shpine
do të pimë një capuccino
te caffeteria Marilyn
në Florida club një martini me ullinj
mos e shtro sofrën e dashur
sonte do të hamë jashtë
në pizzeria Miami
marrim pizza New Jersey
escoloppe vienesë ne resturant Roma
vemi edhe te Parma
për një coupe macedonienne
që të kthehemi më në fund
vonë në shtëpi
të zbrazim zorrët
në një hale Ballkani**

BALKANMENY

**duka inte matbordet, min älskling
ikväll kommer vi att äta ute
vi kommer att gå ut tidigare
och komma tillbaka sent
hos oss i Europa har livet förändrats
kom med mig min kära
och drick en punsch i Amiralbaren
vi tar också en coupe royale
på Café Montreal
på vägen till Bennys biljard
stöter vi en carambole bakom ryggen
och dricker en Cappuccino
på Cafeteria Marilyn
På Florida Club en martini med oliver
duka inte matbordet, min älskling
ikväll kommer att äta ute
på Miami Pizzeria
och tar en pizza New Jersey
escoloppe viennese på restaurang Roma
vi kommer också till Parma
för en coupe macedonienne
för att slutligen återvända
hem sent
för att tömma tarmarna
i ett balkanskt skithål**

NATË ARGATËSH

**vonë është për të dalë në shesh
e dashur
mbylli zogjtë në kafaz
ver qenin në gjumë
të mos i lehtë hënës**

**Vonë është për ta qarë
e për t'u ankuar
e dashur
vër dorën në zemër
mbyllja kyçin ligësisë
lëri ata që flenë me urrejtje
të djegin llampën e vet
dhe ta mbledhin vrerin në shishe**

**Vonë është për dashuri
e dashur
sotë gjithë ditën kam qenë argat
në tregun e të dëshpruarve
dhe s'më morri kush
të mbjell një farë shprese
në arën e madhe
në fund të zabelit**

**Vonë është për dashuri
vonë
më zgjo nesër herët
nëse s'kam vdekur nga pikëllimi**

DAGLÖNARENS NATT

**det är för sent att gå - till torget
min älskling
stäng in fåglarna i buren
se till att hunden somnar
för att inte skälla mot månen**

**det är för sent för att gråta
och för att anklaga
min älskling**

**lägg handen på hjärtat
stäng onskas lås
låt de som sover med hat
- bränna sin lampa
och samla sin galla i flaskor**

**Det är för sent för kärlek
min älskling
idag har jag hela tiden varit daglönare
på de förtvivlades marknad
och ingen tog mig med
för att plantera ett frö av hopp
på det stora fältet
vid slutet av lunden**

**Det är sent för kärlek
för sent
väck mig tidigt i morgon
om jag inte har dött av sorg**

SHTËPIA E VJETËR

ka rënë gjethi i ftoit

dërrasa të kalbura

që do të digjen për dimër

përhapin erë myku

nuk hapen e mbyllen dritaret

vetëm gjethi i ftoit

plaket e zverdhet

GAMMALT HUS

**kvittenträdets blad har fallit
ruttna brädor
som kommer att eldas upp på vintern
sprider en lukt av mögel
Fönstren varken öppnas eller stängs
endast kvittenträdets blad
åldras och gulnar**

STINË E AKULLT

**jam plakur nga malli
tek pres
i plasaritur si lëkurë deveje**

**më erren sytë para murit
që mbyll horizontin
s'më rrëshqet kafshata
që më mban gjallë**

**stinë akulli
s'iu ngrohën trarët kësaj binaje
jam qyqe që gjëmon
dhe duron**

**vetëm është natë
një frymëmarrje solo
notat e një melodie që përsëriten pa fund
melankoli e njeriut
që me dorë të vet shtiu në vetminë
dhe s'e vrau dot**

ÅRSTID AV IS

jag har åldrats av längtan
medan jag väntar
sprucken som läder från en kamel

Det svartnar för mina ögon framför väggen
som stänger ute horisonten
det går inte att svälja munsbiten
som håller mig vid liv

Årstid av is
förmår inte värma taket på den här kåken
Jag är en olycksfågel som klagar
och uthärdar

det är bara natt
ett solo av andetag
toner av en melodi som upprepas utan slut
mänskans melankoli
som med egen hand sköt mot ensamheten
och inte kunde döda den

ZOGU I ZI

**është ndaluar në mes të natës
ka hedhur një glasë në akullin e ftohtë
si përshtymë e mushkërive të kalbura**

lakuriq i natës

**numëron kufomat e bardha
me kokë teposhtë shikon botën
dhe jetën nga ngrysjë në agim**

roje e errësirës

**s'ka dalë nga ëndrra
s'ka mbirë nga varri
numëron vitet e zeza
dhe pështyn aq ftohtë
në mes të kësaj bote
një këlbazë të akullt**

SVART FÅGEL

**Den har stannat mitt i natten
och kastat sin spillning på den kalla isen
som spott ur ruttna lungor**

nattens fladdermus

**räknar de vita liken
med huvudet neråt ser den på världen
och livet från kvällning till gryning**

**mörkrets vakt
har inte kommit ut ur drömmen
har inte spirat fram ur graven
räknar svarta år
och spottar ut så kallt
mitt i denna värld
ett iskallt slem**

HYRJE NËN KUPTIMIN E NJË VETMIE

**Gjendet dikund një shtëpi e braktisur
mure gërvishtur me kulm të përkulur
në oborrin e saj bari i paprerë
pluhuri i pafshirë dera e patundur**

një qen e ruan

**një njeri i vogël i harruar
mjekërr pa rruar flokë kërleshur
shëtit lart e poshtë sillet si i çmendur
fytyrë humbur shpresë këputur**

qenin e kërkon...

INTEG I ENSAMHETENS FÖRSTÅELSE

**Det finns någonstans - ett övergivet hus
med spruckna väggar med sviktande tak
i trädgården oklippt gräs
damm som inte tagits bort orörlig dörr**

en hund vaktar det

**en förglömd liten gubbe
med ovårdat skägg och tovtigt hår
vandrar fram och tillbaka betar sig som en galning
med förgrämt ansikte med sviket hopp**

han letar efter hunden...

KLITHMË

**Qielli i pastër,
ke frikë ta ndotësh me vështrimin.
I kthjellët,
i kthjellët,
gjer në dehje.**

**Ç'gjëmë!
Mermeri i kaltër krisi,
në dysh u nda
nga një lehje...**

SKRIK

**Rena himmel,
du är rädd att förorenas av en blick
Klart,
kristallklart,
intill berusning.**

**Vilket elände!
Den blå marmorn sprack,
klövs i två delar
av ett skällande...**

E VËRTETA

Fëmijë isha, lodra kërkoja. Nëna vendoste.

Unë flisja i pari. Nëna e dyta.

Mësimin thoshja. Mësuesja vendoste.

Unë flisja i pari. Mësuesja e dyta.

Ëndrra shikoja natën. Dita vendoste.

Unë flisja i pari. Dita e dyta.

Isha me ty. S'doja të ikte drita. Nata vendoste.

Unë flisja i pari. Nata e dyta.

S'doja ta lija atin të vdiste. Vdekja vendoste.

Unë flisja i pari. Vdekja e dyta.

**Nisesha djathtas, përfundoja majtas. Jeta
vendoste.**

Unë flisja i pari. Jeta e dyta.

Unë flisja i pari. E dyta ishte e drejtë.

Po ç'numër vallë kishte e vërteta?

SANNINGEN

Jag var då ett barn, sökte leksaker. Modern bestämde.

Först talade jag. Sedan hon.

Jag redogjorde för läxan. Läraren bestämde.

Fört talade jag. Sedan hon.

Jag drömde på nätterna. Dagen bestämde.

Först talade jag. Sedan dagen.

Jag var med dig. Ville inte att ljuset skulle försvinna. Natten bestämde.

Först talade jag. Sedan natten.

Jag ville inte lämna min far att dö. Döden bestämde.

Först talade jag. Sedan döden.

Jag började från höger, avslutade till vänster. Livet bestämde.

Först talade jag. Sedan livet.

Jag talade först. Det andra var det rätta.

Men vilken i ordningen var det som stod för sanningen?

LASGUSH PORADECI *

**Vdekja e kish harruar. E mahnitur
kish humbur rrugën në vargun e tij
erëmirë.**

**Atë ditë që mbylli sytë
gjoli i Poradecit nga habia**

Si një lot i madh kish ngrirë...

*** Lasgushi, poet, liriku më i madh shqiptar në shekullin 19-të.**

LASGUSH PORADECI *

**Döden hade glömt honom. Överväldigad
hade den tappat bort sig i hans väldoftande vers.**

**Den dagen då han slöt sina ögon
hade sjön vid Pogradec i sin häpnad**

Frusit till som en stor tår...

* Lasgushi, poet, den största albanska lyrikern på 1900-talet.

* Pogradec, en stad vid Ohridsjön, där poeten föddes.

AMANETI I POETIT

**Nëse sytë e tu do të qëndrojnë të menduar
mbi këto vargje,
unë do të shoh
një ëndërr të bukur.**

**Nëse sytë e tu do të dridhen sadopak
nga këto vargje,
unë i gjithi do të kumboj si një kitarë
deri në agim.**

**Po nëse sytë e tu do të kalojnë indiferentë
mbi këto vargje,
atëherë unë do të kem vdekur.**

Mos harro të vish në varrim.

POETENS TESTAMENTE

**Om dina ögon kommer att stå undrande
inför dessa rader
kommer jag att se
en vacker dröm.**

**Om dina ögon om än aldrig så lite kommer att darra
genom dessa rader,
så kommer hela jag att ljuda som en gitarr
ända till gryningen**

**Men om dina ögon kommer att glida oberört
över dessa rader,
då kommer jag att dö.**

Glöm inte att komma på begravningen.

VISAR ZHITI *

CIGARE BURGU

**Grise një copë gazetë
vure pak duhan
të mbledhura nga bishtat e flakur
dhe e drodhe një cigare**

**Lajmet
t'u futën në mushkëri
si tym i hidhur**

Atdheu kollitet i sëmurë.

*** Poeti qe i burgosur politik gjatë regjimin komunist të Shqipërisë.**

VISAR ZHITI *

FÄNGELSECIGARETTER

**Du rev ett papper ur en tidning
lade dit lite tobak
samlad från slängda cigarettfimpar
och gjorde en cigarett**

**Nyheter
kom in i lungorna
som bitter rök**

Fosterlandet är sjukt och hostar.

*** Poeten var politisk fånge under den kommunistiska regimen i Albanien.**

GJITHMONË JAM ME TË MUNDURIT

**Gjithmonë jam me të mundurit,
me përpjekjet e tyre
(që afrojnë dritë).
Deri në fitore,
pastaj iki, i braktis
dhe bashkohem me të mundur të tjerë.**

**... dhe kur arrij ndonjë fitore
ndahem dhe me veten
për të nisur beteja të reja...**

**Vetëm fitoret
pa të mundur
dua!**

JAG ÄR ALLTID MED FÖRLORARNA

**Alltid är jag med förlorarna,
med deras försök
(som närmar sig ljuset).
Tills de når segern,
sedan lämnar jag dem, överger dem
och går över till andra förlorare.**

**... och när jag når en seger
skiljs jag också från mig själv
för att börja nya strider ...**

**Bara segrar
utan förlorare
vill jag ha!**

DRITA E SKËTERRËS

**Pas çdo dritë të vetmuar natën
një dritare jete kam besuar se është. Me dëshirat
digjej...**

**Lukuni dritash këtu rreth e rrotull rrethimit
pa një dritare pa një rrugë. Verbëri
qikllopike krimesh të ndezura.**

**Prozhektorët si hëna të marrosura
në një skenë të fohtë ferri.
Drita pafund si fundi. Fosfor varrezash.
Vdekja është pas tyre, ah,
shkëlqejnë, flakërijnë – lotët e mëdhenj
të atij që shpiku llambën. Ah,
tradhëti dhe natë**

Mbi skeletin e Diogjenit.

HELVETE

**Bakom varje ensamt ljus på natten
trodde jag det fanns ett livets fönster. Med önskningar
brann det...**

**Det är en flock av ljus här runt omkring belägringen
utan ett fönster, utan en väg. En cyklopisk
blindhet av brända brott.**

**Strålkastare som galna månar
i en kall, helvetets scen.
Oändligt ljus som slutet. Begravningsplatsernas fosfor.
Bakom ligger döden, ack,
de lyser, flammor - de stora tårarna
av honom som uppfann lampan. Ack,
svik och natt**

På Diogenes skelett.

TË BURGOSURIT LOZIN SHAH

**Rradhite
ushtarët
në kutitë e tua të zeza dhe të bardha.**

**Dhe ushtarët
me armë
të mbajnë të rrethuar
në kutitë e natës dhe të ditës.**

**Oficerët dhe kuajt i hodhe në sulm!
Kentaurët
gjysmë-kuaj, gjysmë-oficerë të bërtasin
dhe të sulen me patkonj.**

**Humbe një torrë,
dalëngadelë, po e harron shtëpinë.**

**Mbretëresha
doli nga një rrezik, por
nëna jote s'është mbretëreshë.
Ti mbretin e çon ku të duash?**

**Mbreti
bën ç'të dojë me ty.**

FÅNGARNA SPELAR SCHACK

**Du ställde upp i led
soldater
i dina svarta och vita rutor.**

**Och soldater
med vapen
håller dig omringad
i rutor av natt och dag.**

**Officerare och hästar tog du till attack!
Kentaureorna
dessa halvhästar, halvofficerare skriker åt dig
och angriper dig med hovarna.**

**Du förlorade ett torn,
efter hand, men du glömmer huset.
Drottningen
kom ifrån en risk, men
din mor är inte drottning.
Kungen kan du leda vart du vill?**

**Kungen
gör vad han vill med dig.**

PSALM

**Ti je gjunjzuar
para një muri
që s'është i thertoresh,
as i tempullit dhe
po rrëfesh. I sinqertë
nga e keqja.
Rrjedh zëri yt
i dëshpëruar. Dhe
muri lëviz. Të vjen rrotull
si një valle.
Dhe ti në mes të mureve.
Ngrihesh. Fshin dheun nga
gjunjët**

**Bien copa mëkati,
e dot nuk del nga qelia.
Rrëfimi yt
me fatkob se muret. Po
Zoti të shpëtoftë! Mos qofsh
i dënuar me lumturinë e dikurshme!
Amin.**

PSALM

**Du har fallit på knä
framför en vägg
som inte är slakteriets,
eller templets och
du gör bekännelsen. Ärlig
inför det onda.
Din röst flödar fram
förtvivlad. Och
väggen rör sig. Den snurrar omkring dig
som en dans.
Och du mitt emellan väggarna.
Du stiger upp. Putsar bort jorden från
knäna**

**Bitar av synd faller ner,
du försöker men kommer inte ut från cellen.
Din bekännelse
är hemskare än väggarna. Ja,
måtte Gud bevara dig! Vilket gräsligt öde
att vara dömd till den tidigare lyckan!
Amen.**

JANË ZBUKURUAR PLEHRAT

**Janë zbukurar plehrat në atdheun tim,
s'janë vetëm lëkura patatesh,
qepësh e gazetash të hedhura
apo këpucë të kalbura,
apo mace të ngordhura.**

**Janë shtuar plehrat dhe janë zbukuruar
ngjyra-ngjyra si fundi i një ëndrre në mëngjes,
letra çokollatash vezulluese,
ambalazhë gjë e gjëzash,
fotografi lakuriq artistësh të ndaluar,
kuti të bukura pijesh të jashtme,
plehra të shtrenjta: një kasetë, gjysmë manjetofoni,
skelet veture.**

**Ja ca furça dhëmbësh
si picirukë përrallash
që kanë vdekur.**

**Pirgje me plehera, kapakët të veprave të shyqera
të diktatorit,
fotografitë e tij të qeshura dhe pis.**

**Kalojmë anash plehrave, mespërmes plehrave,
plehra në kujtesë, në biseda, në karrierë
Plehrrat ndonjëherë janë më pak të shëmtuara,
të dëmshme edhe më pak.**

AVFALLET HAR FÖRSKÖNATS

**Avfallet har förskönats i mitt fosterland,
där finns inte endast potatisskal,
skal av lök eller bortkastade tidningar
eller ruttna skor,
eller döda katter.**

**Avfallet har vuxit och har förskönats
mångfärgat som slutet på en morgondröm,
glittrande chokladpapper
förpackningar med gåtor,
nakenfoton av förbjudna konstnärer,
vackra lådor för utländska dryckesvaror,
dyrt avfall: ett kassetband, en halv bandspelare,
ett bilchassi.**

**Här är några tandborstar
likt dvärgar i sagor
som har dött.**

**Högar av avfall, omslagen på diktatorns
sönderrivna arbeten,
hans glättiga och sketna fotografier.**

**Vi går invid avfall, genom avfall,
minnets avfall, i samtal, i karriären
Gödseln är mången gång mindre ful,
och mindre skadlig än detta avfall.**

BASRI ÇAPRIQI

DRITAREN LËRE HAPUR

1.

**Dritaren lëre hapur dritaren lëre
të hyjë ajri nga rruga
flaka t'i dalë**

**Dritaren lëre hapur dritaren lëre
ta përpish frymën
të dalë erë e keqe e trupit**

**Dritaren lëre hapur dritaren lëre
të thyhet vizioni në sy të spastrosh shpirtin
nga hapësira e mbyllur**

**Dritaren lëre hapur dritaren lëre
ushton zë epik i poetëve nxitojnë fëmijët të ikin
nga terri nga tingujt e mprehur**

**Dritaren lëre hapur lëre
zbresin bishat nga malet
shkelin mollët në gratë e vdekura**

**Dritaren lëre hapur lëre
shi bie pak ujë sidomos pak ujë
në buzë të plasur vëre**

**Dritaren lëre hapur dritaren lëre
Çlirohu nga epsheet nga faji
përfalu me të vdekurit tuaj sidomos**

BASRI ÇAPRIQI

LÄMNA FÖNSTRET ÖPPET

1.

**Lämna fönstret öppet, öppet fönster
så att luften kommer in från gatan
och så hettan går bort**

**Lämna fönstret öppet, öppet fönster
för att kunna andas djupt
och så den unkna kroppslukten försvinner**

**Lämna fönstret öppet, öppet fönster
så att ögats visioner bryts och själen renas,
från det slutna rummet**

**Lämna fönstret öppet, öppet fönster
en episk stämman ljuder från poeter, barnen skyndar
för att komma från mörkret och de skarpa ljuden**

**Lämna fönstret, lämna öppet
odjur kommer ner från bergen
trampar över äpplen över döda kvinnor**

**Lämna fönstret, lämna öppet
regnet faller, lite vatten, särskilt lite vatten
låt det komma till spruckna läppar**

**Lämna fönstret öppet, öppet fönster
Befria dig från begär, från dina fel
sök förlåtelse särskilt från dina döda**

2.

**Dritaren lëre hapur dritaren lëre
me qentë ta bësh gjumin me insektet
me shpirtrat e territ me zërat e largët**

**Dritaren lëre hapur dritaren lëre
kufomat janë bashkudhëtarët tuaj të sinqertë
shih
ata s'të vrasin s'të zënë kalimthi frymën**

**Dritaren lëre hapur dritare lëre
para se të niseni në atë udhëtim të fundit
me nga një ombrellë të çeliktë shi i kuq pikë**

**Dritaren lëre hapur dritaren lëre
thyje pasqyrën katrore me fytyrën tënde
në kënd të dhomës
e nisu**

**Dritaren lëre hapur dritarën lëre
se ti je i vdekur në ushtrinë që marshon nga qielli
mbylle derën mbylle**

Mos të dalin bishat dhe njerëzit

2.

**Lämna fönstret öppet, öppet fönster
för att sova med hundar, med insekter
med mörkrets andar, med avlägsna röster**

**Lämna fönstret öppet, öppet fönster
liken är dina ärliga medresenärare
se
de dödar dig inte, inte heller kväver de dig i förbifarten**

**Lämna fönstret öppet, öppet fönster
innan ni inleder den sista resan
var och en med sitt stålparaply,
på vilket droppar av rött regn faller**

**Lämna fönstret öppet, öppet fönster
krossa den fyrkantiga spegeln med ditt ansikte
i ett hörn av rummet
och ge dig av**

**Lämna fönstret öppet, öppet fönster
för du är död i armén som marscherar från himlen
stäng dörren, stäng den**

Så att inte vilddjur och människor slipper ut.

QIRINJTË

Habitem sa pranë më rrinë

Qirinjtë që

Ndez ti

Me sy të përflakur

Atje përtej më ikin parajsat

Të humburat

Veç kështjella nguliten

Është fati që

Të vë atje lart dhe

Digjesh kot për mua

Habitem sa pranë më digjen

Qirinjtë

Them me pasë pak frymë

Me fikë trupin

LJUSEN

**Jag är förvånad hur nära de står mig
Ljusen som
du tänder
Med dina brinnande ögon**

**Där bortom himlen flyr paradisen
De förlorade
Bara slotten står fast**

**Det är ödet
Som sätter dig högt där uppe och
du brinner förgäves för mig**

**Jag är förvånad hur nära mig de brinner
Ljusen
Och jag säger att finge jag bara lite ande
För att släcka min kropp**

E PAARRITSHMJA

**Ajo më shpinte diku larg
Ëndrrën mbi krahët e një vale**

**Heshtja përgjon tingujt
Zhyten e dalin thërrmijash**

**Mbi kurriz të ujit
Një kalimere [*] s'më lë të ngrohem**

Më zë ëndrrën në grykë të Bunës

**Përpëlitet një pulëbardhë
Ikën pastaj**

E paarritshme si gjithnjë

**Ngul një gjëmë në gjoks
E vdes i lumtur**

**Se s'di ç'ndodh në gjoks
E vdes i lumtur**

**Mbi atë mjegull që
Mbulon gjithë brigjet gjithë fushat**

E ujin sidomos

**Ujin ku Zoti di ç'zihet brenda
Atyre rrjetëve me gogla të**

**Rrumbullakta si sy të tmerrshëm
Mbetur hapur kah qielli**

** Kalimere – mjet primitiv peshkimi që përdoret në Ulqin*

DET OÅTKOMLIGA

**Den förde mig långt bort
Drömmen på vingarna av en våg**

**Tystnaden avlyssnar ljuden
som dyker ner och kommer ut ur partiklarna**

**På vattnets rygg
låter mig en kalimere [*] inte värmas**

Den fångar min dröm vid Bunas utlopp

**En fiskmåå vrider sig i vånå
och flyr därefter**

Oåtkomlig som alltid

**En olycka sårer sig i bröstet
och jag dör lycklig**

**För jag vet inte vad som hånåer i bröstet
och dör lycklig**

**På den dimma som
Tåcker alla kuster, alla slårer**

Och vattnet, sårskilt

**Vattnet där Gud vet vad som kokar inuti
De nåt av bollar**

**Runda likt hemska ögon
stående öppna mot himlen**

** Kalimere -primitivt fiskeredskap som används av fiskare i Ulqin, Montenegro.*

FRUTAT BIZARE

**një gjethe fiku gjakoi në këtë muzg
të fsheh frutat bizare**

**Posa mbuloj nga pëlçitja atë peshë magjike
mespërmes këmbëve ajo përshkon yjet**

**Sa dritë e bukur me vdekë për vetën time
thërret vargje
ai që përflakë qiellin e zymtë**

**Nga turma kah fiket ngadalë pikëllimi
ajo më vjedh me sy të njomur
kur unë ha peshkun e kuq
dhe thërmoi putarkët e një sallmani të zbutur**

**Mbi trotuar nata puthë
pluhurin e yjeve që bien një nga një
mbi trishtimin e asaj dite që vdiq
duke mbuluar çastin tim në**

Një ëndërr të ligë

BISARRA FRUKTER

**ett fikonlöv släppte ut blod i denna skymning
för att dölja de bisarra frukterna**

**Just när det täckte den magiska vikten
mellan benen passerar den genom stjärnor**

**Vilket vackert ljus att dö för mig själv
kallar verser**

han som flammar den dystra himlen

**Från folkmassan där det slockar sorgen
Hon tjuvtittar med sina daggiga ögon
när jag äter rödfisk
och krossade putarköt av en smidig sallmani**

**På trottoaren kyssen natten
damm av stjärnorna som faller en efter en
över vemoden av den dagen den dog
täckande min ögonblick i**

En ond dröm

DHOMA IME NË PRISHTINË

1.

Të gjitha gjërat që i le në mbrëmje përmbys

Të kullojnë gjakun e kuq të mishit që sjell

Nga pyjet përreth

Në mëngjes varen në çengelat mbi furrë

Krejt hallin e kam

Të zënë vend një herë e mirë enët

Në skajin ku zakonisht strukej macja

Në skajin ku zakonisht

Gruaja drejtonte vazot e luleve kah drita. Në skajin ku

Fëmijët grumbullonin lodrat Në skajin ku linim

vend bosh që

Të hapet dera tani

Tani vara kapelen fitonjtë e zverdhur në një gozhdë

të përflakur

Dhe mund të mbyll derën nga brenda me

dorën e zgjatur

Në murin ku më parë rrihte ora. Në gozhdën

Ku varja një sy të bardhë rrethuar me të zezë

Mbi perden

Ku përvidhej një merimangë tani

Tani fryj pluhurin e shtuhisë që derdhej mbi pullaze

ftohtë në mes të dritës së ligë

MITT RUM I PRISHTINA

1.

**Alla saker som jag igår kväll lämnade åt sitt öde
för att låta det röda blodet rinna från köttet som jag tagit hem
Från de omgivande skogarna
Hänger på morgonen på krokarna över ugnen**

**Hela mitt bekymmer är
att lägga kärlen ordentligt
I hörnet där katten brukar gömma sig
I hörnet där min hustru
Brukade ställa blomvaserna i solen. I hörnet där
Barnen lägger ihop sina leksaker. I hörnet där vi lämnade
en tom plats
för att nu öppna dörren -**

**Nu - hängde jag hatten, torkade kvitten på en
brinnande spik
Och jag kan stänga dörren inifrån
med min utsträckta hand**

**På väggen där klockan gjorde tick-tack. I spiken
Där jag brukade hänga ett vitt öga rundat av det svarta
På skynket
där en spindel nu smyger fram**

**Blåser jag nu på stormens damm som spreds över taken
det är kallt mitt i det onda ljuset**

2.

Teli në ballkon i shtirë lakuriq që

Pret teshat të varë të bardhat

Liruan nga erë e rëndë dhe nga pesha e trupit

Tim që shtrihej tek ujët e trazuar tani

Tani jam unë ai që hap me rrëmbim xhamat

Të mos pëlcasin nga ulërима e Bindit

2.

**Tråden hänger utsträckt naken på balkongen och
väntar på kläderna som ska hängas vittvätten
Befriade från dålig lukt och min kropps tyngd
som nu ligger utsträckt vid det rastlösa vattnet**

**Nu är jag den som hastigt öppnar fönstren
för att de inte ska sprängas av Binds ylande**

DHOMA IME NË ULQIN

**Edhe kur unë s'jam aty
Nëna hap dritaren kah deti**

**Vjen hëna vijëzohet në qelq
mbush hapësirën me trupin tim**

**Nëna hap dritaren kah deti
edhe pse unë s'jam aty**

**të hyjë erë e mirë me jord
se unë marrë frymë diku**

**në teh të një ere
kah lë derën hapur**

MITT RUM I ULQIN *

**Även när jag inte är där
Öppnar mor fönstret mot havet**

**Månen kommer och tecknar sin linje i rutan
fyller utrymmet med min kropp**

**Modern öppnar fönstret mot havet
trots att jag inte är där**

**Släpp in den goda doften av jod
så jag kan andas någonstans**

**på eggen av en vind
medan jag lämnar dörren öppen**

Ulqin, en stad vid adriatiska havskusten, bebodd mest av albaner.

MA QETË GJUHËN

**Më rri matanë pikëllimit matanë mollës së lashtë
ma bën me gjuhë në vjeshtë ma vjel guximin fatin
unë kafshoj gjuhën time e bëj grimë me dhëmbë
me shpirt
me qet gjuhën ma qet gjuhën, qet gjuhën
kjo është vetëm një dert në pikën time të ujit
rrokulliset nëpër të lagurat e intelektit të sedrës
pika ime**

DU RÄCKER UT DIN TUNGA ÅT MIG

**Du står bortom sorgen, bortom det gamla äpplet
du räcker ut din tunga åt mig om hösten, du skördar mitt mod,
mitt öde**

**jag biter mig i tungan, skär den i bitar med tänder
och själ**

**och du räcker ut tungan, räcker ut tungan, räcker ut tungan mot
mig**

**Det är bara ett bekymmer i min vattendroppe
den rullar genom min intellektuella heders väta
min droppe**

MIMOZA AHMETI

NOCIONE TË SHKRETA

**Nocione të shkreta,
në vetmi hapësirë prej jush të përbërë
kaloj inerci bashkë me ju,
në hapësirën time të përbër prej meje,
si në një qytet ku sapo kanë ikur të gjithë,
përgjithmonë
me një ndjenjë absolute moskthimi
(gjë e cila, e di, nuk mund të ngjasë.)
Nocione të shkreta,
të mbetura hava, jashtë çdo lidhjeje,
nga shkaku i mjerë dhe madhështor,
që unë nuk ndjej më.**

MIMOZA AHMETI

STACKARS ANINGAR

**Stackars aningar,
i ensamhetens utrymme som utgörs av er
är jag kraftlöst tillsammans med er,
i mitt utrymme som utgörs av mig,
som i en stad där alla just har flytt,
för alltid
med en absolut känsla av icke-återvändo
(en sak som jag vet inte kan hända)
Stackars aningar,
hängande i luften, bortom allt samband,
av det eländiga och upphöjda skälet
att jag inte känner mer.**

LETËR MAMKËS

Mamka,

**mos ta lexojë këtë letër tjetërkush veç teje,
jo se është sekrete, por ende nuk jam e fortë plotësisht
për t'i mundur këto që po të them:**

**Tirana është fare e zakonë:
me ngushtësinë e shtëpive të ulëta,
me udhët e lodhura të dimrit,
me një pesëmbëdhjetëkatësh në qendër
ngritur si utopia ime,
me roje të përforcuara në udhëkryqe
ambasadash,
me policë-qukapikë qershori të zbehur.**

Diç parandjej, mamka!

**Kurrë shteti nuk ka qenë kaq përballë njeriut,
kurrë tradhtia e burrave nuk ka qenë më në modë,
kurrë gjumë më të rëndë nuk kanë fjetur netët
dhe gratë më të humbura, më të zbrazura.**

BREV TILL MAMMA

Mamma,

**det här brevet får inte läsas av någon annan än dig,
inte för att det är hemligt, utan för att jag inte är helt stark
för att klara av det som jag kommer att säga nu:**

Tirana * är en helt vanlig stad:

**med hopträngda små hus,
med trötta gator på vintern,
med ett femtonvåningshus i centrum
som reser sig som min utopi,
med förstärkta vakter på korsvägar
vid ambassaderna,
med poliser - hackspettar i junis bleka ljus.**

Jag anar något, mamma!

**Aldrig har staten stått så mittemot människan,
aldrig har männens svek varit mer på modet,
aldrig har nätterna sovit en tyngre sömn
och kvinnorna aldrig varit så värdelösa, så uttömda.**

*** Tirana, huvudstad i Albanien.**

2.

**Po të them, e dashur, rreziku po më fton duke qeshur
me gojën pa dhëmbë të një dashurie kafshuese
me çarje në karakter,
që ëshë te një pjesë e çarjes shoqërore,
po më ofrohen detyra, miq e të njohur të shumtë,
të gjithë të lartë nga emrat, por të ulët
nga tensioni i jetës,
përpiqen të më ngrenë duke u kapur pas meje,
po më rrëzojnë ende pa u ngritur.**

**E dashur, dëgjomë pa shqetësim,
unë do t'i grij, do t'i grij, po të them,
si në makinën e mishit
në vargjet e mia.**

2.

**Jag säger dig, min kära, att faran bjuder mig leende
med en tandlös mun i en bitsk kärlek
med sprickor i karaktären,
som finns i en del av det spruckna samhället,
det erbjöds mig jobb, vänner och många kända,
allra högst som namn, men låga
av livets spänning,
försöker höja mig genom att ta bakom efter mig,
de håller på att störta mig medan jag inte har höjt än.**

**Min älskling, hör mig utan oro,
Jag ska skura dem, jag ska skura dem, säger jag,
som i köttfärsmaskinen
i mina verser.**

ËSHTË ÇUDI KUR JE FEMËR

1.

**Mua tani më vjen për të qarë. Më duket sikur
shkarkesa yjesh më janë grumbulluar te sytë.**

**Dot nuk duroj,
ndërsa çengelat e nervave nderas tërhiqen
kundrejt njëri-tjetrit.**

**Kangur me foshnjën në xhep
duket figura ime së largu
këtu në bregdet.**

**Më vjen për të qarë. Jam me barrë.
Me siguri molusqet e buta tani
lëviznin kapakët e fortë brenda ujit
dhe kandilët e kuq
kushedi ç'udhëtim të mahnitshëm
kanë marrë.**

DET ÄR KONSTIGT NÄR DU ÄR KVINNA

1.

**Nu känner jag lust att gråta. Det känns som om
en urladdning av stjärnor har samlats i ögonen.**

**Jag står inte ut längre,
medan nervernas krokar dras
mot varandra.**

**Känguru med sin unge i påsen
så ser min figur ut på håll
här på stranden.**

**Jag känner lust att gråta. Jag är gravid.
Säkert rör nu de mjuka molluskerna
sina starka skal nere i vattet
och de röda maneterna
vem vet vilken märklig resa
de har börjat.**

2.

Është çudi kur je femër...

**E kemi parë natyrën kur tmerrohet, fryn
e shkatërrohet!**

**Kur si përbindësh shkrifëron gjermadhat
e mohimit...**

**Pastaj, kur pastaj, e lehtë dhe trandur,
me sytë e mëdhenj plotë hije
pret një vazhdim, një lindje fëmije
buzë një deti kur i vjen për të qarë,
ngaqë se si është, është me barrë.**

**Në ato orë të ditës kur molusqet e buta
hapin kapakët e fortë brenda ujit
dhe kandilët e kuq**

kushedi udhëtim të mahnitshëm kanë marrë...

2.

Det är konstigt när du är kvinna ...

**Vi har sett naturen när den blir hemsk, då
vinden viner och förstör!**

**När den som ett monster skakar om förnekandets
ruiner**

**Då, när hon då, enkelt och skakande,
med stora ögon fulla av skugga**

**väntar - en fortsättning, att föda ett barn
vid stranden av ett hav när hon har lust att gråta,
på grund av hur hon är, att hon är gravid.**

**I de tider på dygnet då de mjuka molluskerna
öppnar sina starka skal nere i vattnet**

och de röda maneterna

vem vet vilken märklig resa

de har börjat.

MELANKOLI E MBRËMJES

**Thua do të harrohen flokët e mi të bakërt,
vija eshtore e artë midis krahorit tim,
dy syte elektrikë, dy buzët zjarrduruese
dhe këmbët muskuloze, të lehta ecarake...
Krahët e mi shtrëngues si hallka të një prange.
Thua do të harrohen pëllëmbët e mia si fati?
Melankoli e mbrëmjes shiu i pasditës,
lëngu i syrit dridhë ditë enigmatike.
E tepërt do qe fjala sikur rinia ime
dhe jeta me gjithë puthjet
sërish të përsëritej...**

KVÄLLENS MELANKOLI

**Du säger att mitt kopparröda hår kommer att glömmas,
den gyllene linjen längs mitt bröstben,
två eldiga ögon, två eldtåliga läppar
och muskulösa ben, lätta att gå med...**

Mina omfamnande armar som länkar på en boja.

Du säger att mina handflator kommer att glömmas, likt ödet

Kvällens melankoli eftermiddagens regn,

ögonvätskan skakar kring under gåtfulla dagar.

Du önskar så mycket att ordet likt min ungdom

och livet med alla kyssar

upprepas igen ...

SHQISË, SHQISË

**Shqisë, o viktima ime e parë,
prapë u hape, prapë po thith, e pastruar
rikthehesh në jetë.
Truri si një djall të përdor,
i yshtur për krim të pakapshëm nga ligji.
Shqisë, o viktima ime e shenjtë,
kështu dhe sonte,
e kthjellët,
(o zot, sa e bukur je, kur e kthjellët je)
tërheq e thith por s'përmbushesh.
Asgjë s'të përgjigjet, asgjë s'të përket,
dhe ty, e dashur, - prapë të duhet të japësh.
Por sonte, as për t'i dhënë kush s'të pret,
askush s'të do, o shqisa ime.
Dhe truri, ky djall magjik
tani po qan.
Dhe sa mëkat që është
kur qanë një djall !?**

SINNE, SINNE

**Sinne, mitt första offer,
på nytt öppnade du dig, på nytt suger du, renad
återvänder du till livet.**

**Hjärnan använder dig som en djävul,
manad till brott som inte omfattas av lagen.**

**Sinne, du mitt heliga offer,
så även i kväll,
så klart,**

**(Gud, vad vacker du är, när du är klar)
du drar och suger men får aldrig nog.**

**Det är ingenting som passar dig, ingenting tillhör dig,
och du, min kära, återigen har du att ge.**

**Men ikväll, ingen förväntar sig att få något från dig,
ingen tycker om dig, mitt sinne.**

**Och hjärnan, denna magiska djävul
gråter nu.**

**Och så synd, så synd det är
när en djävul gråter!?**

DELIRUM

1.

**I thyer,
i errët,
i vvertë,
qëndroj, dritë lëshoj...
I thyer në pikën më të dobët,
të të mbeturit
në vetmi...**

**Oh, gjeniale është kjo gjendje,
kur e kuptoj që gjithçka kam humbur,
lumturinë e pafundme ndjej,
të qenies sime
që e kam në dorë,
atë,
që s'mund të ma dhurojë
asnjë lavdi, kurorë.**

DELIRUM

1.

**Bruten,
mörk,
bitter,
står jag, ger ljus...
Bruten i den svagaste punkten,
av att vara
i ensamhet...**

**Åh, detta läge är genialiskt,
när jag inser att jag har förlorat allt,
känner jag en oändlig glädje,
över min varelse
som jag har i handen,
det,
som jag inte kan få till skänks
av någon härlighet, av någon segerkrona.**

2.

Lavdi! Ç'është kjo fjalë?

**Nga mbërriti tek, unë,
si ke dalë?**

Shpikje!

**(Me siguri
ndonjë ambicion i dobët,
i panatyrë).**

**Kthehem nga kthehem, te natyra mbërrij:
qëndroj, dua ta gjykoj, prapë tërhiqem.**

Kaq i bukur dhe njëherësh i vdekshëm, njeri.

Kaq i zemërt dhe prapë i vetmuar.

Kaq fuqi dhe po aq dyshim...

**Përse ikni prej meje krijesa reale,
jetoj në jetë sendesh gjithmonë të paqenë
dhe vetëm vetveten e kam në duar...**

**Oh, nuk ka lumturi si kjo,
dhe pikëllim si ky.**

2.

Ära! Vad betyder detta ord?

Hur kom det till mig

hur uppkom det?

Uppfinning!

(Förmodligen

en svag ambition,

utan natur).

I vilken riktning jag än går tillbaka, kommer jag till naturen:

jag står där, vill bedöma men drar mig tillbaka.

Så vacker och samtidigt dödlig, människa.

Så hjärtlig och ändå så ensam.

Så mycket kraft och lika mycket tvivel ...

Varför springer ni ifrån mig, ni verkliga varelser,

jag lever ett liv bland alltid obefintliga saker

och bara mig själv har jag i händerna ...

Åh, det finns ingen lycka

och inte heller någon sorg som denna.

PJALMIMI I LULEVE

**Ishte një vogëlush si drita
me sytë si nata
i gjithi yll.**

**Qëndroi përpara humnerave të mia,
i befasuar thirri:
Zonjë, ju po rrëzoheni!**

**E di, i pëshpëriti vështrimi im,
dhe me krahët e mi e pështolla-
puthjen e tij të qumësht si seks i tij -
aq mund të më dhuronte të më shpëtonte.**

**Gjithë ditën fekondonte lule
dhe në mbrëmje, kur e pickonin yjet,
vraponte, thërriste:
Zonjë! Ju po vdisni, ju po gremiseni!
dhe prapë një puthje qumësht...**

BLOMMORNAS POLLINERING

**Det var en telning som ljuset
med ögon som natten
helt som en stjärna.**

**Han stod framför mina avgrunder,
och ropade förvånat:
Frun, ni håller på att falla!**

**Jag vet, viskade min anblick,
och med mina armar famnade jag om honom -
hans mjölkaktiga kyss likt hans kön -
så mycket kunde han ge för att rädda mig.**

**Hela dagen befruktade han blommor
och på kvällen, när stjärnorna började sticka honom,
sprang han och ropade:
Frun! Ni håller på att dö, ni faller ner i avgrunden!
och igen gav han mig en mjölkakig kyss ...**

LINDITA AHMETI

GRAFIKË NË QELQ

**brendinë e kullës sime e ka vizatuar acari në qelq
me thellësitë e natës dimërore
e ka qëndisur
me fije të argjendit të ftohtë
me shkëlqim të bardhë
tash kur duhet të derdhet një grusht dritë mëngjesi
në ditaret e mia
duken përplotë bulëza simbolesh
pemë dadaiste pa gjethe a fruta
një lypës i vogël mbuluar me borë mbi urë
me një kurorë të ngrirë yjesh përmbi kokë
dorën e hollë e ka zgjatur për lëmoshë...**

**Nuk duket as pika e zezë pas çunit
borë borë
e mbi rrafsh rrokulliset fjala pranverë
dhe vullnesa e Perëndisë**

ANDRRA ZHURI DJEG VETMINË TIME

**po më mundon një varg me nyje
me kërcënime se do të më thyej mua,
arrën e pathyeshme,
me kërcënime që t'i çojë duar unë
shfaqet dikah andrra zhuri e vogël
zbret nga degë e lulëzuar e qershisë
ku këndojnë bilbilat
apo del nga tufë e trëndafilave të verdhë
që qëndron mbi tavolinën time
unë nuk e di
unë vetëm e shoh flakën e gëzimit që solli ajo
ah moj andrra ime e vogël
i them unë
ajo më hidhet në përqafim
pastaj trëndafilat e verdhë bëhen të kuq
librat e kopertinave zbardhen
dhe e vërej tymin e vetmisë që tërhiqet nga dhoma
dhe lindjen e gëdhendur e të lëmuar
të vargut.**

LÄNGTANS DRÖM BRÄNNER MIN ENSAMHET

Jag plågas av en vers med knutar
som hotar att den ska knäcka mig
den oförstörbara valnöten,
med hot för att få mig att ge upp
men då visar sig någonstans ifrån
min lilla längtans dröm
som stiger ner från blomstrade körsbärsgrenen
där näktergalarna sjunger
eller kommer från en bukett av gula rosor
som ligger på mitt bord
jag vet inte
jag ser bara flammen av glädje som den för med sig
ack min lilla dröm
säger jag
den kastar sig om min hals
sedan blir de gula rosorna till röda
böckernas omslag blir till vita
och jag ser hur ensamhetens rök drar bort från rummet
och hur en snidad och polerad versrad
föds.

BËJMË SIKUR ECIM PA TOKËN NËN KËMBË

**këtu ditët përplasen prej një muri në tjetrin
si vala e shqetësuar e detit në bregun e zi
e nuk ecin
nuk ndërrohen
duket një tel që zgjatet lidhur nga një ditë në tjetrën
e ne të
në të pra
neve meitëve na kanë varur varg
jemi te varuar ne e s'e shohim
e bëjmë sikur ecim pa tokën nën këmbë
kurse ata
eh ata janë njerëz të mirë
që ecin për toke
e që e dinë punën e tyre**

**prandaj e kanë vjedhur mollën e verdhë flori
e kanë hedhur para nesh
ja një mollë na thonë
ta hani
e molla na ha neve
kurse ne mbetemi varur si hije në tri ditë të gjata
ata janë njerëz të mirë
derisa ne qëndrojmë varur mbi ditët e zeza
ata i punojnë arat tona
na i vjelin pemët
njerëzit e mirë**

VI LÅTSAS ATT VI GÅR UTAN MARK UNDER FÖTTERNA

**här stöter dagarna ihop från en vägg till en annan
som havets rastlösa våg mot den svarta stranden
och inte går de framåt
de förändras inte
det syns en tråd som sträcks ut och förenar en dag med en annan
och i den
alltså i den
har man hängt upp våra lik i rad
vi är hängda och ser inte
och låtsas att vi går utan mark under fötterna
medan de
ja de är goda människor
de som går på marken
och som vet sin egen sak**

**därför har de stulit det guldgula äpplet
och har kastat det framför oss
här har ni ett äpple sa de till oss
för att äta
men äpplet äter oss
medan vi förblir hängande som skuggor i tre långa dagar
de är goda människor
medan vi förblir hängande över svarta dagar
de arbetar på våra åkrar
skördar frukterna
de goda människorna**

U FIK DRITA

**u shter drita në dhomë
nisi të kullojë shpresa në rërë
kodra e shtatë i doli mëngjesit përpara
horizonti u mbyll
ai mbeti matanë
u fik serenanda e premtuar**

LJUSET SLÄCKTES

**ljuset i rummet tömdes ut
hoppet började rinna ut i sanden
den sjunde kullen reste sig framför morgonen
horisonten blev stängd
han förblev utanför
den utlovade serenaden släcktes**

SADIK BEJKO

PËRMBYSJE E QETË

Me është përmbysur një jetë aty

Dhe asgjë s'ka ndryshuar.

Në fytyrën që me çudi shoh nga larg:

Anija e mbytur, faqja e detit e qetë...

Jetë e qelqtë e thye pa një krak.

SADIK BEJKO

TYST OMSTÖRTNING

Hela mitt liv har omstörtats där

Och ingenting har förändrats.

I ansiktet som jag förvånad ser på långt håll:

Ett sjunket skepp, havsytan lugn...

Livet av glas krossades utan minsta smäll

LETËR HAMURABIT *
NGA MURARI I SHPELLËES ARAM

1.

**Imzot Hamurab, mua plakun e përvojtur
Pse më nxore nga shpella ime,
Nga budallallëku im pse më nxore?!
Nën drita e shandanëve me arin e gjithë botës
Shkruaj sot rreshtin e fundit në kode.**

**Jam shpella ime e përvojtur, imzot,
Eshtrore, e gurtë. Më mjafton pak dritë;
Ha tullat e librave, i brej si brejtësit,
Më mjafton pak ujë
Pak vaj për kandilin, pak bukë.
Më mjafton plasa e mekur e diellit në mur.
Thinjët e mia i trembin gjeneralët e tu.
Uji është drita e eshtrave të mia të thara.
Ç'më duhen teatrot, hipodromet,
Stadiumet e vulgut lumë djersë dhe gjak?
Imzot Hamurab, nuk e mbaj dot shpatën.
Lavirhanet e tregut e të valleve
Për gjakun tim të pakët
Nuk ngrenë dot rrjeta, as lak.**

* Hamurabi, mbret i Babilonisë.

BREV TILL HAMMURABI *
FRÅN GROTTANS MURARE ARAM

1.

**Herre Hammurabi, jag stackars gamle man undrar
Varför har du drivit mig ut ur min grotta,
Är det för min dumhets skull du gjort det ?
I ljuset från ljusstakar med guld från hela världen
Skriver jag idag den sista raden med kod.**

**Jag är min stackars grotta, min herre,
Benaktig, stenig. Jag klarar mig med bara litet ljus;
Jag äter böckernas tegel, gnager som en ekorre,
Jag klarar mig med lite vatten
Lite olja till oljelampan, lite bröd.
Jag klarar mig med denna smala springa med solljus på väggen.
Mitt gråa hår skrämmer dina generaler.
Vattnet är ljuset för mina torra ben.
Vad skulle jag behöva av teatrar, hippodromer,
Arenor för slödder, floder av svett och blod?
Herre Hammurabi, jag kan ej hålla svärdet.
Marknadernas horhus och danser
De kan inte snärja mig i sina fällor,
För sådant är mitt blod för tunt.**

* Hamurabi, Babyloniens kung.

2.

**Pse më torturon, zot im, me sjellje të kësaj bote?
Njerëzit këtu janë me nga një bodrum të zi
Me nga një hambar terri mbi shpinë dhe tru.
Kur bien nga shpellat në bodrumin e vetes
Për ta s'ka nënë, mik e të dashur,
Janë më të fortë se një gur,
Më të thatë se një dru.**

**Në atë bodrum ata shqyhen egër mes veti.
Ti po vë ligje për ta dhe kode, imzot,
Ata duan dhëmbët e qenit, shkopin e xhelatit,
Imzot Hamurab, ata s'i ndreq e nuk i ndreq dot.
Ti hartove ligjet, merri kodet e tua,
Për mua zoti im me ligjin e tij të pamort.**

**Imzot Hamurab, më i madh se qytetet dhe muret,
Te shpella ku kthehem, le të mbulohem me pluhur.
Në hipodromet, stadiumet, lavirhanet e tua
Nga bodrumet e zinj të njerëzve
U derdhtë më pak gjak dhe lot i purpurt.**

2.

Varför torterar du mig, herre, med denna världs
beteenden?

Människorna här har bara en svart källare
Bara en visthusbod av mörker på ryggen och i hjärnan.
När de faller ner från grottorna till sin egen källare
finns inte längre för dem varken moder, vän eller käresta,
de är starkare än en sten,
torrare än trä.

I den källaren sliter de vilt i varandra.
Du, min herre, ställer upp lagar och koder för dem,
De vill ha hundens tänder, bödelns käpp,
Herre Hammurabi, du ändrar dem inte, kan inte ändra på dem
Du sammanställde lagar, ta du dina koder,
För mig gäller min herre med sin odödliga lag.

Herre Hammurabi, större än städerna och murarna,
till grottan dit jag återvänder, låt mig få bli täckt av damm.
På hippodromerna, arenorna och i dina horhus
Från människornas mörka källare,
skulle jag önska att det utgöts mindre av blod och purpurtårar.

MAUZOLEU I VJETER

**Çati rënë, mauzoleu i vjetër
për dritën,
e tërheq si vetëtimën**

**Me fosforin e eshtrave të thata
që s'epen,
s'e lëshojnë themelin.**

**Dhe diell, shi... rrëkëllen
me etje muresh,
dhe erën thanë.**

**Pasi i ndritin muret,
shungullimat e bubullimave
në eshtra bien të flenë.**

**Pa gjethe vetëtimash ngrihen
në hapa të moteve,
epen e s'shuhen, lisa në zjarr.**

DET GAMLA MAUSOLÉET

**Med sammanstörtat tak, det gamla mausoléet
för ljuset,
drar till sig som blixten**

**Med torkade bens fosfor
som inte ger sig,
inte lämnar sin grund.**

**Och sol, regn ... sväljer det
med väggars törstighet,
och vinden dog.**

**Efter att de lyst upp väggarna
lägger sig åskknallarna
ner att sova på benknotorna.**

**Utan löv av blixtar står de upp
i tidens gång,
utstår men utplånas inte,
ekarna i brand.**

DY GISHT ERË

**Më ha mbrëmja, më gërryen
me kënaqësinë e ofshamave
që zhurmojnë shpellimin e tij**

**që bie në hon krahënderë.
Zemër, unë të puth ku mund
të të puthin dhe shumë të tjerë**

**po më lart, dy gisht më lart, në erë,
aty ku dëgjohet sopata tek krasit degë
që më fluturon prej vetes në qiej,**

**në vend që të binin në tokë.
Midis mbrëmjes dhe sopatës – veç
puthjen, puthjen tënde të ngrohtë.**

TVÅ FINGRAR VIND

**Kvällen äter mig, gnagar mig
stönande av njutning
grymtande äter den sig in**

**faller så ner i avgrunden med utslitna vingar
Min kära, jag kysser dig där jag kan
kyssa dig ska också många andra**

**men lite längre upp, två fingrar uppåt, i vinden,
där yxan ljuder då den hugger av grenen
som flyger från mig upp till himlen,**

**istället för att falla ner till jorden.
Mellan kvällen och yxan - endast
kyssen, din varma kyss.**

LODHJA

**Jemi bërë të vetmuar
Më të tepërt
Ne edhe halli ynë edhe nëna
Edhe gruaja edhe djali**

**Nuk ka miq
Nuk ka të dashur
Ne edhe para nesh halli ynë i verbër
Dhe secili vetëm. Të egër**

**Ajër nuk ka. Është një gjëmbë
I helmtë, në gjoks, në tru
Qielli i ngulur në gjemb
I tejshkuar në gjemb, i shterrur
Dhe secili vetëm. Të egër**

**Dhembje s'ka...
Ne dhe halli ynë dhe nëna
Edhe gruaja edhe djali. Tok
Secili me hijen e vet nën sqetull
Me kokën e vet të prerë, të përdorur
Kërkojmë Krishtin tonë të lodhur**

TRÖTTHETEN

**Vi har blivit ensamma
överflödiga
vi med vår vånda och mor
min fru och pojken**

**Det finns inga vänner
inga kära
Vi och framför oss vår blinda vånda
Var och en ensam. Helt vilda**

**Luft finns inte mer. Det är en giftig
Tagg, i bröstet, i hjärnan
Himlen spetsad på en tagg
Genomborrad på taggen, förtorkad
Och var och en ensam. Helt vilda**

**Ingen smärta finns ...
Vi och vår vånda och mor
min fru och pojken. Tillsammans
Var med sin skugga under armen
Med var sitt avhuggna huvud, förbrukat
Söker vi vår trötta Kristus**

ZOGU NË MBRËMJE

**Zog i vogël. Shi i hollë në mbrëmje
Plaga e vjetër hapur nën brinjë
Njollë në të kuqe manaferre**

**Këngën në gojë e mëtej e mëtej fluturon
Plaga e hapur nën krah nën pupla
Heshtur dhemb e pikon**

FÅGEL OM AFTONEN

**Lilla fågel. Duggregn i kvällningen
Det gamla såret ligger öppet under revbenen
En rödaktig fläck av björnbär**

**Med sången i munnen flyger och flyger den vidare
Ett öppet sår under vingen under fjädrarna
I tysthet smärta och läckande blod**

IBRAHIM BERISHA

FEMËR PËSHTYME

**Hija jote po ma zë
Frymën e fundit**

**Fokët nxjerr nga kryet e natës
Piqem në mollë, po thellë
Në errësirë ke lënë jargë**

Fryt i thinjur në rrënjë;

**Flokët e nxjerra të kafshimit
Ofshamë të ngrita, po ti larg**

**Trupi yt po ma zë
Frymën,
Në hije ke rënë e gjethi
Mbulon errësirën
Më të bukur të trungut**

**Ofshamë e vërtetë
Shtrat i mundimshëm njeriu
Mbushur femër pështyme
Pa ma zë frymën.**

IBRAHIM BERISHA

SPOTTKVINNA

Din skugga kväver

Mitt sista andetag

Du släpper ut ditt hår ur nattens huvud

Jag mognar i äpplet, men i

Mörkrets inre har du lämnat dregel

Frukt grånad i roten;

Det utslagna håret som du bitit i

Dina stön har frusit, du är borta

Din kropp kväver

Min andning

Du har hamnat i skugga och bladet

Täcker det vackraste

mörkret i trädstammen

Ett verkligt stön

En säng obekvämlig för människan

Fylld av kvinnlig spott

Det kväver mig.

LUSPË

**Nuk është shpatë e gjelbër,
As luspë e peshkut,
Vetëm gojë e thyer
Nëpër dhëmbë të lumit
Vetëm hije trupi
E shtirë në trup balte
Shpinë robi,
Vetëm e gjerë,
Duke rënë poshtë gjurit
Nëpër rrugica të lëngëta
Nuk është halë
Vetëm lëkurë e prerë leht
Por edhe qelb dhe majë e skuqur
E dorë e mbrëmjes së shkretë
Që nuk zgjatet kurrë
Vetëm luspë e gjelbër**

FJÄLL

**Det är inte ett grönt svärd,
Inte ens fiskfjäll
Bara en mun som trasats sönder
Av flodens tänder
Blott skuggan av en kropp
Liggande på en lerbädd
På slavens rygg,
Helt brett,
Fallande ner på knä
På fuktiga stigar
Det är inte ett ben
Bara en lätt uppskuren hud
Men också var och rodnande ryggfena
Och den stackars nattens hand
Som aldrig hinner sträcka ut sig
Bara ett grönt fjäll**

SHËNIM PËR DËSHPRIM

Është koha e fundit

Të bëni familje

Të bëni fëmijë

Dhe, në fund

Thellë në heshtje të thatë

Të mos shpresoni asgjë.

ANTECKNING OM FÖRTVIVLAN

Det är sista chansen

Att bilda familj

Att skaffa barn

Och allra sist

Djupt i den tomma tystnaden

Att inte hoppas på något.

FUND I NATYRSHËM

**Mbas dreke, nën dritare,
Në pyllin e lëkurës
Mirupafshim-thotë
Se, kjo mbrëmje e zbrazur flokësh
Duhet të jetë shumë pikëlluese
Mbi ballin e saj.**

Era e shtirë

Fund i natyrshëm.

NATURLIGT SLUT

**På eftermiddagen, under fönstret,
I hudens skog
Vi ses igen – säger hon
För denna kväll tömd på hår
Måste vara mycket sorglig
På hennes panna.**

Missfallsvind

Naturligt slut.

SHPËTIMI

1.

Bie njëmijë herë fluturë e prerë

**Nga t'ia mbaj
pa oksigjen, në prehërin natyror**

**Askush nuk duhet të dijë
pse veshur me mëndafsh të pjekur
parakalon nata
këtupari
retë po ashtu
lart natyrisht.**

Lutje edhe më

**Në orën tre sipas Grenuicit
Nuk ka më sirena të prishura
Prishje të qetësisë publike**

Duar të djerësitura

**Ujë të derdhur rrugicave copa
Mëlqi të ndrydhura dhe lëkurë prilli**

**As stacione të zhurmshme lodrash
Fëmijë të fshehur nëpër shi**

**Kolona mbushur valixhe
Rroba të pakta dhe**

Fotografi pa objekt

**Shkime të paimagjinueshme
Pritjeje**

FRÄLSNINGEN

1.

Tusen gånger faller fjäril avhuggen

**Hur skulle den klara sig
utan syre i naturens famn**

**Ingen får veta
varför natten paraderar
klädd i spunnet silke
här intill
molnen likaså
där uppe så klart.**

Ännu mer böner

**Klockan tre greenwichtid
Finns inga fler förstörda sirener
Störande av den allmänna ordningen**

Svettiga händer

**Vatten strömmade över gatstumpar
Pressad lever och aprilhud**

**Inte heller bullriga leksaksstationer
Barn gömda i regnet**

**Rader fyllda av resväskor
Lite kläder och**

Bilder utan objekt

**Otänkbara blickar
i väntan**

2.

Ende pa lindur dielli mbi drunjtë

Lutje edhe më pak

Shina

Trena as nuk ka më

Mendime pa lidhje

Vagona të mbushur ofshamë lamtumire.

2.

Före soluppgången över träden

Ännu mindre böner

Spår

Tåg finns inte längre

Tankar utan sammanhang

Vagnar fyllda av stönande farväl.

TË THUASH

Të thuash: fitorja është imja.

Festa është juaja.

Megjithatë edhe sot

Fitorja është imja.

Festa nuk është juaja.

Fitorja është vetëm fitore.

Megjithatë edhe sot

Fitorja nuk është juaja.

Festa është imja

DU SKA SÄGA

Du ska säga: segern är min.

Festen är er.

Likväl, även idag

Är segern min.

Festen är inte er.

Segern är enbart seger.

Likväl, även idag

Är segern inte er.

Festen är min

FAHREDIN GUNGA

TRI ELEGJI PËR KARAGAÇIN *

Shokut të vdekur, Halil Kasapolit

1. Shëtitje e parë

**Sikur t'ia kishin vjedhur Karagaçit sytë
hajnat e muzgut. Kemi dalë të shëtisim. Vonë.
Dukagjinit thuaj se vajzat ia kanë ngjyer ballin
me tamblin e buzëve. Jemi vetëm: na
dhe Karagaçi.* Heshtja. Dhe lista e plogët. Ecim
lehtë shumë lehtë, thuajse frikësohemi mos
po ia prishim ëndrrën barit, Bistricës* shtatzënë
dhe prillit ngjyrë gjaku që rritet si thirrjet tona
të eçtuara për këngë. E te na (thellë në ne)
lind diçka si vala, si mallëngjimi i pranverës
për këngën e këngtarit të vjemë, i cili vdiq
pa e parë kush së bashku me prilline pranverës
së vjeme, si thirrjet tona në barkun e reve lehonë,
dhe, te na, në rremat e përsëritjeve tona,
virret agu i dëshirës së vyshkur, i dëshirës
së palindur. Dëshirë?... Sonte nuk ka dëshira.
Vetë jemi dëshirë. Nuk flasim as me lulet e agujve
të kuqrremtë për të cilët mendojmë se do të lindin
në ne, rëndom, si çdo ditë që përvidhet
prej nesh, si çdo ditë që pagëzohet me agim -
dhe ashtu pa puthje si dashnorët naivë i lamë
të lindin në sytë tanë, edhe pse menduam
se po rritemi së bashku me rritjen e lisave.**

* Karagaçi, park në Pejë.

* Bistrica, lum në Pejë.

FAHREDIN GUNGA

TRE ELEGIER FÖR KARAGATJ *

Till min avlidne vän, Halil Kasapolli

1. Första promenaden

**Som om skymningens tjuvar hade stulit
ögonen från Karagatj. Vi har gått ut för att promenera.
Det är sent.**

**Säg till Dukagjin * att flickorna har färgat hans panna
med läpparnas mjölk. Vi är ensamma: vi
och Karagatj. Tystnaden. Och den tröga listan. Vi går
lätt, mycket lätt, nästan som vore vi rädda
att störa gräsets dröm, den havande Bistritsa *
och den blodfärgade april som växer likt våra törstiga
rop på sånger. Och hos oss (djupt i oss)
föds någon likt en våg, som vårens längtan
efter sången av förra årets sångare, som dog
utan att något har sett det, tillsammans med förra
vårens april, som våra rop i magen på barnsängsmolnen,
och, hos oss, i våra lögners upprepningar,
hänger den förtorkade gryningens önskan, en ofödd
önskan. Önskan? ... Ikväll finns det ingen önskan.
Vi själva är önskan. Vi talar inte ens med gryningens röda
blommor som vi tror kommer att slå ut
inom oss, vanligtvis, som varje dag som stjäls
ifrån oss, som varje dag som döps till gryning -
och så utan en enda kyss som de naiva älskarna lät
vi dem slå ut i våra ögon, trots att vi trodde
att vi växer tillsammans med de växande träden.**

* Karagaç, [uttal: Karagatj], en park i Peja, Kosova.

* Dukagjini, västra delen av Kosova.

* Bistrica, [uttal: Bistritsa], en flod i Peja

*

**I njohim hapat lazdranë. Unë i zgjas duart
kah blerimi duke menduar ta mbyllim në grushta
freskun hidhërak të mbrëmjes buzënuese, e ti-
i picërron sytë dhe përshpërit këngët e zogut
të përgjumshëm, që ka harruar të flejë. Kthehemi
prapë në vetvete. Te ne vargjet. Etje
për puthjet e Dukagjinit... Sikur t'ia kishin vjedhur
Karagaçit
sytë hajnat e mbrëmjes. Jemi shëtitësit e vonë. Vonë.
Dukagjinit thuajse vajzat ia kanë ngjyer ballin
me tamblin e buzëve. Ia dhamë edhe buzët tona.**

*

Vi känner igen den bortkämddassteg. Jag sträcker händerna mot grönskan och tänker att vi ska innesluta i våra nävar den bittra friskheten ur kvällens kyska läppar, men du - du blinkar och viskar sångerna från den sömniga fågeln som har glömt att slumra in. Låt oss komma tillbaka till oss själva. I oss verserna. Törst efter Dukagjins kyssar ... Som om kvällens tjuvar hade stulit ögonen från Karagatj. Vi är sena vandrare. Sena.

Flickorna har liksom färgat Dukagjins panna med sina läppars mjök. Vi skänkte honom även våra läppar.

2. Shëtitja ime e dytë. Vetëm

**Ku je, o vëllai im? Ku je? Karagaçi
nuk përgjigjet. A i ka dëgjuar lutjet e mia
të bleruara me barin e kujtimeve të mia?
A i ka dëgjuar, o vëllai im? Karagaçi heshti
e unë të thirra. Klitha. N'ajër u shndërrova.
Vetëm Bistrica belbëzon. Si gjithmonë belbëzon.
Preka ballin. I ftohtë si Bistrica. Si sytë e tu.
Kurrkush nuk më përgjigjet. Së paku, të më shajë.
Mendova se do të gjejë në mes të zogjve.
Por vetëm Bistrica belbëzon. Si gjithmonë belbëzon.
Zogjtë prej kokës sime kanë fluturuar dikah.
Ndoshta pas teje. Ndoshta pas lutjeve të mia.
U kam hipur kuajve të fëmijërisë sonë jetime
dhe jam bërë kalorës i shekullit njëzet -
e vargjeve gjakun deri në asht ua kam thithur. Si fëmijë
u mashtrova me Karagaçin ... sikur të mundja
për fyti t'ia ngjesë, e sytë prej ballit shkëmb t'ia këpusë, kishte
për t'm'i kthyer me siguri qeshjet që m'i vodhi
por ai rrin i ftohtë edhe më. Zemëruar. Si Bistrica.
E unë mundohem të mashtrohem me Dukagjinin.**

2. Min andra promenad. Ensam

**Var är du, min bror? Var är du? Karagatj
svarar inte. Har han hört mina
böner, gröna av mina minnens gräs?
Har han hört dem, min bror? Karagatj var tyst
och jag kallade på dig. Jag skrek. Jag förvandlades till luft.
Endast Bistritsa pladdrar. Pladdrar som vanligt.
Jag kände på pannan. Kall som Bistritsa. Som dina ögon.
Ingen svarar mig. Inte ens för att skälla på mig.
Jag trodde jag skulle hitta dig bland fåglarna.
Men det är bara Bistritsa som pladdrar. Pladdrar som alltid.
Från mitt huvud har fåglarna flugit någonstans.
Kanske efter dig. Kanske efter mina böner.
Jag rider på våra föräldralösa barndoms hästar
och jag blev till riddare av det tjugonde århundradet -
och ur mina verser har jag sugit ut blodet ända in till benet.
Som barn lät jag mig luras av Karagatj ... om jag kunde
gripa honom om strupen, och slita ut ögonen ur hans stenpanna,
skulle han säkert lämna tillbaka de skratt som han stal från mig
men han håller sig ännu mera kall. Arg. Som Bistritsa.
Och jag försöker lura mig med Dukagjin.**

3. Zjarri i shëtites së vonë

Mali u kall. Me të edhe unë. I thirra
zjarrfikësit e damareve të mi, por ata i ka zënë
gjumi i parë, sepse janë dehur sonte. Kanë pirë shumë.
Ç'të bëj? Pyeta Karagaçin. Karagaçi heshti.
E unë (thellë në mua) u kalla. Zjarrfikësit flejnë.
Duart i kam të vogla e hapat po i mas me centimetër.
Mendoj: kah të shkoj? Si të shuhem...?

Bistrica

po ikën si vajzë e turpshme. O, më kalli qetësia.
E heshtja. E uji i burimit. Kë të zgjoi nga gjumi
kujt t'i trokas në dyert e zemrës, kur jam në mal -
e zemrat janë të mbyllura ndërmjet mureve
të plogëta të qytetit me sy neoni, dhe asnjë kalimtar
nuk kalon këndeypari? Si duket
jam kalimtari i fundit i ditës që shkoi, (o, jam
bërë gjuetar ndjenjash, i dashuri im).
Ndoshta agimi flokëkuq i ditës lehonë u kall
në mua. O damarët më vjellin vetëm flakë,
E zjarrfikësit flejnë. Kush e din, vallë që endem
Kaq vonë nëpër pyll? Askush. Vetëm sytë e mi
dhe heshtja së cilës desha t'i hyj në gji
dhe burimi ku i lash kokërrzat e puthjeve të mia
me epshin e mbrëmjes që m'i këputi buzët.
Qielli rrecka – rrecka është vjerrë nëpër lisa
e hënës iu kanë shkyer velat nëpër rrema
Vonë ka lindur sonte. E është e madhe sa ndjenja.

3. Elden i en sen promenad

Skogen brändes. Med den brändes även jag. Jag kallade på brandmännen i mina ådror, men de hade redan fallit i sömn, de var berusade igår kväll. De drack för mycket.

Vad ska jag göra? Jag frågade Karogatj. Karogatj teg.

Och jag (djupt inne i mig) brändes. Brandmännen sover.

Jag har små händer och mina steg mäter jag i centimeter.

Jag tänker: Vart ska jag gå? Hur ska jag slockna?

Bistritsa ger sig av som en blyg flicka. Å, stillheten bränner mig.

Och tystnaden. Och källans vatten. Vem ska jag väcka ur sömnen hos vem kan jag knacka på hjärtats dörrar, när jag är i skogen -

och hjärtana är instängda mellan de tröga väggarna

i staden med neonögon och ingen förbipasserande

går på den här sidan? Det verkar som om

jag är gårdagens sista förbipasserande (å, jag

har blivit känslornas jägare, min älskade).

Kanske den gyllenblonda gryningen denna förlossningsdag

brändes i mig. Ack, mina ådror sprutar bara ut flammor,

och brandmännen sover. Vem vet, kanske strövar jag

Så sent i skogen? Det är ingen. Bara mina ögon

och tystnaden som jag ville tränga in i bröstet på

och källan där jag lämnade min säd av kyssar

med kvällens åtrå som skar i mina läppar.

Himlen söndertrasad hänger på träden

och månens segel har skurits sönder under rodden

Sent föddes det ikväll. Och det är stort som känslan.

ELEGJIA E KËNGËS

Lindi
ndërmjet agujve e zemrave
pa duartrokitje.

Lindi
për t'u bërë vetëm sa për t'u bërë
gur i bardhë në Bistricë.

Lindi
për të lindur përseri ndërmjet -
puthjes e dashurisë.

SÅNGENS ELEGI

**Den föddes
mellan gryningar och hjärtan
utan applåder.**

**Den föddes
för att bli till, bara för att bli till
vit sten i Bistritsa.**

**Den föddes
för att födas igen
mellan kyss och kärlek.**

ELEGJIA E DYTË E KËNGËS

**Po e mas vetveten
me peshën e agimeve, edhe pse – buzët
janë eçtuar për dashurinë e barit –**

**Në mua vërshon Bistrica,
vërshon e kurrë nuk del nga shtrati.**

**Çdo lindje peshon
sa një agim, nga një Dukagjin. Çdo këngë
është e rëndë sa një lindje.**

**Në muaj rrjedh Bistrica,
rrjedh e kurrë dhembja nuk i dihet.**

SÅNGENS ANDRA ELEGI

**Jag mäter mig själv
med vikten av gryningar, fastän - läpparna
är törstiga av kärlek till gräset -**

**I mig svämmar Bistritsa över
svämmar över och lämnar aldrig flodbädden.**

**Varje födelse har sin vikt
som en gryning, som ett Dukagjin. Varje sång
är tung som en födelse.**

**I månader rinner Bistritsa,
rinner och dess smärta förblir okänd.**

SABRI HAMITI

NUK FLE KUSHI THELLË NË PYLL

**ku ke tretur asht i fjetur
zana iku thellë në pyll
në fund lumi të kam gjetur
pika gjaku hymën mbyll**

Ku ke tretur asht i fjetur

**bota kotet nuk fle kushi
hapet rruga me sopatë
sillen motet syri pushi
mbyllet rruga natë me natë**

bota kotet nuk fle kushi

SABRI HAMITI

INGEN SOVER I SKOGENS DJUP

**var multnar du nu slumrande ben
i skogens djup gick älvans stig
vid flodens slut jag fann dig sen
från hymen rann en droppe blod**

Var multnar du nu slumrande ben

**världen dåsar ingen sover
vägen röjes med en yxa
ögonblick med åren tumlar
vägen avstängd natt på natt**

världen dåsar ingen sover

TRUNGU ILIR

Rri i verbuar nën Dhé në Mes-Dheun plak
Pi ujin e zi të rrjedhës në qivur
Kur shtrydh dorën e huaj a del gjak
Nga zemra e fundosur gurëzuar në gur
Detet e llahtarshëm a i bashkon urë
Apo fjalët e dashjes shprishen në jehonë
Rri strukur rri dru nuk flet rri gur
Në vitet e reja ndër shekujt e vonë
Rrënjët nën dhé rjepin lëkurën një këmbonë
Prish gjumin e rëndë në tokë e qiell
Degët lidhin kurorë si thikë si këmbonë
Se pijnë ujin tjetër i nxen tjetër diell
Nis këngën e vajin e klith mallshëm me fyell
O valë e tmerrshme o ujë trubull o det
E shpie zërin e tretur rrugës nëpër pyll
Në udhën e bashkimit nisu o vijë vetë
Ky shurdhim i moçëm veshët po m'i vretë
Nisur në dhenë e njohjes ndër fushat e male
Zgjimi symbyllë solli gjumin mbet shkret
I shtrirë në zhurmë e zhduk dalëngadalë
Në zjarrin e dashurisë së një fjale
U skuq e poq molla portokalli e fiku
Lëngun e jetës vala i dha një valë
Frika e heshtja nën dru mbet o iku
Kur ja nëpër terr qeshja e një miku
E rëndë sa kujtesa do shqiptim në lojë

DEN ILLYRISKA STAMMEN *

**Du ligger blind under jorden i gamla Balkan
Du dricker likvattnet som sipprar fram ur kistan
När du trycker en främmandes hand kommer det då blod
Ur det gravsatta hjärtat förvandlat till sten
Kan du överbrygga de vilda haven med en bro
Eller förvrängs viljans ord av ekon
Du ligger skymd, du är trä, du talar inte, du är sten
I nya år i de sista århundradena
Rispar rötterna under jord upp huden, en klockklang
Stör den tunga sömnen i jord och himmel
Grenarna bildar kransar som knivar som klockor
För de dricker annat vatten de värms av annan sol
Sången börjar med klagan och med flöjtens skri av längtan
Ack hemska våg ack grumliga vatten ack hav**

**Den tar med den förlorade rösten på vägen genom skogen
På vägen mot förening börjar din resa och jag kommer själv
Denna gamla dövhet stör mina öron
Med början i erkännandets land bland slätter och berg
Uppvaknande med slutna ögon ledde till sömn blev tomhet
Liggande i bruset och långsamt försvinner den
I elden i kärleken till ett ord
Blev röda och mognade äpplet apelsinen fikonet
Till livets saft gav vågen en våg
Rädslan och tystnaden under trädet blev kvar eller flydde
När just i mörkret hördes skrattet från en vän
Tungt som minnet krävs att det talas i detta spel**

*Illyrer räknas som albanernas förfäder.

**Në sofrën e drurit rrethuar lajmi piku
Fusha mori veshët e mali mori gojë
E rrjetohe biseda thua thue thoj
Vëllai i madh ta mban dhembjen në kokë
Pa shih o zot i qajmë qeshim flasim njësoj
Dhembjen klithjen vdekjen i mbjellim në tokë
Kur dielli shkrumohet në det e në bokë
E i skuq gjurmët në udhëtimin pluhurak
Erren mendimet plas klithja në kokë
Gjaku yt të ndjek në botë e në prak
Rri i verbuar në Dhé në Mes-Dheun plak
Pi ujin e zi të rrjedhës në qivur
Kur shtrydh dorë e huaj e del gjak
Nga zemra e fundosur gurëzuar në gur**

**När de satt runt matbordet av trä kom nyheten
Fältet fick öron och berget fick mun
Samtalet nystar in sig imse vimse
Storebror håller smärtan i huvudet
Se, herre Gud, se hur likadant vi gråter skrattar talar
Smärtan skriker döden sår vi i jorden
När solen förkolnar över hav och land
Och gör rödaktiga spår under sin dammiga resa
Mörknar tankarna och skriker spränger fram i huvudet
Ditt blod följer dig i världen och på din tröskel
Du ligger blind i jorden i det gamla Balkan
Du dricker det svarta vattnet som rinner från kistan
När en främmande hand klämmer till då rinner det blod
Ur det gravsatta hjärtat förvandlat till sten**

PRIZRENI

Qyteti është krenar se është kryesori.

**Kur shkon me veturë bën një orë.
Kur shkon në këmbë njëqind vjet:
Nisi numron bimët, krojet, këngët,
Gurët e varreve dhe vitet.
Mbërrin i mplakur për tërë breza
Me peshën e shekullit në shpinë.**

**I lodhur nga sëmundja e vetmisë
Gjen një shtëpi të moçme qyteti,
Që roje i bëjnë dy njerëz qindravjeçarë:
Njëri me kravatë e dokument,
Tjetri me plis e me kobure.**

**Mat moshën tënde e vetminë
Me plasat e tokës, kulmet e shprishura,
Oxhaqet pa tym...
E mëson drejtshkrimin, drejtpeshimin.**

**Kalaja rri lart e heshtur
Me dhëmbin e gjatë sa koha.
Kush e ka vetminë më të moçme:
Kalaja, Bistrica, Ti?
Apo Prizreni, që është më i madhi?**

*** Bistrica, lum në Prizren.**

PRIZREN

Staden är stolt över att vara den viktigaste.

**När du kör dit med bil tar det en timme.
När du går till fots tar det ett hundra år:
Du börjar räkna växter, källor, sånger,
Gravstenar och år.
Du kommer fram åldrad för många generationer
Med århundradets tyngd på ryggen.**

**Trött av ensamhetens sjukdom
Hittar du ett gammalt hus i staden,
där två flerhundraåriga människor håller vakt
en av dem bär slips och dokument,
den andre har plis* och ett gammalt vapen.**

**Mät din ålder och ensamhet
Med sprickorna i marken, de trasiga taken,
Skorstenar utan rök...
Du lär dig rättskrivning, rätt balans.**

**Slottet står tyst där uppe
Så långt som tidens tand.
Vem har den äldsta ensamheten:
Slottet, Bistritsa, Du?
Eller Prizren, som är den största?**

* Prizren, en stad i sydvästra Kosova,

* Bistrica [uttal Bistritsa] floden i Prizren.

* Plis, traditionell albansk rundkullig vit mössa

GATITU

Çdo gjë është e qetë në gjendje gatitu

Pleqt lindin qetë në gjendje gatitu

Fëmijët vdesin qetë në gjendje gatitu

Të rinjtë duan qetë në gjendje gatitu

Lisat rrinë të qetë në gjendje gatitu

Nata bie qetë në gjendje gatitu

Mëngjesi kullohet qetë në gjendje gatitu

Çdo gjë është e qetë në gjendje gatitu

Ga-ti-tu!

GIVAKT

Allting är lugnt i läget givakt

Åldringarna föds lugnt i läget givakt

Barnen dör lugnt i läget givakt

Ungdomarna älskar lugnt i läget givakt

Träden står lugnt i läget givakt

Natten faller lugnt på i läget givakt

Morgonen rinner lugnt fram i läget givakt

Allting är lugnt i läget givakt

Giiiv-akt!

SHQIPËRIA

**Shqipëria ka Jug e Veri,
rri ngrehur në hartë,
e hajthme si qiriri.**

**Kur merr frymë lirisht
me sharrë e me thikë
në trup i pret kufiri.**

**Shqipëria shkrihet në det,
ngrihet maje malesh,
bardh e kaltër përjetë:**

**E mbajnë hundë malesh
lumenjtë me lot
valë të tmerrit në det.**

**Shqipëria do të ketë
Lindje e Perëndim,
me qendër që shndërit,**

**Shigjeta diellore
bëjnë rrethin e jetës,
të gjallit i pëshpërit.**

**Shqipëria ka rrugë të ngushta,
këmbë të zbathura,
është vend e varre,
dheun e zi përfundi
qiellin kaltër përmbi,
në gji hi e zjarr.
Shqipëria vishet bardh e zi.**

ALBANIEN

**Albanien har syd och nord,
står i relief på kartan,
tunt som ett vaxljus.**

**När det andas fritt
börjar dess gränser att tas bort
Från dess kropp med såg och kniv.**

**Albanien smälter i havet,
stiger upp på bergstopparna,
blått och vitt för alltid:**

**Med sin näsa uppe bland bergen
med floder av tårar
med skräckens vågor i havet**

**Men Albanien kommer också att ha
både öst och väst
med ett centrum som lyser,**

**Solens pilar
ger livets cirkel,
viskar till det levande.**

**Albanien har smala gator,
bara fötter,
är land och gravar,
den svarta jorden under
den blå himlen ovanför,
i bröstet aska och brand.
Albanien klär sig i vitt och svart.**

**Jashtë e në shtëpi
e nxjerr inatin:**

**Nxjerr gjuhën shpatë,
dhembjen e lashtë,
kur masha ia mat shtatin.**

**Shqipëria ka Jug e Veri
Lindje e Perëndim
në mes e në skaj shqipen.**

**Shqipëria ka njerëzit,
që e duan kur vuan,
shqiptarët.**

**Där ute och hemma
sticker det ut sin ilska:**

**Sticker ut tungan som ett svärd
den urgamla smärtan,
när eldgaffeln mäter hans längd.**

**Albanien har söder och nord
öst och väst
i mitten och på kanten örnen.**

**Albanien har folket,
de som älskar det när det lider,
albanerna.**

NATASHA LAKO

NJË CEP I PADUKSHËM

**Në hapësirën bosh,
mes zgavrës së shkallëve,
çan nga larg një bri i hajthshëm hëne.**

**Zbres në katin e poshtëm,
por jo për të ngulur këmbët te dhéu.**

Eci pastaj kalëqafë me rrugën,

Hedhur si një lëkurë të therur.

**Ngre kokën të gjej
cepin tjetër të hënës së vockël,**

Të fshehur nga retë.

**Kam mbetur larg një trupi hëne të ngrënë përgjysmë,
po më sjell vërdallë
ai cep i lakueshëm.**

NATASHA LAKO

ETT OSYNLIGT HÖRN

**I tomrummet,
i hålet under trappan**

Skär det in fjärran ifrån ett smalt horn av månen.

**Jag går ner till undervåningen,
men inte för att sätta mina ben på marken.**

Sedan rör jag mig barbacka längs vägen,

Utslängd som en torkad hästhud.

**Jag lyfter huvudet för att hitta
det andra hörnet på den lilla månen,**

Dolt av molnen.

**Jag har kommit långt från en månens kropp halväten
men det får mig att irra omkring
det där böjliga hörnet.**

NJË LIQEN DHE NJË FUSHË

**Përballë njëri-tjetrit qëndrojnë
të lodhur, të kapitur, kokulur,
një liqen që gufon valët në shpinë,
dhe një fushë që gufon në shpinë lulëkuqet.**

**E kanë të pamundur edhe urrejten, edhe zemërimin,
nuk mund të puqen më as për luftë, as dashuri.
Të shtirë përallë, në një përgjim të përjetshëm,
një liqen dhe një fushë.**

**Vetëm një vijë e thërmuar rëre i bashkon dhe i ndanë,
si dy koka të bëra copë çikë.**

EN SJÖ OCH ETT FÄLT

**De står mitt emot varandra
trötta, utmattade, ödmjuka,
en sjö som stänker vågor upp på ryggen,
och ett fält som stänker upp vallmoblom på sin rygg.**

**För dem är både hatet och vreden en omöjlighet,
och de kan inte mötas längre ens för krig eller kärlek.
Liggande mitt emot varann, i ett evigt betraktande
en sjö och ett fält.**

**Endast en smal linje av sand förenar och delar dem,
som två huvuden som huggits i bitar.**

MBRËMJE DHE MËNGJES

**Mbrëmja është një derë e madhe
nga kaloj drejt natës
të zezë që vjen si korridor i pafund
ku eci për të takuar ditën
e bardhë, si dhomë e pastër
që ka dritare qiellin
të tejdukshëm, si xham
që thyhet kur eci.
Çudi, ka mbetur pa çati
dhe mbrëmja, dhe mëngjesi.**

KVÄLL OCH MORGON

**Kvällen är en stor dörr
som jag går genom mot den svarta natten
den kommer likt en oändlig korridor
där jag går för att möta den vita
dagen, likt ett rent rum
som har himlen som fönster
genomskinlig som glas
vilket krossas när jag går.
Märkligt, både kvällen och morgonen
har blivit utan tak.**

TRUNGJET E ULLINJVE

**Të vjetër dhe të zinj,
trungjet e ullinjve shuhën nëpër natë,
të heshtur dhe të nxirë...**

**Edhe në natën më të thellë,
trungjet po mbledhin errësirën,
dhe gjethnaja palodhur shpërndanë dritë në terr.**

**Po pema e vjetër,
e njollosur me paqen,
nuk çahet dot më dysh.**

OLIVTRÄDEN

**Gamla och svarta,
olivträd stammar försvinner i natten,
tysta och svartnande...**

**Även i den djupaste natten,
samlar olivträden mörkret,
och deras lövverk sprider outtröttligt ljus i mörkret.**

**Men det gamla trädet,
fläckat med freden,
kan inte delas i två.**

NËN SHËN NAUM *

**Pasqyrë e thyer e Drinit të Zi,
Mbytur në të gjyshi,
Babai,
Zhytur unë gjer në grykë,
Në sy.**

**Dhëntë Zotit të na nxjerrin
Fëmijët e mi.**

* Shën Naumi, në vitet e 30-ta iu mor
Shqipërisë dhe iu dha Maqedonisë së sotme.

UNDER S:T NAUM *

**Svarta Drins sönderslagna spegel,
där dränktes min farfar,
Och min far,
Där sjönk jag ner till halsen
Ner till ögonen.**

**Gud give att mina barn
tar oss därifrån.**

*** S:t Naum, en plats som på 1930-talet togs från
Albanien och gavs till det som nu heter Makedonien.**

LULJETA LLESHANAKU

NË MES JE I SHPËTUAR

Në mes je i shpëtuar – thoshin latinët
Mbulesa e qëndisur në mesin e tryezës,
Tryeza në mesin e qilimit.
Qilimi në mesin e dhomës.
Dhoma në mesin e shtëpisë.
Shtëpia në mesin e bllokut,
Blloku në mesin e qyetetit.
Qyteti në mesin e hartës.
Harta në mesin e dërrasës së zezë.
Dhe dërrasa e zezë.
Në mesin e hiçit.

2.

Lola është një engjëll. Balli i saj nuk është rritur që kur ishte
tetë vjeçe
për të ruajtur të njëjtën qendër graviteti. Dhe ajo pëlqen
skajet, qoshet
pavarësisht se veten e gjen gjithmonë në mes të një autobusi
kur njerëzit turren drejt hyrjes dhe daljes.

Fqinjët e mi janë njerëz të pashkollë,
nuk kanë dëgjuar asgjë për estetikën,
dhe zor se kanë lexuar gjë mbi boshtin, simetrinë dhe të vërtetën
absolute.

Por, ata lëshohen instinktivisht drejt mesit
ashtu si koka e burrit që lëshohet krejtësisht në prehrin e gruas,
që me një palë gërshëre, pabesisht, deri nesër
do të bëjë atë më të prekshëm se kurrë.

LULJETA LLESHANAKU

I MITTEN ÄR DU RÄDDAD

I mitten är du räddad – sa latinarna

Broderat täcke i mitten av bordet,

Bordet mitt på mattan

Mattan mitt i rummet.

Rummet mitt i huset.

Huset i mitten av kvarteret,

Staden i mitten av kartan.

Kartan i mitten av den svarta tavlan.

Och den svarta tavlan

Och tavlan.

I mitten av ingenting.

2.

Lola är en ängel. Hennes panna har inte vuxit sedan hon

var åtta år

för att hålla samma tyngdpunkt. Och hon tycker om

kanter, hörn

oberoende av det att hon alltid befinner sig mitt i en buss

då folk rusar mot ingången och utgången.

Mina grannar är obildade människor,

har inte hört någonting om estetik,

och knappt har läst något om axeln, symmetrin och den absoluta

sanningen.

Men de släpper sig iväg instinktivt mot mitten

likt mannens huvud som släpper sig ner i kvinnans knä,

kvinnan som med en sax, svekfullt, tills imorgon

kommer att göra honom mer sårbar än någonsin.

MISTERI I LUTJEVE *

**... Në shtëpinë time
lutja ishte dobësi
që nuk përflitej kurrë
si të bërit dashuri.**

**Dhe njësoj
si të bërit dashuri
pasohej nga nata e frikshme e turpit.**

*** Në kohën e komunizmit, në Shqipëri ishte e ndaluar feja.**

BÖNERNAS MYSTERIUM*

**... I mitt hem
var bön ett tecken på svaghet
som vi aldrig talade om,
det gällde också om samlag.**

**Och likadant
som samlaget
följdes den av en skrämmande natt av skam.**

*** Under kommunisttiden var religionen förbjuden i Albanien.**

ANTON PAPLEKA

ZHELE QIEJSH

**Me penjtë e kaltër të shiut
Prilli mundohet të qepë qiejt e shqyer
Nga predhat
A të përcëlluar
Nga flakët e automatikëve**

**Aty-këtu
Prilli ngjit copëza resh
Siç ngjit kirurgu copëza lëkure
Në fytyrën e lemerishme
Të një njeriu të djegur**

**Prilli do të ikë
Do të sosen penjtë e kaltër të shiut
Arrnat e bardha të reve
Ne do të mbajmë mbi supe
Zhele qiejsh...**

ANTON PAPLEKA

TRASOR AV SKYAR

**Med de blå regntrådarna
försöker april laga de trasiga skyarna
efter granater
eller svedda av
elden från automatvapen**

**Här och där
syr april fast bitar av moln
Som kirurgen gör med hudstycken
i det vanställda ansiktet
på en brandskadad människa**

**April kommer att gå sin väg
De blå trådarna av regn kommer att ta slut
molnens vita laglappar
kommer att finnas kvar på våra axlar
trasor av skyar...**

LUMI I THARË

**Shtegtarët e lodhur mbërritën
Buzë lumit**

Kishin udhëtuar gjatë

**Lumi ku do të pinin
Prej kohës qe tharë
Dhe kishte fluturuar në qiell
Bashkë me shpirtrat e fëmijëve
Të panjollosur nga mëkati**

**Të çartur nga etja
Shtegtarët zunë të gjuheshin me gurë
E me rrashta
Të grumbulluara te shtrati i lumit**

**Secili shihte te qafa e tjetrit
Një krua të kuq...**

DEN UTTORKADE FLODEN

**Trötta vandrare anlände
till flodstranden**

De hade en lång resa hit

**Floden där de skulle dricka
hade för länge sedan torkat ut
Och hade flugit till himlen
Tillsammans med barnens själar
Obefläckade av synd**

Galna av törst

**Började vandrarna kasta på varandra stenar
och ben
som de hittade på flodstranden**

**Var och en såg på den andres hals
En röd källa...**

PRIMO SHLLAKU

PROFESION

**Jam msue me të vra
me sendet ma të buta,
me heshtje, me një “mirë, s’ka gja”,
me mendje të lehtë,
ty që e vdekun dukesh
n’balkon të pozës tande.
E kam vra me mija herë dëshirën tande
me sende ma të buta:
me ikje, me ndrojtje, me mosvendim,
bile me gazin tim të kotë,
ty që dora ime kurr s’arrika me të ngjallë
nga hija e baltës tande.
Do ta vras prap,
prap e përsëri prap
mendimin tim për ty
me çka të më vijë përdore
dhe mendimin yt,
në vdekjen e vet
kah pak, kah pak
do të marrë me vete
pjesë prej meje,
të vrame edhe ato
me sende të buta,
me ç’të vijë përdore
me kohë, pritje,
indiferencë...**

PRIMO SHLLAKU

YRKE

Jag har lärt mig att döda dig
med de mjukaste tingen,
med tystnad, med "bra, det gör inget"
med ett lättsinne,
du som verkar död
på balkongen av din pose.
Jag har dödat tusentals gånger din önskan
med de mjukaste tingen:
med att fly, med blyghet, med obestämdhet,
även med mitt fåniga skratt,
dig som min hand aldrig kan väcka till liv
från skuggan av din lera.
Jag kommer att döda igen,
igen och återigen
min tanke på dig
med allt som jag har till hands
och din tanke,
i sin egen död
lite i taget
kommer att ta med sig
delar av mig,
även de dödade
av mjuka ting,
med allt som du kan ha till hands
tid, väntan,
likgiltighet ...

GJENDJE

**Në shtratin tand
me mija herë para njoftjes
trupit im u pre kortarë – kortarë.**

**Në pellgun e detyrës
mbytej e kaluemja jote,
e shkurtë dhe e brishtë
si rinia e andrra,
ndërsa mbas piramidës
perëndonte
drita ndër ethe e virgjinisë.**

**Mbas shiut që binte vazhdimisht
mes klimës tande
e klimës sime
rrija me trup e zemër tjetërkund
dhe sytë këtej,
kurse karvani i mjegullave të ngrohta të natës,
hipun në devet e reve të shpëlame të ditës,
lente mbrapa shkretinën e bardhë
të shtrati të prishun.**

LÄGE

**I din säng
tusentals gånger innan vi träffade varann
skars min kropp i bitar.**

**I põlen av arbetsuppgifter
drunknade ditt förflutna,
kort och bräckligt
som en ungdomsdröm,
medan bakom pyramiden
slocknade
ljuset i oskuldens hetta.**

**Efter regnet som föll oavbrutet
mellan ditt klimat
och mitt klimat
stod jag med kropp och hjärta någon annanstans
med blicken hitåt,
medan karavanen av nattens varma dimmor,
sittande på kameler av dagens uttvättade moln,
lämnade bakom sig den vita öknen
i den trasiga sängen.**

ANDËRR E LAGUN

Niset anija

e limani mbeti si nofull me një dhamb të hequn.

Shuhet ngadalë vazhda prej fluskash

e moria e peshqve e ripopullon rrugën e saj.

Këtë herë anija s'mori asgja pej meje,

bile as shikimin.

Unë jam në kambë mbi tokën e fortë

si direku i një anije të ngurosun.

DEN BLÖTA DRÖMMEN

**Fartyget avgår
och hamnen blev som en käke med en borttagen tand.
sakta försvinner spår av bubblor
och mängden av fiskar återbefolkar sin egen väg.**

**Den här gången fick inte fartyget något av mig
inte ens ett ögonkast.**

**Jag står än på mina ben på den stadiga marken
som masttoppen på ett förstenat fartyg.**

SENDI SI NGJARJE

**Hapa dritaren e dhomës
e pashë një vile të vogël rrushi,
rozë të tejdukshme si qepallë engjëlli.**

**E kam të vështirë ta marr me mend
se ajo asht vena, rakia, bërsia,
dehja, dhimbja e kokës,
të vjellat, mjesi i shkretuem
e betimi
se nuk do të pi ma.**

SAKEN SOM HÄNDELSE

**Jag öppnade rummets fönster
och såg en liten klase av druvor,
knopp genomskinlig som ängelns ögonlock.**

**Det är svårt för mig att inse
att det är vinet, spriten, matresterna,
berusningen, huvudvärken,
kräkningarna, äcklig omgivning
och min ed
att inte dricka igen.**

FASLLI HALITI

DIELLI DHE RRËKERAT

Çatia e shtëpisë sime është qaramane,

Shtëpia ime është sentimentale,

Dy re në qiell

Ajo vu lotët,

Dy re në qiell

Ajo vu me të madhe.

Nga sytë e tavanit tim

(Tavani ka dhjetëra sy)

Lotë gjerbësh rrjedhin vu, vu

vu, vu

Natë e ditë

Rrjedhin me të madhe...

FASLLI HALITI

SOLEN OCH SKURARNA

Mitt fosterlands tak lyser optimistiskt blått

Men taket på mitt hus darrar av gråt

Mitt hus är sentimentalt

Tårarna droppar

Två moln på himlen

Och tårarna rinner i strömmar.

Från ögonen i innertaket

(de är dussintals)

Rinner tårefloder

Natt och dag

Dropp-dropp-dropp-dropp

Och snyftningarna fyller huset...

O

Beni,

Blerta,

Zamir!

Këto faqe librash

Kur t'i lexoni

Pas viteve shtatëdhjetë

Mos i merrni për lotët e mamasë

Mos i merrni për lotët e babait këto gjerbë.

As mamaja,

As babai

Nuk ishin sentimentalë,

Sentimentale qe shtëpia jonë

Sentimentale ishte tavani i saj...

O

Beni!

Blerta!

Zamir!

En dag

då sjuttioalet gått till ända

Och ni läser dessa sidor

Tro då inte att de där fläckarna

Är mammas eller pappas tårar

Nej, varken mamma

eller pappa

var sentimentala

Det var vårt hus som var sentimentalt

Och alldeles särskilt dess tak...

O

Çatia ime sentimentale,

Dy re në qiell

Ajo vu lotët,

Dy re në qiell

Ajo vu me të madhe.

Nga sytë e tavanit tim

Rrjedhin lotë gjerbësh vu, vu

Vu,

Vu,

Natë e ditë,

Rrjedhin me të madhe...

*

O

Mitt tak är sentimentalt

Två moln på himlen

Tårarna faller

Två moln på himlen

Tårarna strömmar ner

Från ögonen i taket

Rinner tårefloder

Natt och dag

Dropp-dropp,

dropp-dropp,

Och snyftningarna fyller huset...

*

**Janë dadot tona,
Janë gjyshet tona
Këto pikë,
Këto gjerbë
Që na vënë në gjumë,
Me zërin e tyre të verdhë
Dhe për çudi,
Këto gjerbë,
Këto pikë
Vënë në gjumë edhe shokun Lili
Shefin e strehimit në komitetin ekzekutiv...**

*

**De är våra barnsköterskor
och mormödrar**

**Dessa droppar,
detta regn**

Som vagnar oss till sömns

Med tårdränkta röster

Och märkligt nog

dessa regn

vagnar till sömns

även kamrat Lili

Chefen för bostadsförmedlingen vid Exekutivkommittén...

*

**Zgjoj gruan,
Fëmijët i zgjoj
Dhe mes gjerbëve të verdha, familjarisht
i drejtohem Enverit,
i drejtohem Partisë:
Mos rrini fare të menduar!
Ne për ju flemë edhe në ujë,
Ne për ju flemë dhe në dyshekë akujsh,
Ne për ju flemë
Edhe në çarçafe dëborërash mbuluar!...**

*

**Jag väcker hustrun,
Likaså barnen
Och mitt bland fukten, i famljekretsen
Vänder jag mig till Enver
Riktat jag mig till Partiet:
Sitt inte alltför länge och fundera!
För er sover vi till och med i vatten
För er sover vi till och med på en bädd av is
För er sover vi
till och med under ett täcke av snö!...**

Shoku Lili, shoku Koli

Ju erdhën Qazimi, Meti, Llazari,

Në zyrë,

Në Komitet

Dhe mos mendoni se ishin të ndrojtur,

Mos mendoni se ishin leshko,

Mos kujtoni se s'e dinin që kishin të drejtë!

Jo!

Ata e dinin se kishin të drejtë,

Por i mbanin hatrin Partisë,

Që strehimin s'e ka të lehtë...

*

Kamrat Lili, kamrat Koli

Till er kom en dag för att klaga

Qazim, Met och Llazar

De kom till ert kontor, till kommittén

Och tro inte att de var modstulna

Tro inte att de var okunniga

Kom inte och påstå att de inte visste att de hade rätt!

Nej!

De visste mycket väl att de hade rätt

Men de tog hänsyn till Partiet

Som har stora bekymmer med bostadsfrågan...

*

**Për një banesë,
Për një hall,
Ne trokisnim tek ju,
Trokisnim në portat e buzëve tuaja,
Me gishtin e halleve tona trokisnim,
Shoku Koli,
Shoku Lili;
Portat e buzëve tuaja s'hapeshin
Dhëmbët tuaja kyçeshin
Me nervozizëm kërcisnin.
Vinte miqësia,
Hynte pa trokitur,
Vinte shoqëria, hynte pa trokitur,
Portat e buzëve hapeshin vetë,
Muret e dhëmbëve shkëlqenin,
Qindra kërkesat tona thyenin kokën,
Dhe, nuk futeshin dot...**

*

**För ett lägenhet
För våra bekymmers skull
Knackade vi på hos er
Vi knackade på era munnars portar
Med våra bekymmersnävar knackade vi på
Kamrat Koli,
Kamrat Lili;
Munnars portar förblir stängda
Tänderna var sammanbitna
De gnisslade av irritation
Men där kom vänskapen,
Och steg på utan att knacka
Där kom bekantskapen och klev in utan vidare
Munnarnas portar öppnades automatiskt,
Tändernas väggar glänste,
Våra hundra förfrågningar bröt nacken,
Och de kom aldrig in...**

*

Shtëpia ime sentimentale

Vazhdon të qajë,

Të pikojë.

Të gjerbojë.

Por

Në secilën pikë të shtëpisë sime

Në secilën gjerbë,

Ne po hapim nga një themel

Nga një pallat të ri vigan do të ngremë.

Në truallin e shtëpisë sime sentimentale,

Ne do të ngremë një lagje të re vigane.

Shkretëtira e kontradiktës së shtrehimit

Do të bëhet një qytet i ri banimi...

*

**Mitt sentimentala hus
Fortsätter med sin gråt
Med sina regndroppar
Med sin fukt
Men
I varje regndroppe i mitt hus
I varje fuktfläck
Reser vi en grund
Bygger vi ett väldigt hus
På tomten till mitt sentimentala hus
Bygger vi ett stort kvarter

Bostadsproblemets öken
Förvandlas till en stad med nya bostadshus...**

*

Urdhër!

Me grushtin e klasës punëtore

Thyejani dhëmbët e burokracisë!

Thyejani dhëmbët shokut Koli,

Shokut Lili!

Po ua thyejmë,

Por

Na duhen gurë.

Makinat në gurore u vonuan.

Po i murosim dhëmbët tuaj.

Ne s'mund të rrimë pa punë

Ne s'mund të lemë me duar nën gjerbë

Enverin,

Partinë,

Ne i kemi piketa duart e tyre.

Piketa ku duhet të hapim themele

Piketa ku duhet të ngremë çatira.

Partia,

Enveri

Zgjuar rrinë?!

Dhe venë dorën aty ku pikon?!

Dhe s'ka gjerbë që s'e dinë?!

Si, s'ka gjerbë që ai s'e dinë?!

Order!

Krossa med arbetarklassens nävar

Tänderna på byråkratin!

Slå in tänderna på kamrat Koli och kamrat Lili

Men

För att slå in dem

Måste vi ha sten

Vagnarna från stenbrottet är försenade

Och tändernas murar står fasta

Vi kan inte stå här sysslolösa

Vi kan inte lämna Enver och Partiet

Med fingrarna i läckan

Deras händer sitter fast i droppet

Det droppar där grunden ska läggas

Det droppar där taket ska resas

Partiet,

Enver

Sitter vakande?!

Och håller fingrarna där det läcker?!

Det finns inte en läcka som inte de vet om

Nej, hur kunde det finnas en läcka,

Som inte de vet om?!

Som inte han vet om?!

NJERIU ME KOBURE *

**Ai pret të fryjë era
Jo që të zhvishen pemët,
Jo që të shkunden gjethet e verdha,
Por që t'i ngrihet cepi i xhaketës,
T'i duket pas brezit koburja.**

**Ai pret të vijë pranvera,
Jo që të mbjellë e të korrë,
Por që të zhveshë xhaketën,
T'i duket pas brezit
Koburja.**

** Ky njeri ishte kryeministr i Shqipërisë, Mehmet Shehu.*

MANNEN MED REVOLVERN *

**Han väntar på att det ska börja blåsa
Inte för att löven ska falla av träden,
Inte för att de gula löven ska virvla kring,
Utan för att hörnet på hans kavaj ska lyftas,
Så att man ser hans revolver vid bältet.**

**Han väntar på att våren ska komma,
Inte för att så och skörda,
Men för att kunna ta av sig kavajen,
Så att man kan se vid bältet
Hans revolver.**

**Dikten syftar på den brutale premiärministern i Albanien,
”slaktaren” Mehmet Shehu.*

POEZIA BASHKËKOHORE SHQIPE - NË SUEDISHT

A N T O L O G J I

NUTIDA ALBANSK POESI - PÅ SVENSKA

A N T O L O G I

Përkthimi / Översättning

Ulmar Kvik (Ullmar Qvick)

Hajdin Abazi

Shqiptar Oseku

Poezitë i përzgjedhi dhe korrektoi redaktori, Shefki Oseku

Poesin valdes och korrekturläst redaktören, Shefki Oseku

Korrektorë të poezisë suedeze

Korrekturläsning på svenska

Marjanne Bengtsson

Monika Fingal

Kompjuterizimi / Dataansvarig

Frashër Oseku

Botim i dytë, i përmirësuar, qershor 2013

Andra, förbättrade upplaga, juni 2013

Tirazhi / Upplaga 1.000 copë

BOTIM I REVISTËS "DRITA" NË TRELEBORG - SUEDI

UTGIVEN AV TIDSKRIFT DRITA I TRELLEBORG – SVERIGE

**LISTA E LIBRAVE TË BOTUARA NGA REVISTA "DRITA", NË
TRELEBORG, SUEDI.**

**LISTA MED UTGIVNA BÖCKER AV TIDSKRIFTEN DRITA,
TRELLEBORG, SVERIGE.**

1. "Një lloj drite tjetër", poezi, shkruar nga Shefki Oseku, botuar në gjuhën shqipe më 1997 dhe ribotuar disa herë me përmirësime të vogla. Libri është përkthyer në suedisht, gjermanisht, polonisht dhe anglisht.

"Ett annat slags ljus" poesibok, skriven av Shefki Oseku, utgiven på albanska året 1997. Senare har utkommit nya upplagor, med små ändringar. Boken översattes till svenska, tyska, polska och engelska språket.

2. "Hetimet" roman në gjuhën shqipe, autor Shefki Oseku, botuar në vitin 2000. Më vonë u ribotua disa herë me përmirësime të vogla.

"Förhör", roman på albanska, skriven av Shefki Oseku, utgiven år 2000. Senare har boken utkommit i nya upplagor, med små ändringar.

3. "Kryquesi i shpirtit", poezi, shkruar nga Shqiptar Oseku, botuar në vitin 2000. Më vonë libri është ribotuar me përmirësime të vogla.

"Själens korsfästelse", poesibok, skriven av Shqiptar Oseku, utgiven år 2000. Senare har det utkommit nya upplagor, med små ändringar.

4. "Poezia shqipe suedisht dhe poezia suedeze shqip", botuar më 2001, përkthyer në të dy gjuhët nga Shqiptar Oseku. Libri u botua disa herë me përmirësime të vogla.

"Svensk poesi på albanska och albansk poesi på svenska", utgiven år 2001, översattes på båda språket av Shqiptar Oseku. Senare har det utkommit nya upplagor, med små ändringar.

5. "Ngjyrat e jetës", poezi, shkruar nga Esat Cërmjani, botuar më 2001.

"Livets färger", poesibok av Esat Cërmjani, utgiven år 2001.

6. "Arti shtetëror i letërsive të verbra" ese për letërsinë shqipe, shkruar nga Hazyr Dervishi, botuar më 2001.

"Statlig konst i den blinda skönlitteraturen", skriven av Hazyr Dervishi, en kritisk granskning av den albanska litteraturen. Boken är utgiven år 2001.

7. "Kodi", roman, shkruar nga Hazyr Dervishi, botuar më 2004.

"Koden", roman, skriven av Hazyr Dervishi, utgiven år 2004.

8. "Pocahontas Powhatan", roman, shkruar nga Hazyr Dervishi, botuar më 2008.

"Pocahontas Powhatan", roman skriven av Hazyr Dervishi, utgiven år 2008.

9. "Më shumë heroizma se sa grurë", tregim i letrarizuar që flet për shqiptarët, shkruar nga Ulmar Kvik. Libri u botua më 2004, pastaj u përkthye në shqip nga Hajdin Abazi dhe gjithashtu u botua më 2006.

"Mer hjältemod än vete", en dokumentärschildring om albanerna, skriven av Ullmar Qvick. Boken är utgiven år 2004. Senare, översattes boken på albanska av Hajdin Abazi och utgavs år 2006.

10. "Historia e veshjeve popullore shqiptare - në shqip dhe suedisht", ku tregohen traditat e shqiptarëve që nga lindja e deri në vdekje. Libri u botua më 2006 dhe u përkthye në suedisht.

"Historik om albanska folkdräkter - på svenska och albanska" där man skildrar den albanska kulturen och dess traditioner från födelsen till döden. Boken utgavs år 2008.

11. "Poetët nga Gjakova, në suedisht - Poetët nga Treleborgu, në shqip". Një libër me poezi në të dy gjuhët, shqip-suedisht, botuar më 2010. Libri u përkthye në të dy gjuhët nga Ulmar Kvik dhe Hajdin Abazi.

"Poeterna från Trelleborg på albanska - Poeterna från Gjakova – på svenska". En poesibok på svenska och albanska språket, utgiven år 2010. Boken översattes på båda språken av Ullmar Qvick och Hajdin Abazi.

12. "Tre poetë shqiptarë, shqip-suedisht", ku janë përfshirë disa nga poezitë e Ismail Kadaresë, Frederik Reshpjes dhe Ali Podrimjes. Libri u përkthye nga Shqiptar Oseku dhe u botua më 2010.

"Tre albanska poeter", på albanska och svenska", där man presenterar några poesier av Ismail Kadare, Frederik Reshpja, Ali Podrimja. Boken översattes av Shqiptar Oseku och är utgiven år 2010.

13. "Ushtar i vonuar", roman, shkruar në gjuhën shqipe nga Shefki Oseku, botuar në vitin 2012.

"Försenad soldat", roman på albanska, skriven av Shefki Oseku, utgiven år 2012.

14. "Poezia bashkëkohore shqipe në suedisht", ANTOLOGJI. Libri u botua në vitin 2013, përkthyer në suedisht prej Ulmar Kvikut, Hajdin Abazit dhe Shqiptar Osekut e ku janë përfshirë poetët më të njohur të poezisë bashkëkohore shqipe.

"Nutida albansk poesi på svenska", ANTOLOGI. Boken utgiven år 2013, översattes till svenska av Ullmar Qvick, Hajdin Abazi och Shqiptar Oseku där man presenterar nutida och välkända albanska poeter.

15. "Poezia bashkëkohore suedeze në shqip", ANTOLOGJI. Libri u botua në vitin 2013, përkthyer nga Shqiptar Oseku.

"Nutida svensk poesi på albanska", ANTOLOGI. Boken är utgiven år 2013, översattes av Shqiptar Oseku.

16. "Poezi", përmblendhje poetike, shkruar nga Shqiptar Oseku, botuar në vitin 2013

"Poesibok", skriven av Shqiptar Oseku, utgiven år 2013.

Shefki Oseku, Kryeredaktori i Revistës "Drita", në Treleborg, Suedi.

Shefki Oseku, Chefredaktör för Tidskriften Drita, Trelleborg, Sverige.

P.S.

Përveç këtyre librave, gjatë viteve 1996-2000, është botuar edhe gazeta e përmuajshme "Drita", në gjuhën shqipe dhe suedisht. Të 26 numrat e gazetës në fjalë u shpërndanë në shumë vende të botës. Një falënderim të veçantë për ABF-in në Treleborg, Suedi dhe posaçërisht për Arne Nilsonin dhe Lars-Olof Obergun. Po kështu e falënderoj edhe Nise Martinsonin, që në fillim na dha ndihmën e pakursyer. Një mirënjohje të veçantë për mikun e dëshmuar të shqiptarëve, Ulmar Kvikun. Falënderoj djalin tim, Frashërin, që me përkushtim punoi për nxjerrjen e gazetës "Drita". Ju jam mirënjohës edhe bashkëpunëtorëve të redaksisë së "Dritës", veçmas Ulmar Kvikut, Shqiptar Osekut, Hajdin Abazit dhe Zeqir Ramës.

P.S.

Förutom dessa böcker, utgavs med 26 nummer under åren 1996-2000 även tidskriften Drita på albanska och svenska. Dessa 26 utgåvor av tidskriften distribuerades till många olika länder. Ett stort tack riktas till ABF i Trelleborg, Sverige, särskilt till Arne Nilsson och Lars-Olof Åberg. Till Nisse Martinsson riktas ett stort tack för den obegränsade hjälp han gav från början. Ett tack riktas också särskilt till albanernas beprövade vän, Ullmar Qvick. Tack också till min son, Frashër, som arbetade hängivet vid utgivningen av tidskriften Drita. Jag känner också tacksamhet till medarbetarna i Dritas redaktion, särskilt då Ullmar Qvick, Shqiptar Oseku, Hajdin Abazi och Zeqir Rama.